



Kompania Rajonale e Ujësjetjesit

*Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija*

RAPORTI VJETOR 2025 K.R.U."GJAKOVA" SH. A. GJAKOVË



Përgatitur në Shkurt, 2026

Tabela Përmbledhëse

1. Hyrje	4
Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv	4
Fjala hyrëse e Drejtorit të Bordit	6
2. Të dhënat për KRU Gjakova Sh.A.	7
2.1. Aktivitetet dhe performanca e Ndërmarrjes	8
2.1.1. Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit	9
2.1.2. Pasqyra e performancës operative dhe financiare.....	14
2.1.3. Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes	15
2.1.4. Pasqyra e të priturve për vitin e ardhshëm	16
2.2. Informacione në lidhje me kapitalin dhe dividenda	16
2.2.1. Kredit e rëndësishme	17
2.2.2. Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2025.....	17
2.2.3. Dividentet e paguara gjatë vitit	20
2.3 Të dhënat për Drejtorët Jo Ekzekut	20
2.3.1 Emrat e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025	20
2.3.2. Numri i takimeve të bordit gjatë vitit 2025	20
2.3.3. Komisioni i Auditimit, komitete numri i takimeve	21
3. Ngjarjet Kryesore të vitit.....	21
3.1. Arritjet kryesore	21
3.1.1. Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit.....	22
3.2. Pasqyra e performancës Operative Teknike.....	23
3.2.1. Niveli i shërbimeve të ndërmarrjes -indikatorët fizik.....	23
3.3. Ndryshimet që kanë ndodhur në performanc operative në krahasim me vitin e kaluar.....	37
3.4. Pasqyrë e performancës finciare dhe rezultatet	38
3.4.1. Ndryshimet në të ardhur dhe shpenzimet.....	38
3.4.2. Faktorët ndryshues në këto shpenzime	39
3.4.3. Komentet mbi ndryshime e strukturës së kapitalit.	39
3.5. Progresi me Planin e Biznesit	40
3.5.1. Pasqyrat e progresit në implementimin e Planit të Biznesit	40
3.5.2. Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjike	41
3.5.3. Çfarë ndryshimesh janë paraqitur gjatë aktivitetëve, operimeve	42
3.6. Shpenzimet kapitale dhe të projekteve.....	42
3.6.1. Komentet në progresin e e projekteve kapitale të ndërmarrjes	44
3.7. Përspektiva për vitin e ardhshëm	44
3.7.1. Skica gjithëpërfshirëse e P. Biznesit për vitin e ardhshëm dhe objektivat	44
3.7.2. Përmbledhja e arsytimit për ndryshime të mundshme	47
3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës.	49
3.8.1. Çfarë duhet berë për të ulur rreziqet	50
4. Raporti i Auditorit të Brendshëm.....	51
5. Raportimet sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike	53
5.1. Struktura organizative aktuale e KRU Gjakova.Sh.A.....	53
5.2. Pasqyrat Financiare për vitin 2025.....	54
6. Veprimtaria e Zhvilluar nga Dep. Administrativ	58
6.1. Punët e kryera nga sekretari për Bordin e Drejtorëve Janar-Dhjetor 2025.....	58
6.2. Seksioni i Burimeve Njerëzore	58
6.3. Seksioni Ligjorë.....	61
6.4. Njësia për mbrotje në punë e punëtorëve dhe sigurimi i objekteve.....	73
6.5. Seksioni i Arhivi	78
6.6. Veprimtaria e zhvilluar nga sektori i Teknologjis Informatike 2025.....	79
7. Veprimtaria e Zhvilluar nga Departamenti i Shitjes	82
7.1. Shërbimi me konsumator	83
8. Veprimtaria e Zhvilluar nga Zyra e Prokurimit	86
9. Sygjerimet me të cilat pritet të rritet performanca e Koimpanisë	89

Tabelat dhe figurat/grafikonet

Tabela 1. Pasqyra e Përformancës operative dhe financiare	14
Tabela 2. Struktura e kapitalit dhe kapitali aksionar	17
Tabela 3. Investimet nga donacionet e KFW-së, Qeverisë, Komunave dhe Investime vetanake 2025	17
Tabela 4. Investimet kapitale për përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore	19
Tabela 5. Uji i prodhuar, faturuar, humbjet gjatë vitit 2025, krahasuar me 2024 dhe BP 2025	24
Tabela 6. Uji i prodhuar gjatë vitit 2025 krahasuar me BP 2025	25
Tabela 7. Analizat e Ujit gjatë muajit Janar –Dhjetor 2025, krahasuar me vitin 2024	25
Tabela 8. Totali i Numrit të defekteve në vitin 2025, sipas Ø /mbi dhe nën 2 coll/	26
Tabela 9. Ujëmatës të rinj dhe të pastruar gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024	28
Tabela 10. Intervenimet në rrjetin e Kanalizimit gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2025, krahasuar me 2024	29
Tabela 11. Vlerat vjetor të analizave në ITUN 2025	30
Tabela 12. Incizimi i avarive në teren, Incizimi i dislokimeve dhe instalimeve të reja në GIS	35
Tabela 13. Incizimi i avarive në teren nga ekipi detektues në ujësjellës dhe kanalizim	36
Tabela 14. Pasqyra e përform. operat. në krahasim me vitin paraprak dhe planin aktual	37
Tabela 15. Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti 2025, dhe ndryshimet nga caqet e PB 2025	38
Tabela 16. Pasqyra e përformancës operative dhe financiare në krahasim me BP	40
Tabela 17. Lista e investimeve kapitale -2025	42
Tabela 18. Treguesit kryesor të përformancës, caqet e planifikuara PB 2025	45
Tabela 19. Pasqyrat financiare deri 31. Dhjetor 2025, krahasuar me vitin 2024	54
Tabela 20. Mbledhjet e Bordit Drejtorëve dhe Komisionit Auditimit	58
Tabela 21. Lista e Aktiviteteve të Burimeve Njerëzore	58
Tabela 22. Numri i punëtorëve dhe ndryshimet Janar-Dhjetor 2025 dhe krahasimi sipas BP	60
Tabela 23. Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve	60
Tabela 24. Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve (%)	60
Tabela 25. Ndarja gjinore në Kompani , raporti 18 % deri 82% në favor të punëtorëve meshkuj	60
Tabela 26. Numri i minoriteteve në KRU Gjakova Sh.A.	60
Tabela 27. Profili i moshës së stafit në KRU Gjakova Sh.A.	60
Tabela 28. Departamentet organizative në kuadër të Kompanisë	61
Tabela 29. Padi në procedure Civile K.R.U. "Gjakova" palë paditës	61
Tabela 30. Padi në procedure Civile K.R.U. "Gjakova" palë e paditur	62
Tabela 31. Akte të ndryshme të hartuara nga zyra Ligjore	64
Tabela 32. Seancat e mbajtura në Gjykata Janar-Dhjetor 2025	66
Tabela 33. Kallëzime penale të iniciuara nga KRU. "Gjakova" Sh. A. në Prokurorit themelore	70
Tabela 34. Arkëtimit i mjeteve nga Përmbaruesi Privat për periudhat Janar-2025 deri Dhjetor-2025	72
Tabela 35. Lëndë të dërguara tek përmbaruesit Privat për periudhat Janar-2025 deri Dhjetor-2025	73
Tabela 36. Objektet ,vizitat, gjendja në objekte dhe masat që duhet ndërmerren	73
Tabela 37. Nr. i vizitave personelit - Roje në sigurimin e objekteve	75
Tabela 38. Asistimet në vendet e punës , kontrollimi i mbajtjes së mjeteve mbrojtëse të punës nga punëtorët	75
Tabela 39. Aparatet e zjarrfikës (Modelet që kemi në posedim).	76
Tabela 40. Raporti i dokumenteve, lëndëve, dosjeve të regjistruara dhe dokumentet e dorëzuara me kërkesë gjatë vitit 2025	78
Tabela 41. Raporti i shkresave të protokolluara dhe të dorëzuara me Post	78
Tabela 42. Konsumatorët gjatë vitit, transaksionet, lidhjet e reja, blloime	82
Tabela 43. Prodhim, faturim për vitin 2025 i ndarë në njësi krahasuar me vitin 2024	82
Tabela 44. Krahasimi i vitit 2025 me BP 2025	82
Tabela 45. Raporti mbi numrin e Ankesave/Kërkesave dhe Kontratave të Shërbimeve	84
Tabela 46. Raporti i Marrëveshjeve për Riprogramimin e Pagesës së Borxhit me Këste	84
Tabela 47. Transaksionet-Aktivitetet e Prokurimit	86
Foto 1. Mbulueshmëria me furnizim me ujë nga KRU Gjakova (2025)	7
Foto 2. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit nga KRU Gjakova (2025)	8
Diagrami 1 - Uji i prodhuar, faturuar, UPF dhe humbjet 2025, krahasuar me 2024 dhe BP 2025	24

Shkurtesat:

ARRU -	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e ujit
MMPHI -	Ministria e Mjedisit, Planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës
IKSHPK -	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik Kosovë
ShUKOS-	Shoqata e Ujërave të Kosovës
ITUP -	Impianti i Trajtimit të Ujit të Pijes
ITUN -	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
UA -	Udhëzim Administrativ
AC -	Gyp Azbest Çimento
PE -	Gyp Polietileni
DMA –	District metered area – Zonë e Rrethuar/Izoluar e matur (Një nën-zonë e izoluar hidraulikisht në një rrjet shpërndarës për të cilën konsumi i ujit monitorohet me ujëmatës).
GIS -	Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) është një sistem kompjuterik që analizon dhe shfaq informacione të referuara gjeografikisht.
SPK -	Stacioni Policor Kufitar (Morinë)
KE-	Kryeshefi Ekzekutiv
KRU-	Kompania Rajonale e Ujërave
Sh.A.-	Shoqëri Aksionare
NJPMNP-	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
OE-	Operatori Ekonomik
NJAB-	Njësia e Auditimit të Brendshëm
BP-	Biznes Plani
NjO-	Njjësia operative
SCADA-	Kontrolli i mbikëqyrës dhe marrja e të dhënave të prodhimit të ujit (SCADA është një proces monitorimi dhe kontrole për pajisjet në proceset industriale dhe matjen e ujit)
BD-	Bordi i Drejtorëve
KA-	Komisioni i Auditimit
TM1,2,3,4-	Tremujorët (TM1 Janar-Mars, TM2 Prill-Qershor, TM3 Korrik-Shtator, TM4 Tetor-Dhjetor)
DEP-	Departamenti
Inv-	Investimi
mm-	milimetra
m-	metra
km-	kilometra
m²-	metra në katror
m³ -	metra në kub
%-	përqindja
Ø-	diametri i gypit/fi
VA-	volt amper
kV-	kilo volt (1,000 volt)
IT -	teknologjia informatike
Dt.-	data
Nr.-	numri

I. Hyrje

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2025. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.


Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara nga Departamentet e Kompanisë për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese.

Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve teknike, financiare, komerciale dhe çështje të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore.

Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

FJALA HYRESE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



Z. Hasan Krasniqi
Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të
Ujësjellësit "Gjakova" Sh.A.–Gjakovë

Viti 2025 Konsiderohet si vit i suksesshëm duke ju falenderuar angazhimit të të gjithë punonjësve, stafit menaxherial, zyrtarëve të lartë, qeverisje profesionale korporative nga ana e Bordit të Drejtorëve si dhe mbështetjes institucionale nga Aksionari. Prioritetet tona në të ardhmen mbeten të fokusuar në ofrimin e shërbimeve sa më kualitative, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastruktures ekzistuese, implementimin e investimeve kapitale si dhe rritjen e tregueve kryesor të performancës. Kompania ka

arritur që të përmbyllë pasqyrat financiare me një rezultat pozitiv dhe të kënaqshëm operativ duke ruajtur trendin pozitiv.

Në drejtim të kryerjes së punëve operative teknike Ndërmarrja është munduar që të arrijë rezultatet e planifikuara. Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit është arritur që të mirëmbahet sipas planit të paraparë. Suksesi është arritur përmes organizimit të punës, formimit të grupeve të rregullta të kontrollës të cilët në kontinuitet kanë inspektuar rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Falë ndihmës së institucioneve vendore, donatoreve ndërkombëtar, si dhe mjeteve tona vetenake me një profesionalizëm të lartë është arritur implementimi i suksesshëm i të gjitha projekteve të planifikuara .

Me një organizim maksimal të stafit të kësaj njësie kemi arritur që të kemi furnizim të mjaftueshëm të Liqenit me ujë, të sigurojmë ujë të pastër dhe cilësor gjithmonë duke i plotësuar standardet e kërkuara nga rregullorja për kualitet të ujit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (I.K.SH.P). Në aspektin e Prodhimi i ujit është prodhuar me kapacitet të plotë, aq sa kishte nevojë për furnizim të gjithë konsumatorëve.

Në anën tjetër KRU" Gjakova" me sukses ka realizuar planin e biznesit edhe në aspektin e realizimit të projekteve, duke arritur kështu të implementoj projektet e planifikuara, të cilat kanë pas impakt në rritjen e performancës teknike, zvogëlimin e humbjeve të ujit, zvogëlim të shpenzimeve operative, rritje/maksimizim të ardhurave dhe furnizim më kualitativ për konsumatorët.

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2025, si dhe tërë stafi i Kompanisë janë munduar me përkushtimin e tyre maksimal ti arrijnë caqet e dëshiruara të biznesit dhe konsumatorit ti ofroj shërbimet më të mira. Nuk ka munguar bashkëpunimi me Konsumatorin, informimi i vazhdueshëm i tyre për shërbimet, shqyrtimi me kohë dhe në mënyrë efektive të kërkesave të tyre, intensifikimin i aktivitetit për zvogëlimin e humbjeve të ujit, rritjen e faturimit dhe arkëtimit, si dhe organizimit të punës dhe motivimit të mirë të stafit.

Gjithashtu Kompania ka qenë shumë aktive në revidimin dhe konsolidimin e kornizës ligjore e regullative Opinioni i Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2025, me auditimin e bërë gjatë vitit 2025, e prezanton qartë punën profesionale dhe përkushtimin e Ekzekutivit në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës. Kompania me mjete vetenake ka arrit ti kryej me kohë obligimet e klientëve dhe institucioneve të Shtetit të Kosovës .

Për fund posaçërisht falënderojë Bordin e Drejtorëve të K.R.U." Gjakova " SH.A. Gjakovë për përkrahje të vazhdueshme dhe inkurajuese për projektet dhe përkrahjen e Menaxhmentit të K.R.U. "Gjakova" SH.A. Gjakovë. Falënderojmë NJPMNP dhe partnerët tanë afaristë, që pa bashkëpunimin reciprok nuk do të kishim mundur të përmbyllim këtë vit suksesesh.

Mbi të gjitha më lejoni të shpreh mirënjohje dhe respekt për konsumatorin tonë besnik, i cili na beson dhe i pëlqen produkti i jonë, ujë me cilësi, sasi dhe shtypje të mjaftueshme, me furnizim 24 orësh, e që shpresojmë të kenë begatuar dhe lehtësuar shumë nevojat e përditshme dhe jetën e tyre në përgjithësi .

FJALA HYRESE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE



Z. Urim Gashi

**Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Regjionale të
Ujësjetës "Gjakova" Sh.A. – Gjakovë**

Vitin 2025 Kompania ka shënuar përmirësime në realizimin e objektivave të afarizmit të saj, prej të cilave vlen të ceket rritja e faturimit, rritja e arkëtimit, zvogëlimi i shpenzimeve operative, rritja e investimeve kapitale. Në këtë periudhë, Bordi i Drejtorëve i cili ka operuar me përbërje të plotë, ka përqëndruar angazhimin e tij në ekzekutimin e detyrave të lejuara me legjislacion dhe akte të brendshme të Kompanisë, me qëllim të aritjes së planifikimeve të parashikuara për Kompaninë. Kështu Bordi ka luajtur rol aktiv dhe ka ofruar mbështetje për Menaxhmentin në realizimin e qëllimeve të caktuara me Planin e Biznesit.

Kemi shqyrtuar dhe miratuar kërkesat e menaxhmentit për projektet e caktuara kapitale, qofshin ato vetanake apo nga donatorët e ndryshëm.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Drejtorëve ka zhvilluar 13 mbledhje të rregullta, 1 Mbledhje Përgjithshme Vjetore me Aksionarin për vitin 2025 dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme. Në periudhat midis mbledhjeve Bordi i Drejtorëve ka marrë vendime meritore kur ka qenë e nevojshme, ka monitoruar rregullisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e KRU "Gjakova" Sh.A. dhe zhvillimet e rrezikut brenda saj, janë zhvilluar rregullisht diskutime me anëtarët e Drejtorisë në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe mbi drejtimin e aktivitetit të Ndërmarrjes dhe strategjitë e rrezikut. Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar gjithashtu në mënyrë të hollësishme zhvillimet e mëtejshme në lidhje me qeverisjen e korporatës dhe ka monitoruar zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë veprimtarisë së tij monitoruese dhe këshilluese, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur kontakte të drejtpërdrejta me punëtorët përgjegjës të Drejtorive, auditorët, si dhe drejtuesit tjerë përgjegjës për funksionet e

ndërmarrjes. Ai gjithashtu ka pasur një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni dhe pikëpamjesh me përfaqësuesit e autoriteteve mbikqyrëse për çështje me rëndësi. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve nga drejtoritë ka marrë raporte të rregullta dhe të hollësishme për çështje të rëndësishme në lidhje me performancën në fushat përkatëse të aktivitetit të Ndërmarrjes. Bordi i Drejtorëve ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në legjislacionin, statutin e Ndërmarrjes dhe Kodin e Etikës. Gjatë mbledhjeve janë diskutuar diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e Ndërmarrjes. Dëshiroj të përfitoj nga rasti për të falënderuar klientët tanë për besimin e tyre të vazhdueshëm dhe të gjithë punonjësit e KRU "Gjakova" Sh.A. për punën e tyre të palodhur dhe përpjekjet e palëkundura gjatë vitit 2025, si dhe për të kërkuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm për të përballuar çdo sfidë që po kalojmë.

Duke e përmbyllur këtë fjalë dhe duke iu referuar të dhënave, të cilat do të gjeni në këtë raport, kam kënaqësinë të përgëzoj Kryeshefin Ekzekutiv, të gjithë menaxherët, zyrtarët dhe punonjësit e kompanisë tonë për punën e zellshme që kanë bërë. Njëkohësisht një falënderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat kontribuan për suksesin tonë.

2. TË DHËNAT PËR KOMPANINË KRU GJAKOVA Sh.A.

KRU“Gjakova” Sh.A. Gjakovë, ka kapacitet dhe mund të furnizon me ujë të pijshëm rreth 230,000 banor, me 1,000 lit/sec, apo prodhim të ujit të pijes në sasi prej 86,400 m³ në ditë.

KRU Gjakova, posedon kaptazhën në lumin Bistrice të Deçanit, kanalin derivues prej 9 km, Liqenin e Radoniqit, si i vetmi burim kryesor dhe burimet vetanake në fshatrat: Damjan 1 & 3, Gërquinë, Opterushë, Hoqë e Madhe, Senoc, Drenoc dhe burimin në bjeshkën e Babaj Bokës, që shërbejnë për furnizim për këto fshatra.

Kapaciteti (Maksimal) i Liqenit është 118.7 milion m³, kur është i mbushur plotë, në kotën mbidetare prej 456 m, gjatësia maksimale e Liqenit është 5,035m., gjerësia maksimale e Liqenit është 2,100 m., thellësia maksimale është 61m, sipërfaqja e Liqenit me ujë në kuotën maksimale është 574.3 hektar, (vlerat janë marr nga raporti i matjeve të fundit batimetrike të kryera në liqenin e Radoniqit nga Kompania “Studio Pietrangeli” në vitin 2024/2025, në kuadër të projektit FLOWS i mbështetur nga Banka Botërore).

Stacioni i filtrave për trajtimin e ujit faza I & II, 42 rezervuare të ujit me kapacitet prej: 23,390m³, 36 stacione pompimi, rrjet primar dhe sekondar të ujësjellësit të regjistruar në ArcGIS 1,363,829 m, apo 1,364 km. Gypa që furnizohen nga liqeni i Radoniqit: 1,061,057 m, dhe gypat që furnizohen nga burimet: 302,772 m.

Përveç furnizimit me ujë të pijshëm KRU “Gjakova” bënë shërbime për menaxhimin dhe largimin e ujërave të ndotura, me një rrjet prej 96.6 km, ku prej tyre janë të digjitalizuara në ArcGIS: 92.266 km apo 94.3 % si në vijim: Gjakovë 73.6 km, rrjet i kanalizimit fekal i cili është i digjitalizuar 100 %, dhe Rahoveci 23 km, rrjet kanalizimi fekal, ku prej tyre janë të digjitalizuar 18.9 km, apo 82.03 %. Në kuadër të rrjetit kemi edhe 2,825 puseta të kanalizimit fekal dhe 1,368 puseta të kanalizimit atmosferik.




Foto 1. Mbulueshmëria me furnizim me ujë nga KRU Gjakova (2025)




Foto 2. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit nga KRU Gjakova (2025)

2.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë arritja e realizimit të objektivave të planifikuara për vitin 2025 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera nga aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2025. Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025 si edhe vitet tjera ka qenë arritja e caceve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Janë hartuar nga ekzekutivi dhe aprovuar nga BD një sërë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve, si dhe Planifikimi i Biznesit për periudhën 2025-2027.

KRU "Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2025 ka realizuar performancës pozitive në të gjithë treguesit e performancës krahasuar me vitin 2024 dhe BP e vitit 2025 e që në mënyrë detale janë të prezantuara në kriteret e kërkuara si më poshtë në këtë raport .

Punët Administrative -janë hartuar dhe aprovuar një sërë rregullore të brendshme të Kompanisë, manuale, si dhe akte tjera të cilat kanë bërë që puna të kryhet në mënyrë profesionale dhe e bazuar në infrastrukturën ligjore të ligjeve në fuqi në Kosovë.

Raportet teknike, financiare dhe administrative prezantojnë në mënyrë të përgjithësuar të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Kompania, sa janë realizuar ato duke i prezantuar përmes tabelarëve dhe diagrameve si dhe duke dhënë sqarime detale për të gjitha shifrat dhe faktet e prezantuara përmes raporteve teknike, financiare dhe administrative.

2.1.1. Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit

Me datë 20.07.2022 është emëruar Bordi Drejtorëve me Vendimin NR 10/89 në përberje prej 4 anëtarëve Kryesues z.Urim Gashi Kryesues, znj.Arianeta Nura, Anëtare znj.Vildane Maloku, Anëtare z.Jeton Haxhija - Anëtar, me mandat prej 3 vite. Me datën 14.12.2023 janë emëruar tre anëtar të ri të Bordit si znj.Fortuna Haxhikadrija, z.Armend Behluli dhe z.Faton Osmani.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2025, i ka mbajtur 13 takime të rregullta me përbërje të plotë, dhe 1 mbledhje vjetore të përgjithshme me Aksionarin, dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme. Në kuadër të Bordit të Drejtorëve funksionon edhe autoriteti i zgjedhur nga Qeveria -Komisioni i Auditimit është emëruar me datë 26.07.2022 me NR Vendimit 01-1742. Komisioni Auditimit ka mbajtur gjithsejtë (13) takime.

Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv. Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të Kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme. Bordi i Drejtorëve duke mos dalur nga suazat e kompetencave si autoritet i emëruar për përfaqësimin e aksionarit e plotësisht në harmoni me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në harmoni me interesat e aksionarit ka marrë vendime me të cilat ka aprovuar :

Vendimet dhe Qëndrimet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit të emëruar me dt.

26.07.2022 me Nr. Vendimit 01-1742

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 32 data: 27.01.2025

VENDIM-Aprovohet raporti 6 mujor TM-III dhe TM-IV dhe raporti vjetorë punës dhe rekomandimeve për vitin në KRU" Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Dhjetor2024 bashkangjiten përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIMR-Raporti tremujor TM4 Tetor-Dhjetor 2024 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 33 data: 25.02.2025

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Janar 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve, Kërkohet nga menaxhmenti të mirren masa lidhur me arketimin sepse verëhet rënie krahasim me vitin 2024 dhe PB 2025.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 34 data: 14.03.2025

QËNDRIM-Raporti vjetor 2024 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste 2024 në KRU" Gjakova" Sh.A.- Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 35 data: 03.04.2025

QËNDRIM-Përcillet plotësim ndryshimi Statutit neni 14 pika 2.1 në KRU' Gjakova' Sh.A. për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Shkurt 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit Nr. 36 data: 25.04.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti AD-HOC Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në KRU' Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Mars 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për

aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Raporti tremujor TM1-Janar-Mars 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova'Sh.A.-Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Draft Rregullorja për Procedurat e Rekrutimit në KRU'Gjakova'Sh.A. përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit Nr. 37 data: 23.05.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti Sistemi për menaxhimin e Procedurave të Faturimit për periudhën Janar 2024/Janar 2025 në KRU'Gjakova'Sh.A-Gjakovë.

QËNDRIM-Përcillet për aprovimin në Bordin të Drejtorëve plotësim ndryshimi Statutit neni 14 pika 2.1 në KRU 'Gjakova'Sh.A-Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Prill 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Kërkohet sqarime nga Auditori Jashtëm lidhur me të gjeturat në letrën e menaxhmentit 2024.

QËNDRIM-Draft Rregullorja për Procedurat e Rekrutimit në KRU'Gjakova'SH përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 38 data: 25.06.2025

VENDIM Aprovohet Raporti Sistemi për menaxhimin e Procedurave të Prokurimit për periudhën Janar-Dhjetor 2024 në KRU'Gjakova'Sh.A.-Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Maj 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Rregullorja për Procedurat e Rekrutimit në KRU'Gjakova'Sh.A. përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 39 data: 28.07.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti gjashtëmujorit të parë lidhur me auditimet e brendshme të kryera për periudhën Janar - Qershor 2025 në KRU'Gjakova'Sh.A-Gjakovë .

VENDIM-Aprovohet raporti final "Sistemi për Menaxhimin e Mjeteve Themelore (nga mjetet vetanake dhe format e tjera të financimit) për periudhën Janar - Dhjetor 2024 në KRU'Gjakova'Sh.A.-Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Qershor 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Raporti tremujor TM2 Prill - Qershor2025 përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Plani veprimit lidhur me të gjeturat e Auditorit Jashtëm për vitin 2024 përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 40 data: 26.08.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti final Furnizim me barkë dhe dy kamioneta' në KRU'Gjakova'Sh.A.-Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Korrik 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 41 data: 24.09.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti final Sistemi për Menaxhimin e Depove" për periudhën Janar - Dhjetor 2024.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Gusht 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 42 data: 30.10.2025

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Shtator 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

QËNDRIM-Planin Biznesit 2026-2028 në KRU"Gjakova" Sh.A- Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

VENDIM-Vazhdohet mandati Drejtoreshes së Njesisë së Auditimit znj Arbresha Dina Thaqi për 3 vite nga data 08.12.2025-07.12.2028.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 43 data: 24.11.2025

VENDIM-Aprovohet Raporti Final "Sistemi për Menaxhimin e Sektorit të Marrëdhënies me Konsumator" për periudhën Maj 2024 deri Gusht 2025 në KRU"Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Raporti Final "Sistemi për Menaxhimin e Sektorit të Marrëdhënies me Konsumator" për periudhën Maj 2024 deri Gusht 2025 në KRU"Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Plani Strategjik për NJAB për periudhën 2026 – 2028 në KRU"Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Raporti Vjetor për NJAB për periudhën 2026 – 2028 në KRU"Gjakova" Sh.A- Gjakovë.

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Tetor 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 44 data: 22.12.2025

QËNDRIM-Raportet mujore financiare Nëntor 2025 bashkangjiten me raportin e KE dhe përcillen për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtorëve.

Vendimet e mbledhjeve të Bordit Drejtorëve të emëruar me datë 20.07.2022 është emëruar Bordi Drejtorëve me Vendimin NR 10/89

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr.33 data: 30.01.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Dhjetor 2024 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A-Gjakovë.

VENDIM Aprovohet raporti tremujor TM4 Tetor –Dhjetor 2024 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A-Gjakovë.

VENDIMI-Aprovohet me shumicë votave kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv me nr. protokolli 1198 datë 26.12.2024 për ngritjen e pagave prej 10 % të pagës bazë për gjithë punëtorët e Kompanisë në KRU'Gjakova"Sh.A.- Gjakovë.II. Zyrtarëve të lartë dhe drejtorëve departamentit teknik dhe departamentit komercial i ngritet paga bazë 50 euro + 10 % në të ardhurat personale.

III.Ngritja e pagave si në pikën I dhe II të këtij Vendimi do të ekzekutohet në llogaritjen e të ardhurave personale nga muaji Janar 2025 në KRU 'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:34 data: 27.02.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Janar 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr Nr:35 data: 14.03.2025

VENDIM-Aprovohet Raportit Vjetor 2024 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.- Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr :36 data: 04.04.2025

VENDIM-Aprovohet unanimisht plotësim ndryshimi Statutit të Kompanisë neni 14 pika 2.1 me emërin e UD.Kryeshef Ekzekutiv z.Visar Hasi.

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Shkurt 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:37 data: 28.04.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Mars 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet unanimitisht raporti TM1 Janar-Mars 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:38 data: 29.05.2025

VENDIM-Aprovohet unanimitisht plotësim ndryshimi Statutit të Kompanisë neni 14 pika 2.1 me emërin e Kryeshef Ekzekutiv z.Hasan Krasniqi.

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Prill 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet unanimitisht Raporti Auditorit Jashtëm dhe Letra Menaxhmentit 2024 në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë. Menaxhmenti të hartojë Planin e Veprimit për eliminimin e gjetjeve për vitin 2024.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:39 data: 30.06.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Maj 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet unanimitisht Rregullorja mbi Procedurat e Rekrutimit në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet unanimitisht Rregullorja mbi Procedurat disiplinore e Rekrutimit në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:40 data: 31.07.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Qershor 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet raporti tremujor TM2 Prill-Qershor 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet me shumicë votave Rishiqimi Planit Biznesit për vitin 2025 në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet me shumicë votave Plani veprimit të menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm për vitin 2024 në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordi Drejtorëve nr:41 data: 28.08.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Korrik 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv z.Hasan Krasniqi i vazhdohet në afat prej 3 vite duke filluar nga data 30.09.2025 - 01.10.2028.

Mbledhja e Bordit Drejtorëve nr 42 data: 30.09.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Gusht 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordit Drejtorëve nr:43 data: 31.10.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Shtator 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet raporti tremujor TM3 KE Korrik- Shtator 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU" Gjako" Sh.A.- Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Plan Biznesit 2026-2028 në KRU" Gjako" Sh.A.- Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Planit menaxhimit aseteve 2026 në KRU" Gjako" Sh.A.- Gjakovë.

VENDIM-Vazhdohet mandati Sekretares së Kompanisë dhe për 3 vite nga data 02.12.2025-01.12.2028.

Mbledhja e Bordit Drejtorëve nr:44 data: 27.11.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Tetor 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja e Bordit Drejtorëve Nr:45 data: 26.12.2025

VENDIM-Aprovohet raporti mujor i Kryeshefit Ekzekutiv Nëntor 2025 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Planit Menaxhimit të emergjencave në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet Plani Sigurisë së ujit në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë Menaxhimit të emergjencave në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë.

VENDIM-Aprovohet me shumicë votash kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv me nr protokolli 1319 për shpërblimin e punëtorëve në vlerë prej 300 euro bruto në të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2025.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve të KRU "Gjako" Sh.A.-Gjakovë

Mbledhja Nr 1 data: 12.03.2025

Mbledhja Nr 2 data: 22.03.2025

VENDIM-.z.Hasan Krasniqi Kryeshef Ekzekutiv në KRU" GJAKOVA" Sh.A. Përkohësisht Largohet nga puna duke filluar nga data 22.03.2025

VENDIM-.Z.Visar Hasi emërohet në pozitën e ushtruesit të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në KRU' Gjako" Sh.A.-Gjakovë.

Mbledhja Nr 3 data: 24.04.2025

VENDIM-Shfuqizohet vendimi nr.1227 dt. 22.03.2025 mbi largimin e përkohshëm nga puna për z.Hasan Krasniqi.

VENDIM -Shfuqizohet vendimi nr.1228 dt.22.03.2025, mbi emërimin e z Visar Hasi në pozitën e punës ushtruesit detyre të Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Gjako" SH.A-Gjakovë.

2.1.2 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Bordi në mënyrë të rregullt ka vlerësuar parametrat e performancës së Kompanisë. Krahasuar me vitin 2024 dhe Planifikimin e Vitit 2025, Kompania ka arritur që ti realizoi pothuajse të gjitha caqet e objektivave .

Tabela 1. Pasqyra e Performancës operative dhe financiare

Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual							
Treguesit kryesor të performancës		Caqet e realizuar a 2024	Caqet e realizuara 2025	Ndryshimi në përqindje	Caqet e planifikuara BP 2025	Caqet e realizuara 2025	Ndryshimi në përqindje
1.	Uji i prodhuar në m ³	16,202,875	16,211,843	0.06%	16,150,102	16,211,843	0.38%
2.	Uji i faturuar në m ³	8,434,971	8,300,017	-1.63%	9,199,005	8,300,017	-10.83%
3.	Konsumatorë të regjistruar nr.	49,216	51,702	4.81%	51,684	51,702	0.03%
4.	Nr. i faturave të lëshuara	49,216	51,702	4.81%	51,684	51,702	0.03%
5.	Nr. i kons. që faturohen sipas leximit me ujëmatës	49,147	51,645	4.84%	51,684	51,645	-0.08%
6.	Uji faturuar për konsumatorët me ujëmatës m ³	8,402,807	8,286,048	-1.41%	8,755,003	8,286,048	-5.66%
7.	Faturimi nga uji në Euro	5,002,476	5,084,575	1.61%	5,335,423	5,084,575	-4.93%
8.	Arkëtimi nga uji në Euro	5,357,492	5,234,542	-2.35%	5,335,423	5,234,542	-1.93%
9.	Të hyrat tjera operative Euro	130,075	157,985	17.67%	144,000	157,985	8.85%
10.	Shpenzimet operative Euro	3,980,809	4,837,521	17.71%	4,123,833	4,837,521	14.75%
11.	Shlyerja e borxheve ndaj konsumatorëve Euro	0	0	0	0	0	0
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët Euro	0	0	0	0	0	0
13.	Parat e gatshme në bank dhe në arkë Euro	1,282,039	470,665	-172.39%	1,288,284	470,665	-173.72%
14.	Stoqet Euro	829,379	740,957	-11.93%	846,423	740,957	-14.23%
15.	Llogarit e arkëtueshme nga uji Euro	9,284,692	9,062,175	-2.46%	9,469,702	9,062,175	-4.50%
16.	Llogarit e pagueshme Euro	26,380,809	28,213,636	6.50%	22,668,340	28,213,636	19.65%
17.	Numri i punëtorëve	293	301	2.66%	305	301	-1.33%
18.	Numri i ankesave	2,213	1,429	-54.86%	250	1,429	82.51%
19.	Numri total i testeve të realizuara laboratorike	3,989	3,600	-10.81%	4,037	3,600	-12.14%
21.	Matja e treguesve në %						
22.	Uji i pa faturuar %	48%	49%	0.90%	43%	49%	5.80%
23.	Përqindja e faturimit %	100%	100%	0%	100%	100%	0%
24.	Përqindja e konsumit të matur%	100%	100%	0.00%	95%	100%	5%
25.	Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	100%	100%	0.00%	100%	100%	0%
26.	Efikasiteti i stafit numër	5.95	5.82	0	5.90	5.82	0
27.	Shkalla e arkëtimit në % total	107%	103%	-4.15%	100%	103%	2.95%
28.	Shkalla e arkëtimit në amv% -	110%	104%	-6.00%	96%	104%	8.00%
29.	Shkalla e arkëtimit në biz.% -	97%	107%	10.00%	97%	107%	10.00%
30.	Shkalla e arkëtimit në inst.% -	110%	87%	-23.00%	92%	87%	-5.00%
31.	Norma e mbulesës së punës numër	1.38	1.08	-30%	1.33	1.08	-25%
32.	Norma e punës numër	1.29	1.08	-21%	1.33	1.08	-25%
33.	Shpenzimet Operative për Konsumatorë numër	6.74	7.80	1	6.65	7.80	1%

Prodhimi i ujit në m³-Prodhimi i ujit në vitin 2025, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2024 ka rritje prej 0.06%, ndërsa krahasuar me BP 2025 ka rritje prej 0.38%. Rritja e prodhimit të ujit ka ardhur si pasojë e rritjes së kërkesës për ujë nga rritja e konsumatorëve.

Faturimi nga uji në Euro-Në vitin 2025 faturimi në Euro është më i lartë se në vitin 2024 për 1.61% ndërsa krahasuar me BP 2025 ka zvogëlim për 4.93%. Rritja e faturimit të ujit ka ardhur si pasojë e rritjes së prodhimit të ujit dhe zvogëlimit të humbjeve.

Arkëtimi nga uji në Euro – Në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, vlera e arkëtimit nga uji në euro ka zvogëlim për 2.35%, ndërsa kur krahasojmë me Biznes Planin 2025 ka zvogëlim prej 1.93%.

Shpenzimet Operative Euro- Në vitin 2025 kanë qenë për 17.71% më të larta se vitin 2024, kurse për 14.75% më të larta se BP 2025. Shpenzimet operative përfshijn shpenzimet e pagave, kemikaleve, derivateve, rrymes, taksave, mirëmbajtjes etj. Rritje më madhe të shpenzimeve kanë shpenzimet e rrymës.

Humbjet e ujit % -Në vitin 2025, humbjet e ujit janë përfunduar me 49%,për 0.90% më të larta se viti 2024 dhe për 5.8% më të larta se BP 2025.

Fitimi operativ euro – Viti 2025 e kemi mbyllur me fitim operativ (raporti në mes të arkëtimit dhe shpenzimeve operative) prej 563,613€. Krahasuar me vitin 2024 fitimi operativ në euro ka qenë me 1 ulët për 934,475 €, kurse kur krahasojmë me BP 2025 ka zvogëlim për 188,435€. Zvogëlimi i fitimit operativ ka ardhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative kryesisht shpenzimeve të rrymës, pagave.

Numri i punëtorëve- Kur krahasojmë vitin 2025 me vitin 2024 numri i punëtorëve ka rritje prej 2.66%, kurse kur krahasojmë BP 2025 ka zvogëlim për 1.33%.

Numri i testeve të dështuara - Në vitin 2025 në total kanë dështuar 26 mostra fiziko-kimike në zonën e furnizimit për shkak të turbecitetit të ujit. Zakonisht ndodhin në fshatrat që i kanë burimet e veta të ujit dhe për shkak të reshjeve atmosferike dhe problemeve me energji elektrike.

Numri i konsumatorëve- Në vitin 2025 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2024 ka rezultuar me rritje prej 4.81% ndërsa krahasuar me BP 2025 numri i konsumatorëve ka rritje prej 0.03%.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë- Me 31.12.2025 paraja ka qenë 470,665, që është për 172.39% më pak se në vitin 2024 dhe për 173.72% më pak se BP 2025. Paraja përfshin paranë në të gjitha bankat dhe atë në arkë.

2.1.3 Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Top çështjet tjera të cilat do mund të përcaktojnë të ardhmen e Kompanisë janë :

- Krijimi në vazhdimësi i kushteve më të volitshme të infrastrukturës ujore dhe të kanalizimit për konsumatorët tanë.
- Funksionimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, e cila është futur në funksion në vitin 2022 dhe është biznes i ri për Kompaninë.
- Zgjidhja e çështjes financiare të obligimeve financiare të rregullta mujore ndaj ARRU-së, MMPH

etj.

- Arkëtimi i borxheve të vjetra sipas Saldo 31.12.2025, sipas Ligjit në mënyrë të detyruar.
- Realizimin e Marrëveshjeve për borxhet e pa paguara, me konsumatorët borxhli për ri-programim të borxheve ndaj KRU-së.
- Pajisja me ujëmatës të mençur i të gjithë kategorive të konsumatorëve.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit të pijes.
- Lidhja e Marrëveshjeve të shërbimeve me konsumatorët.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë, mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit, në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e koston së këtyre shpenzimeve.
- Angazhimi maksimal i Sektorit të Planifikimit e Zhvillimit në hartimin e Projekteve investive kapitale, për aplikimin tek aksionari Qeveria e Kosovës, Donatorët, Bankat, etj.
- Realizimi me kohë i projekteve
- Zhvillimi i raporteve të vazhdueshme me Institucionet vendore dhe donatorët ndërkombëtar.
- Rritjen e investimeve kapitale nga mjetet vetanake.
- Gatishmëria teknike dhe furnizimi i duhur me makineri të rëndë për nivelin e duhur të operativës.

2.1.4 Pasqyrë e të pritave për vitin e ardhshëm

Kompania do të vazhdoj punën në vitin e ardhshëm në mirëmbajtjen dhe aktivitetin e avancimit të funksioneve të operimit si dhe do të realizoi treguesit operativ dhe financiar sipas objektivave të përcaktuara në Plan Biznes 2026:

- Menaxhimi i prodhimit të planifikuar në: 16,687,102 m³,
- Shitja me shumicë e ujit për Komunën e Mamushës,
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë për -1%
- Rritjen e sasisë së ujit të shitur e të faturuar për + 20.71%
- Rritja e arkëtimit të faturuar në 100%
- Rritja e arkëtimit në masën prej +23.11%
- Rritjen e shpenzimeve operative për +12.10%
- Investime vetanake kapitale 1,714,041 euro, për ujë dhe ujëra të zeza.

2.2. Informacione në lidhje me kapitalin dhe dividendën

Rivlerësimi i aseteve në KRU "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë, e kemi kryer gjatë vitit 2020. Në pajtim me ligjet e aplikueshme, ky proces është kryer përmes një kompanie të licencuar për vlerësim dhe atë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik. Vlera e aseteve pas rivlerësimit ka pasur ngritje, nga vlera neto e tyre në kontabilitet nga 31,811,412 është ngritur në 43,068,810 dhe diferenca prej 11,257,399 i është shtuar kapitalit të Kompanisë si rezervë nga rivlerësimet, kurse vlera prej 215,270 euro janë zbrit rezervat e rivlerësimit duke rritur fitimet e mbajtura. Kapitali themelor i Ndërmarrjes në momentin e regjistrimit ka qenë 25,000 € aksione me vlerë nominale prej 1 € secili. Aksionar i vetëm i K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë është - Qeveria e Republikës së Kosovës. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themelor, bëhen sipas përcaktimit në Ligjin Nr.02/L123 "Për Shoqëritë Tregtare" ku përfshihet shuma-parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksionit, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themelor, riblerja ose revokimi i aksionit.

Tabela 2. Struktura e kapitalit aksionar

Struktura e Kapitalit	Kapitali Aksionar në Euro
Kapitali aksionar në para	25,000
Rezervat e rivlerësimit	40,423,164
Humbjet e bartura	9,105
Fitimit/Humbja financiare e vitit 2025	91,640
Total ekuiteti dhe kapitali	40,548,909
Bilanci deri me 31.12.2025	40,548,909

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2025 Kompania nuk ka hyrë në marrëdhënie kreditore .

2.2.2 Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2025

KRU “Gjakova ” Sh.A. gjatë vitit 2025, ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor, por edhe nga kërkesat e Komunave në zonën e shërbimit të cilave ju jepet një prioritet. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2025, janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim, në veçanti Projektet e financuar nga ME, kanë pasur një ngecje në realizim për shkak të vonesës për dhënien e lejeve ndërtimore nga Komunitat në zonën e shërbimit, në trasetë e terenit ka kanë kaluar projektet. Më poshtë janë paraqitur projektet Investive dhe burimet e financimit të projekteve.

Projektet e paraqitura në vijim janë të financuara nga; mjetet vetanake, disa prej tyre me bashkëfinancim me; Komuna e Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit, donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Banka Gjermane.

Gjithashtu vlen të theksohet se është punuar me intensitet të lartë për investime shumë të rëndësishme si më poshtë:

Tabela3. Investimet nga donacionet e KFW, Qeverisë, Komunave dhe vetanake për vitin 2025

Emri i Projektit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Dëshmi mbi punimet e realizuara
Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit faza 1.	Projekt me bashkëfinancim; ME 500,000.00€, Komunën e Rahovecit 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 243,389.85€ Gjithsejtë: 943,389.85€.	ME 500,000.00€, Komuna e Rahovecit 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 219,234.84€ Gjithsejtë: 919,234.84€	Ka vazhduar nga viti 2024. Ka përfunduar me datë: 21.11.2025
Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, Medvec dhe Komuna Mamushës faza 1.	Projekt me bashkëfinancim; ME 700,000.00€ Komuna e Prizrenit 300,000.00€ dhe KRU Gjakova 248,952.53€ Gjithsejtë: 1,248,952.53€	ME 700,000.00€ Komuna e Prizrenit 300,000.00€ dhe KRU Gjakova 248,952.53€ Gjithsejtë: 1,248,952.53€	Ka vazhduar nga viti 2024. Ka përfunduar me datë: 24.12.2025
Gypi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për	Projekt i financuar nga Ministria e Ekonomisë 449,964.26€ Gjithsejtë: 449,964.26€	Projekt i financuar nga Ministria e Ekonomisë 449,964.26€	Ka përfunduar me datë: 18.12.2025

vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojz, Medvec dhe Mamushë-FAZA II,		Gjithsejtë: 433,214.26€	
Ndërtimi i rrjetit dhe stacionit të pompave shtytëse për SPK në Qafë Morinë – Ritender-2	Projekt me bashkëfinancim; nga KRU Gjakova:40,287.45€ dhe Policia e Kosovës:38,707.55€ Gjithsejtë: 78,995.00€	KRU Gjakova:34,538.60€ dhe Policia e Kosovës:33,184.15€ Gjithsejtë:67,722.75€	Ka vazhduar nga viti 2024. Ka përfunduar me datë: 24.06.2025
Rehabilitimi i ujësjellësit për fshatrat Ratkoc dhe Bratotin	Projekt me bashkëfinancim; KRU Gjakova: 30,584.088€ dhe Komuna e Rahovecit: 29,384.712€. Gjithsejtë: 59,968.80€	KRU Gjakova: 30,584.088€ dhe Komuna e Rahovecit: 29,384.712€. Gjithsejtë: 59,968.80€	Ka përfunduar me datë: 26.06.2025
Ndërrimi i gypit furnizues nga stacioni i pompave Pataqan i ulet deri te rezervuari Pataqan i Epërm	Vetëfinancim KRU Gjakova – Kontrata bazë: 134,532.58€. Gjithsejtë: 134,532.58€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 108,446.58€. Gjithsejtë:108,446.58€	Ka përfunduar me datë: 12.09.2025
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rr. Ymer Pula dhe në 4 fshatrat të komunës së Gjakovës	Vetëfinancim KRU Gjakova – 113,535.64€. Gjithsejtë:113,535.64€	Vetëfinancim KRU Gjakova: 113,535.64€. Gjithsejtë:113,535.64€	Ka përfunduar me datë: 30.10.2025
Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP- Ritender	Vetëfinancim KRU Gjakova – 6,272.30€. Gjithsejtë: 6,272.30€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 6,272.30€. Gjithsejtë: 6,272.30€.	Ka përfunduar me datë: 25.06.2025
Renovimi i objekteve administrative	Vetëfinancim KRU Gjakova – 7,856.86€. Gjithsejtë: 7,856.86€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 7,856.86€. Gjithsejtë: 7,856.86€.	Ka përfunduar me datë: 24.12.2025
Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës	Projekt me bashkëfinancim; ME 200,000.00€ Komuna e Gjakovës 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 184,277.25€ Gjithsejtë: 584,277.25€	ME 200,000.00€ Komuna e Gjakovës 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 184,277.25€ Gjithsejtë: 584,277.25€	Ka filluar në Nëntor 2025. Vazhdon në vitin 2026.
Sanimi i rrjetit të kanalizimit si rast emergjent në rrjetin e kanalizimit në rrugën Nëna Terezë	Vetëfinancim KRU Gjakova – Pjesa e parë: 44,847.00€. - Pjesa e dytë: 52,548.41€ Gjithsejtë: 97,395.41€	Vetëfinancim KRU -Pjesa e parë: 44,847.00€. - Pjesa e dytë: 52,548.41€ Gjithsejtë: 97,395.41€	Ka përfunduar me datë: 15.07. 2025.
Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec,dhe Smaq 1-faza 2	Vetëfinancim KRU Gjakova – 44,616.58€. Gjithsejtë: 44,616.58€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 44,616.58€. Gjithsejtë: 44,616.58€.	Kontrata është nënshkruar me: 20.10.2025, vazhdon 2026.
Instalimi i ujëmatësve jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashengjergj të Komunës së Prizrenit	Vetëfinancim KRU Gjakova – 32,821.00€. Gjithsejtë:32,821.00€	Vetëfinancim KRU Gjakova: 32,821.00€. Gjithsejtë:32,821.00€	Kontrata është nënshkruar me: 20.10.2025, vazhdon 2026.

Sanimi i rrjetit të kanalizimit nëpër rrugë të ndryshme, në gypat e dëmtuar dhe ndërtimin e pusetave	Vetëfinancim KRU Gjakova – Vlera e kontratës bazë: 56,485.00€. 1 vit. Gjithsejtë: 56,485.00€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 56,485.00€. Gjithsejtë: 56,485.00€.	Kontrata është nënshkruar me datë: 02.12.2025 vazhdon 2026.
Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve në teren, në tërë Njësit e KRU Gjakova	Vetëfinancim KRU Gjakova – Kontrata bazë: 26,600.00€, për një vit. Gjithsejtë: 26,600.00€.	Vetëfinancim KRU Gjakova: 26,600.00€, Gjithsejtë: 26,600.00€.	Kontrata është nënshkruar me: 11.12.2025 vazhdon 2026.
Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë Faza V-VI 1) Rehabilitimi i Rrjetit të Ujërave të Ndotura, 2) Furnizimi i Autocisternës për mirëmbajtje të Rrjetit të Ujërave të Ndotura, 3) Ndërtimi i Argjinatures për mbrojtjen e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) nga vërshimet e lumit Erenik	Investimi është grant i pakthyeshem nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW. Vlera financiare e kontraktuar: 4,191,238.42€. 1) Albstar: nënshkrimi i kontratës më 22.11.2025; në fazën e garancionit 1 vjeçar, vlera e zbatuar = 3,629,982.26€ 2) Fidani L: nënshkrimi i kontratës më 23.04.2025; në fazën e garancionit 1 vit, vlera e zbatuar = 493,936.40€. 3) SRP JV Hidroing-DK: Konsulent.	Banka Gjermane për Zhvillim KfW. Buxheti = 4.191.238,42€. Zbatimi = 3.629.982,26€. Progresi (%) = 86,61%	Projekt i përfunduar në Dhjetor 2025

Tabela 4. Investimet kapitale për përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore të realizuara gjatë vitit 2025 me investime vetanake dhe Grand Qeveritar

Nr.	Përshkrimi	Vlera e investimit nga mjetet vetanake	Vlera e investimit nga donacionet	Totali
1	Tokat	0	0	0
2	Objektet ndërtimore	18,617	14,928	33,545
3	Rrjeta e ujësjellësit	823,506	1,883,865	2,707,371
4	Lidhjet shtëpiake	0	0	0
5	Ujëmatësit	47,348	0	47,348
6	Paisjet e makinerisë	27,323	3,516	30,839
7	Automjetet	149,434	0	149,434
8	Paisjet IT	23,450	0	23,450
9	Paisjet e mirëmbajtjes	2,705	0	2,705
10	Paisjet për zyre	5,952	0	5,952
11	Investimet në vijim-ITUN-i	0	583,749	583,749
12	Investimet në vijim-Sanimi i rrjetit të kanalizimit të dëmtuar dhe ndërtimi i pusetave	0	6,283	6,283
13	Investimet në vijim-për kategorinë e Aseteve E,G,H.	1,891	0	1,891
14	Investimet në vijim-Ndërrimi i ujëmatësve dhe zgjerimi i rrjetit-për fsatrat Lipovec dhe Smaq 1	24,732	0	24,732
15	Investimet në vijim-Softveri i ERP-së	70,552	0	70,552
16	Investimet në vijim- Gjakova III- për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan	0	172,144	172,144
	Totali	1,195,510	2,664,485	3,859,995

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2025, nga KRU "Gjakova", nuk është kërkuar të paguajnë dividend nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2.3 TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO EKZEKUTIV

2.3.1 Emrat e drejtorëve të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes.

Urim Gashi:

Kryesues i Bordit të Drejtorëve. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025, neto – 4,674.66 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

Vildane Maloku Avdiu :

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetare e Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025 , neto – 4,452.84 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

Arianeta Nura :

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtare e Komisionit të auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025 neto - 4,145.04 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

Faton Osmani :

Anëtar i Bordit të Drejtorëve. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025 neto – 4,673.51 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

Fortuna Shaqiri Haxhikadrija :

Anëtar i Bordit të Drejtorëve. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025 neto – 3,301.01 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

Armend Behluli :

Anëtar i Bordit të Drejtorëve. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2025 neto – 3,301.01 Euro. (Janar - Dhjetor 2025).

2.3.2 Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit

Gjatë vitit 2025 Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Gjakova", Sh.A-Gjakovë ka mbajtur, Mbledhje të rregullta gjithsejtë 13 mbledhje dhe Mbledhja e përgjithshme të Aksionarit 1 mbledhje dhe 3 të jashtëzakonshme.

Mbledhjet e Bordit janë vijuar në mënyrë të rregullt nga të gjithë Drejtorët jo-Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv. Në përgjithësi vijimi i mbledhjeve vlerësohet me pjesëmarrje të rregullt të Bordit të Drejtorëve.

2.3.3 Komisioni i Auditimit, Komitet, përbërja e tyre dhe numrin e takimeve të mbajtura

Komisioni i Auditimit që nga formimi i tij ka qenë mjaft aktiv, konstruktiv dhe frytdhënës, duke shqyrtuar, diskutuar dhe duke marrë vendime shumë të rëndësishme, në aspektin e mbarëvajtjes dhe ngritjes së performancës së përgjithshme të kompanisë.

Komisioni i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsejtë 13 takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve. Në vazhdim, paraqesim në mënyrë kronologjike, takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit të cilët kanë diskutuar dhe analizuar; - Raportin financiar, për tremujorin e parë e deri në tremujorin e katërt të vitit 2025; Raporti vjetor i punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2025; - Aprovimi i planit strategjikë 2025-2027 dhe planit vjetor të Auditorit të brendshëm për vitin 2025. Konkluzionet dhe vendimet e marrura të K.A:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportet financiare të prezantuar nga Zyrtari Kryesor Financiarë të Kompanisë, mujore Tremujore dhe Vjetore, me sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna që i propozohet Bordit, Planin strategjikë të auditorit të brendshëm për vitin 2025, në bazë të propozimit të auditorit të brendshëm sipas nevojës të bëhet ndonjë auditim shtesë, aktivitetet e Auditorit të Brendshëm si dhe auditimet lidhur me raportet e tij të realizuara në bazë të Planit të punës së tyre .

3. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1. Arritjet kryesore

Si arritje kryesore vlen të theksohen :

- KRU “Gjakova ” Sh.A.- është vlerësuar në Raportin e vlerësimit të treguesve të performancës nga ARRU-ja, si kompania mjaft e suksesshme në arritjen e treguesve operativ dhe financiar të performancës, edhe pse këtë vit pa drejtësisht nuk ka rangim nga ARRU-ja.
- Raporti i vlerësimit të cilësisë së ujit të pijes nga IKSHPK -ja. Cilësia e ujit është vlerësuar e kualitetit të lartë dhe që i plotëson të gjitha kriteret e caktuara me akte nga IKSHPK .
- Vazhdimi i rritjes së numrit të portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve si dhe realizimi i Marrëveshjeve për Riprogramim të borxhit, Kontratave të shërbimit si dhe suksesi i arkëtimit të mjeteve përmes Përmbaruesve privat .
- Rritja e numrit të konsumatorëve në vitin 2025 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2024 ka rezultuar me rritje prej 2,486.
- Realizimi në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë, eliminimi në tërësi i reduktimeve të ujit, plotësimi i kërkesave për furnizim me ujë, pandërprerë për të gjitha zonat furnizuese, më orar të plotë 24 orë.
- Vazhdimi i zbulimit të keqpërdorimeve të mëdha nga konsumatorët e pandërgjegjshëm si dhe përcjellja e lendeve si Kallëzim Penal tek Prokurori i Shtetit për zhvillimin me tutje të procedurës për ngritjen e Aktakuzës. Ky aktivitet është duke ndikuar dhe në masë të madhe në zvogëlimin e numrit të keqpërdoruesve si dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit si dhe avancim në këtë drejtim të këtij treguesi të performancës ;
- Menaxhimi i mirë dhe me kohë i projekteve të implemetuara në teren edhe kundër vështirësive të paraqitura kohë pas kohe.
- Menaxhimi i mirë dhe me kohë i defekteve në zonën e shërbimit, ku vlen të theksohet se gjatë vitit 2025, kemi me pak defekte prej 82 rasteve, se në vitin paraprak 2024, kjo ndikon në uljen e kostos së mirëmbajtjes së rrjetit dhe fuqisë punëtore.

- Edhe përkundër thatësirave të mëdha dhe mungesës së reshjeve, është bërë furnizimi i gjithë zonës së shërbimit me ujë cilësor 24/7, me ndonjë përjashtim të vogël në zonat me lartësi të madhe mbidetare /kuota/.
- Menaxhimi i mirë i prodhimit dhe Raportimi te Bordi i Drejtorëve në baza javore;
- Raporti i Vlerësimit të cilësisë së ujit të pijes nga IKSHPK -ja. Cilësia e ujit është vlerësuar e kualitetit të lartë dhe që i plotëson të gjitha kriteret e caktuara me akte nga IKSHPK, duke respektuar Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2021 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.
- Koordinimi i mirë i të gjitha çështjeve me Komunitat në zonën tonë të shërbimit.
- Hartimi dhe aprovimi i Planit të Biznesit 2026-2028.
- Futjen me kohë e të dhënave në platformën Benchmark për vitin 2024.
- Futjen e të dhënave në Sistemin Informativ të Shërbimeve të ujit (SISHU).
- Përfundimi i tri projekteve madhore, të financuara nga ME dhe bashkëfinancim KRU Gjakova dhe Komunitat: Rahovec dhe Prizren.
- Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zogisht dhe Opterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit FAZA 1, Investimi është nga ME 500,000.00€, në bashkëfinancim me Komunitatën e Rahovecit 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 219,234.84€ /**vlera totale: 919,234.84€**.
- Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, dhe Medvec Faza 1. Investimi është nga ME 700,000.00€, në bashkëfinancim me Komunitatën e Prizrenit 300,000.00€ dhe KRU Gjakova 248,952.53€, /**vlera totale: 1,248,952.53€**.
- Gypi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, Medvec dhe Mamushë- Faza II, Projekti financohet nga ME, vlera financiare e projektit është: **433,214.26€**.
- Fillimi i projektit: Instalimi i ujësjellësit "Gjakova III" për fshatrat Lugbunar, Osek Hilë dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës, Investimi është nga ME 200,000.00€, në bashkëfinancim me Komunitatën e Gjakovës 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 184,277.25€, /**vlera totale: 584,277.25 €**/, i cili pritet të përfundojë deri në maj të vitit 2026.
- Furnizimi me Cisternë moderne për pastrimin e ujërave të ndotura, financiar nga KfW Gjermane;
- Furnizim me Minibus dhe automjete për çasje me të lehtë në teren;
- Aprovimi nga Bordi i Planit për Sigurinë e ujit në KRU Gjakova dhe Planit për Menaxhimin e Emergjencave /obligim Ligjor/.

3.1.1 Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit

Si çështje kyçe që kanë ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Kompanisë gjatë vitit 2025 vlen të përmendet ;

- Është mbajtur mbledhja e përgjithshme vjetore me aksionarin ku pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e ME –së ,të NJPMNP;
- Vazhdimi i implementimit të Marrëveshjes për zbatimin e projektit për eliminimin e ujërave të zeza në Komunitatën e Gjakovës. Aktivitetet në plotësimin e procedurave administrative tek autoritetet komunale dhe qeveritare për fillimin e punimeve kanë përfunduar është marrë leja e ndërtimit nga MMPH .
- Vazhdimi i Instalimit i ujëmatësve familjare në qytet dhe fshatra
- Hartimi i planeve dhe projekteve për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit të pijes, Hartimi i Projekteve për aplikimin tek aksionari–Qeveria e Kosovës,
- Dërgimi i shkresave në ME për subvencione në investime kapitale .

- Takimet me zyrtarët e Komunave me të cilën operon Kompania; Gjakovë, Rahovec dhe Prizren.
- Përgatitja e materialeve dhe e mbledhjeve të rregullta të BD. Mbajtja e mbledhjes vjetore me aksionarin së bashku me BD, menaxhimi i punëve të përditshmes bashku me menaxhmentin e kompanisë .
- Pjesëmarrje e vazhdueshme dhe e rregullt me SHUKOS dhe ARRU për; të gjeturat e raportit të inspektimit (eliminimi i faturimit pa matje) ;
- Kryeshefi Ekzekutiv gjatë vitit 2025 ka pasur aktivitete të shumta në institucione të ndryshme për interesin e Kompanisë si:
 - o në ARRU për aplikim tarifor për vitet 2026-2028
 - o në mbledhjet e rregullta të Bordit në SHUKOS që mbahen çdo muaj
 - o në takimet e rregullta me konsulentët rreth projektit të ITUN-it
 - o në takimet me kryetart e Komunave për nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëfinancim
 - o në takimet në zyret e Ministrisë së Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëfinancim (si projekti i Krushës së Madhe, Pianë, Zojz, Medvec dhe Mamushë) dhe për tema të tjera të caktuara nga Ministria
 - o në takime të ndryshme si Zyra e Kryeministrit, Banka Botërore, zyra Zvicerrane-SECO, USAID, Instituti Kosovar i Qeverisjes Lokale etj.
 - o kurse në zyrën e tij Kryeshefi Ekzekutiv z.Hasan Krasniqi ka pritur institucione të shumta si: Ramiz Kokollarin dhe Afrim Lajqin për reduktimin e humbjeve të ujit, z.Burrel Cenaj takimi ishte për nevojat e KRU-ve, veçanërisht të KRU Gjakovës, në aspektin e ngritjes profesionale, bashkëpunimit teknik dhe shkëmbimit të ideve dhe përvojave pastaj Kryetarin e Komunës së Mamushes z. Abdulhadi Krasniç. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit për furnizim me ujë të pijshëm.

3.2 PASQYRË E PERFORMANCËS OPERATIVE TEKNIKE DHE INDIKATORËT KYÇ TË PERFORMANCËS

3.2.1 Niveli i shërbimeve të ndërmarrjes (të saktësohet në vlera volumi i aktivitetit) gjegjësisht indikatorët fizik

Ardhja e ujit në Liqe

Gjatë vitit 2025, mbushja e Liqenit të Radoniqit, me ujë nga Lumi i Lumëbardhit të Deçanit, në muajt e parë të vitit, ka qenë relativisht e mirë, mirëpo nuk ka mundur të mbushet deri në kuotën maksimale, ndërsa në fund të vitit kemi prurje më të mirë i cili reflekton në mbushjen e Liqenit me ujë. Në fillim të vitit: 01.01.2025, niveli i liqenit ka qenë në kuotën 448.58. m (n.m.d), ndërsa në fund të vitit me: 31 Dhjetor 2025, niveli i liqenit ka qenë 451.14 m (n.m.d), brenda vitit kemi ngritje të nivelit të Liqenit për 2.56 m., ndërsa nga kuota maksimale 456, kemi rënie të nivelit të liqenit në total prej: -4.86 m., deri me 31.12.2025. Vëllimi i Liqenit në fillim të muajit Janar 2025, ka qenë 83,236,730 m³, ndërsa në fund të vitit me 31.12.2025 ka qenë: 91,975,420 m³, ku bazuar në shpenzimet vjetore të ujit kemi rritje të nivelit të liqenit për: **8,738,690 m³**.

Të reshurat e matura gjatë muajve Janar – Dhjetor 2025, kanë qenë: 348.80 mm/m², në krahasim me të reshurat gjatë muajve Janar – Dhjetor 2024, ku kanë qenë: 468 mm/m², kemi më pak të reshura prej: 119.6 mm/m², krahasuar me vitin 2024. Por kemi reshje më të mëdha në fund të vitit 2025, krahasuar me vitin 2024.

Nga data: 24.04.2025, ka filluar marrja e ujit nga liqeni i Radoniqit nga KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A, dhe gjatë muajit Shtator 2025 ka marr gjithsejt ujë nga Liqeni 5,009,275 m³, në total deri me 30.09.2025 dhe nga 01.10 – 03.10.2025 ka marrë ujë: 184,014m³. Gjatë vitit 2025, ka marr ujë gjithsejt: 38,166,821 m³, krahasuar me vitin e kaluar 2024, 36,549,213m³, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.a, gjatë kësaj periudhë ka marr ujë më tepër për: **+1,617,608m³**. Ndërprerja e ujit për ujitje është bërë me datë 03.10.2025.

Prodhimi i ujit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, prodhimi i ujit është realizuar në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë. Prodhimi i ujit ishte normal dhe i ka plotësuar kërkesat për furnizim me ujë, pandërprerë për të gjitha zonat furnizuese, më orar të plotë 24/7 orë, në përjashtim të muajit Gusht, ku për shkak të keqpërdorimeve të ujit kemi pasur reduktime të vogla nëpër zonat rurale.

Në vitin 2025, është prodhuar **16,211,843 m³**, sasi kjo më e lartë për: 61,741m³, në krahasim me Planin e Biznesit të vitit 2025, ku prodhimi ka qenë i planifikuar: 16,150,102 m³, nga kjo sasi e prodhuar e vitit 2025, janë faturuar gjithsejtë: 8,300,018 m³, ndërsa uji i pa faturuar UPF ka qenë: 7,911,825 m³, apo shprehur në përqindje humbja ka qenë 48.80%, kemi rritje të humbjeve nga planifikimi në Planin e Biznesit 2025, për 0.86%. Në këtë prodhim të raportuar janë të dhënat edhe për burimet e ujit në: Hoqë të Madhe, Ofterushë, Senoc, Drenoc, Damjan, Greqinë dhe Reka e Keqe. Kërkesën e furnizimit të konsumatorëve me ujë të pijshëm pa ndërprerje për të gjitha zonat 24 orë, në ditë e kemi arritur 100 %.

Tabela 5 - Uji i prodhuar, faturuar, UPF dhe humbjet gjatë vitit 2025, krahasuar me 2024 dhe BP 2025

Treguesit	Viti 2025	Viti 2024	Ndryshimi	%	Viti 2025	PB 2025	Ndryshimi	%
Prodhimi m³	16,211,843	16,202,875	8,968	0.06%	16,211,843	16,150,102	61,741	0.38%
Faturimi m³	8,300,018	8,434,845	-134,827	-1.62%	8,300,018	8,755,005	-454,987	-5.48%
Pa faturuar m³	7,911,825	7,768,030	143,795	1.82%	7,911,825	7,395,097	516,728	6.53%
% humbjes	48.80%	47.94%	0.86%		48.80%	45.79%	3.01%	

Prodhimi i ujit -ka rritje duke krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, për 8,968 m³, ndërsa krahasuar me Planin e Biznesit Janar -Dhjetor 2025, ka rritje për 61,741 m³.

Faturimi i ujit -në m³ në periudhën Janar-Dhjetor 2025, është më i ulët për 134,827 m³ se Janar- Dhjetor i vitit 2024, dhe për 454,987 m³ është më i ulët se Plani i Biznesit Janar-Dhjetor 2025.

Humbja e ujit -në periudhën Janar-Dhjetor 2025 është 48.80%, për 0.86% më i lartë se Janar- Dhjetor i vitit 2024, dhe për 3.01 % më i lartë se Plani i Biznesit Janar-Dhjetor 2025.

Diagrami - Uji i prodhuar, faturuar, UPF dhe humbjet 2025, krahasuar me 2024 dhe PB 2025




Tabela 6 - Uji i prodhuar gjatë vitit 2025 krahasuar me PB 2025

Vitet	2025				Plani i Biznesit 2025				
	Prodhimi	Faturimi	UPF	%	Prodhimi	Faturimi	UPF	%	Ndryshimi
Muajt									
Janar	1,271,352	621,337	650,015	51.13	1,300,150	702,841	597,309	45.94	5.19
Shkurt	1,109,555	556,641	552,914	49.83	1,140,050	606,489	533,561	46.80	3.03
Mars	1,183,710	538,254	645,456	54.53	1,230,334	627,325	603,009	49.01	5.52
Prill	1,118,546	602,527	516,019	46.13	1,280,871	675,853	605,018	47.23	-1.10
Maj	1,249,409	653,924	595,485	47.66	1,254,970	677,045	577,925	46.05	1.61
Qershor	1,562,624	691,286	871,338	55.76	1,390,320	667,981	722,339	51.95	3.81
Korrik	1,749,228	849,636	899,592	51.43	1,591,638	774,755	816,883	51.32	0.10
Gusht	1,654,228	1,010,951	643,277	38.89	1,601,257	999,308	601,949	37.59	1.29
Shtator	1,471,719	828,249	643,470	43.72	1,380,150	858,273	521,877	37.81	5.91
Tetor	1,327,802	725,059	602,743	45.39	1,320,252	709,006	611,246	46.30	-0.90
Nëntor	1,211,243	627,526	583,717	48.19	1,310,110	709,208	600,902	45.87	2.33
Dhjetor	1,302,427	594,628	707,799	54.34	1,350,000	746,921	603,079	44.67	9.67
Totali:	16,211,843	8,300,018	7,911,825	48.80	16,150,102	8,755,005	7,395,097	45.79	3.01

Gjatë vitit 2025, raportimi i prodhimit është bërë në baza ditore dhe javore i cili raport është dërguar edhe të Bordi i Drejtorëve. Departamenti Teknik, periudhën e raportimit e mbyll çdo herë me datën 01 të çdo muaji në vijim.

Rritja e humbjeve në m³, ndodhë si pasoj e rrjetit të amortizuar me një vjetërsi shumë të madhe, defektet në rrjetin e ujësjellësit, leximi jo i saktë dhe i jo i rregullt i ujëmatësve nga inkasantët te disa konsumatorë, ujëmatësit e vjetruar mbi 10-30 vjeçar, keqpërdorimet në rrjet nga ana e konsumatorëve, kyçje ilegale nga disa konsumator të pandërgjegjshëm, dhe rënia e faturimit në m³.

Kualiteti i ujit të pijes -2025

Uji i prodhuar nga Impianti i trajtimit të ujit të pijes -ITUP, në vazhdimësi është nën kontroll dhe i plotëson standardet e kërkuara nga rregullorja për kualitet të ujit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (I.K.SH.P). Aktivitetet e laboratorit përfshijnë marrjen sistematike të mostrave dhe realizimin e analizave fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit në pika të ndryshme të sistemit të furnizimit, duke filluar nga burimi i ujit, procesi i trajtimit në impiant, rezervuarët e shpërndarjes dhe deri në rrjetin e shpërndarjes tek konsumatorët. Programi i monitorimit realizohet sipas planeve të përcaktuara të kontrollit të cilësisë së ujit dhe në përputhje me kërkesat e autoriteteve kompetente për shëndetin publik.

Duke u bazuar në numrin e mostrave bakteriologjike dhe mostrave kimike gjatë tremujorit, uji ka qenë sipas normativës së kërkuar për të gjitha zonat furnizuese të KRU "Gjakova", duke respektuar Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2021 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu. Në laboratorin e Stacionit të Filtrimit janë bërë po ashtu analizat interne për kontrollin e kualitetit të ujit.

Analizat fiziko kimike bëhen çdo 2 orë/24 orë pa ndërprerë, gjithashtu edhe ato bakteriologjike, si dhe marrja e mostrave në rrjetin furnizues (analizat bakteriologjike dhe fiziko kimike në 12 pikat kryesore, nga pika më e afërt deri të pika e fundit).

Mostrat merren në rrjetin e Qytetit të Gjakovës, Rahovecit, furnizimi i fshatrave në Prizren dhe burimet tjera si (Damjan, Greqinë, Opterushë, Drenovc, Senoc dhe burimi Batushë).

Tabela 7. Analizat e Ujit nga ISHP-Gjakovë, Prizren, Rahovec dhe laboratorin e stacionit të filtrave, gjatë muajve Janar- Dhjetor 2025, krahasuar me muajt e njëjtë të vitit 2024:

Janar-Dhjetor 2025	2025	2024	Ndryshimi
Bakteriologjike	1,050	1,029	+21
Fiziko Kimike	2,540	2,964	--424
Totali:	3,590	3,993	--403

Përveç raportimit të rregullt mujor, mbetemi të përkushtuar ndaj monitorimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë dhe përmirësimit të mëtejshëm të transparencës në raportim, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale, ku aktualisht jemi duke punuar në konfigurimin e të dhënave për seksionin "Kualiteti i Ujit" për vitin 2025, në Sistemin Informativ të Shërbimeve të Ujit (SISHU).

Tabela 8 - Analizat e Ujit gjatë muajit Janar –Dhjetor 2025, krahasuar me vitin 2024:

Vitet	2025			2024			2025/2024
Muaji	Analizat Mikrobiologjike	Analizat Fiziko-Kimike	Total 2025	Analizat Mikrobiologjike	Analizat Fiziko-Kimike	Total 2024	Ndryshimi
Janar	83	242	325	79	260	339	-14
Shkurt	89	191	280	83	248	331	-51
Mars	100	230	330	81	241	322	8
Prill	97	236	333	96	275	371	-38
Maj	84	217	301	87	240	327	-26
Qershor	85	204	289	76	239	315	-26
Korrik	102	231	333	82	260	342	-9
Gusht	70	158	228	86	219	305	-77
Shtator	93	204	297	93	249	342	-45
Tetor	78	216	294	103	266	369	-75
Nëntor	86	213	299	82	213	295	4
Dhjetor	83	198	281	81	254	335	-54
Totali:	1,050	2,540	3,590	1,029	2,964	3,993	-403

Gjatë tremujorit parë Janar-Mars 2025, gjithsejtë 10 mostra fiziko-kimike, kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit – fshati Greqinë, për shkak të turbicitetit.

Gjatë tremujorit dytë Prill-Qershor 2025, gjithsejtë 2 mostra fiziko-kimike, kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit – fshati Greqinë, dhe Zonën e Furnizimit Opterushë për shkak të turbicitetit.

Gjatë tremujorit tretë Korrik-Shtator 2025, gjithsejtë 4 mostra fiziko-kimike, kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit – fshati Greqinë, dhe Zonën e Furnizimit Opterushë për shkak të turbicitetit.

Gjatë tremujorit katërt Tetor-Dhjetor 2025, 10 mostra, kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit RA-10 - Gërquinë, RA-04-Damjan dhe RA-08-Senoc, për shkak të reshjeve atmosferike dhe problemeve me energji elektrike. 9 mostra kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit RA-09 - Greqinë, RA - 04-Damjan dhe RA - 06 - Opterushë, dhe 2 mostra kanë rezultuar të dështuara në Zonën e Furnizimit RA-02 në fshatin Çifllak. Në total: 37 mostra të dështuara gjatë vitit.

Laboratori funksionon në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, duke zbatuar procedura të dokumentuara për menaxhimin e cilësisë, kontrollin e pajisjeve laboratorike, sigurimin e gjurmueshmërisë së matjeve, si dhe verifikimin dhe validimin e metodave analitike.

Në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë, laboratorit është në proces të aplikimit për riakreditim pranë Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës, duke përditësuar dokumentacionin teknik, procedurat operative standarde (SOP), si dhe duke verifikuar përputhshmërinë e metodave analitike me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017. Ky proces përfshin gjithashtu vlerësimin e kompetencës së stafit laboratorik, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike, si dhe demonstrimin e aftësisë teknike për kryerjen e analizave të akredituara.

Gjatë muajit Gusht është realizuar vlerësimi i gjendjes ekologjike e liqenit nga ekspertë të jashtëm. Rezultatet treguan se cilësia e ujit në përgjithësi është e mirë deri në të lartë, me një komunitet të pasur algash diatomike që tregojnë ujë relativisht të pastër dhe të përshtatshëm për furnizim me ujë të pijshëm. Bazuar në këto rezultate, është rekomanduar zgjerimi i hulumtimeve në më shumë pika të liqenit, për të siguruar një vlerësim më të plotë të cilësisë së ujit.

Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit 2025

Ekipi i mirëmbajtjes së rrjetit të ujit të pijes në tërë sistemin që përfshinë qytetin e Gjakovës me Fshatra si dhe Njësinë e Rahovecit, Njësinë e Prizrenit dhe Rekën e Keqe, me angazhim të plotë dhe përkujdesje e ka bërë mirëmbajtjen e rrjetit dhe eliminimin e defekteve që paraqiten në rrjetë ku kryesisht janë defekte të natyrave të ndryshme dhe dimensioneve të ndryshëm e në rastet më të shpeshta janë defektet në rrjetin nga materiali i Azbest-Cementit.

Defektet gjatë këtij viti janë kryer me kohë sidomos është respektuar koha e kryerjes së defekteve që të jetë sa më e shkurtë në mënyrë që të ndikohet në zvogëlimin e humbjeve që janë akoma të larta.

Gjatë vitit 2025, kemi pasur paraqitje të defekteve me shumë të natyrave me të vogla se < 63 mm, por edhe një numër të vogël të defekteve >63 mm, si pasojë e punimeve dhe zgjerimit të rrugëve në hyrje/dalje të qytetit të Gjakovës, ku fal ekipeve të mirëmbajtjes në teren, defektet janë sanuar në afatin e duhur kohor.

Ekipet e mirëmbajtjes edhe përkundër riparimit të defekteve me kohë, kanë qenë të angazhuar në punë edhe jashtë orarit të punës në mirëmbajtjen e rrjetit.

Gjatë vitit 2025, janë bërë instalime të reja në rrjet por edhe ndërrim i gypave aty ku kemi pasur defekte me të shprehura gjatë vitit me mjete vetanake, si në tabelë më poshtë: 1,236m, instalim i ri, ndërsa 1,508m, ndërrim rrjeti, në total: 2,744 m.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2025, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit rrjet primar dhe sekondar të regjistruar në ArcGIS **1,363,829 m, apo 1,364 km**. Gypa që furnizohen nga liqeni i Radoniqit: 1,061,057 m, dhe gypat që furnizohen nga burimet: 300,772 m.

Defektet e poshtëshënuara janë si pasojë e rrjetit të vjetërsuar të ujësjellësit apo edhe instalimeve të gypave jo kualitativ nga Operatorët e ndryshëm ekonomik.

Tabela 8–Totali i Numrit të defekteve në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, sipas Ø

Vitet	2025			2024			
Muajt	Nën 2 coll	Mbi 2 coll	Gjithsejtë defekte	Nën 2 coll	Mbi 2 coll	Gjithsejtë defekte	Ndryshimi
Janar	174	20	194	168	33	201	(7)
Shkurt	175	13	188	203	31	234	(46)
Mars	180	21	201	198	35	233	(32)
Prill	197	44	241	190	28	218	23
Maj	186	22	208	226	36	262	(54)
Qershor	228	26	254	196	34	230	24
Korrik	268	47	315	261	44	305	10
Gusht	284	31	315	221	46	267	48
Shtator	258	40	298	246	44	290	8
Tetor	208	31	239	269	23	292	(53)
Nëntor	164	25	189	178	31	209	(20)
Dhjetor	162	35	197	159	21	180	17
Totali:	2,484	355	2,839	2,515	406	2,921	(82)

Tabela 8–Totali i Numrit të defekteve të paraqitura sipas Nj. O. në zonën e shërbimit:

Muaji	Gjakovë Fshatrat		Gjakovë Qyteti		Gjithsejtë Nj.O. Gjakovë		Reka e Keqe		Nj.O. Rahoveci		Nj.O. Prizreni		Gjithsejtë		Totali i defekteve
	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	nën 063	mbi 063	Σ
Janar	61	7	34	3	95	10	5	1	47	2	27	7	174	20	194
Shkurt	59	3	45	2	104	5	6	1	37	2	28	5	175	13	188
Mars	72	3	44	12	116	15	5	1	21	0	38	5	180	21	201
Prill	68	23	46	9	114	32	9	1	45	1	29	10	197	44	241
Maj	53	5	38	6	91	11	9	2	58	1	28	8	186	22	208
Qershor	71	9	41	4	112	13	9	0	77	10	30	3	228	26	254
Korrik	70	11	50	14	120	25	15	3	98	7	35	12	268	47	315
Gusht	83	10	52	3	135	13	13	6	81	7	55	5	284	31	315
Shtator	95	11	52	15	147	26	16	2	46	4	49	8	258	40	298
Tetor	75	13	48	6	123	19	5	0	38	6	42	6	208	31	239
Nentor	47	5	53	5	100	10	8	3	26	3	30	9	164	25	189
Dhjetor	61	5	37	11	98	16	7	2	25	12	32	5	162	35	197
Gjithsejtë:	815	105	540	90	1355	195	107	22	599	55	423	83	2484	355	2839

Gjatë periudhës 12 mujore, kemi një ulje të numrit të defekteve për **82 raste**, krahasuar me 12 mujorin e vitit të kaluar 2024, gjë që ka ndikuar edhe në zvogëlimin e kostos së mirëmbajtjes.

Mirëmbajtja dhe ndërrimi i ujëmatësve 2025

Gjatë muajit Janar - Dhjetor 2025, kemi pasur më shumë defekte në dëmtimin e ujëmatësve për shkak të kushteve atmosferike, por prezantojmë rastet kur punëtorët tonë apo edhe konsumatorët, lajmërojnë rastet e prishjeve, bllokimit të ujëmatësve nga copat e gurit, thyerje të ndonjë dhëmbëzori, bllokimi në zonat e ulëta nga zalli, si dhe ndërrimi i xhamave etj.

Në kemi filluar edhe me ndërrimin e ujëmatësve, të cilat gjinden në defekte apo nuk bëjnë matjen e duhur pas vlerësimit të kontrollës dhe çkyçjes, por edhe instalimin e ujëmatësve të ri në lidhje të reja, ku për herë të parë sipas Rregulloreve të ARRU-së, e blenë vetë konsumatori sipas standardeve të kërkuara, dhe deri në fund të muajit Dhjetor, janë ndërruar/zëvendësuar si më poshtë:

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, është ndërruar dhe riparuar kjo sasi e ujëmatësve, por janë vendosur ujëmatës edhe te konsumatorët të cilët nuk kanë pasur ujëmatës dhe janë faturuar paushall.

Tabela 9-Ujëmatës të rinj dhe të pastruar gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024

Vitet	2025				2024			
Muajt	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave	Total	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave	Total
Janar	58	-	1	59	73	2	1	76
Shkurt	73	2	2	77	85	9	1	95
Mars	45	6	-	51	71	2	-	73
Prill	47	3	1	51	84	2	-	86
Maj	44	2	1	47	53	-	1	54
Qershor	63	6	1	70	36	-	1	37
Korrik	52	1	-	53	50	-	-	50
Gusht	57	6	1	64	61	-	19	80
Shtator	72	2	-	74	53	-	1	54
Tetor	57	10	1	68	80	-	-	80
Nëntor	81	6	-	87	54	2	1	57

Dhjetor	73	5	4	82	67	6	-	73
Totali:	722	49	12	783	767	23	25	815

Mirëmbajtja e rrjetit të Kanalizimit -Ujërat e ndotura 2025

Përveç furnizimit me ujë të pijshëm KRU "Gjakova" bënë shërbime për menaxhimin dhe largimin e ujërave të ndotura, me një rrjet prej 95.6 km, ku prej tyre janë të digjitalizuara në ArcGIS: 92.226 km apo 95.5 % si në vijim: Gjakovë 73.6 km, rrjet i kanalizimit fekal i cili është i digjitalizuar 100 %, dhe Rahoveci 23 km, rrjet kanalizimi fekal, ku prej tyre janë të digjitalizuar 18.866 km, apo 82.03 %. Në kuadër të rrjetit kemi edhe 2,825 puseta të kanalizimit fekal dhe 1,368 puseta të kanalizimit atmosferik.

Gjithashtu në baza mujore bëhet pastrimi dhe kontrollimi i impiantit të ujërave të zeza në Kramovik. Ekipi e mirëmbajtjes së kanalizimit ka pasur intervenime dhe angazhim në sanimin e bllokimeve dhe funksionalizimin e rrjetit të kanalizimit. Për shkak të reshjeve gjatë vitit, ekipi ka pasur më shumë angazhime në deblokimin e kanalizimit.

Është intervenuar në sanimin e rrjetit të kanalizimit si rast emergjent për shkak të depërtimit të betonit në rrjet në rrugën "Nëna Terezë".

Tabela 10- Intervenimet në rrjetën e Kanalizimit Fekale gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2025, krahasuar me vitin 2024

Janar - Dhjetor 2025	Pastrimi i rrjetit (m)	Pastrimi i pusetave	Intervenim me cisternë	Janar - Dhjetor 2024	Pastrimi i rrjetit (m)	Pastrimi i pusetave	Intervenim me cisternë	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi
Gjakovë	39,852	888	606	Gjakovë	44.160	927	583	39,808	-39	23
Rahovec	6,495	228	77	Rahovec	1.420	446	128	6,494	-218	-51
Totali:	46,347	1,116	683	Totali:	55.580	1.373	711	46,301	-257	-28

Gjatë vitit 2025, janë bërë hulumtime në teren nga Inxhinierja e Ujërave të Ndotura dhe Industriale, ku qëllimi ka qenë të bëhet identifikimi i ndotësve të ndryshëm në zonën e shërbimit duke kontaktuar dhe duke kërkuar nga operatorët; Industrial, biznese, Institucional, që të plotësojnë pyetësin, duke marrë të gjitha informatat e përgjithshme që na nevojiten për hapat e më tejshëm në marrjen e mostrave dhe llogaritjen e shkallës së ndotjes dhe përbërësit kimik në ndotje.

Gjatë vitit janë identifikuar:

- Ndotës Komercial – 20 biznese;
- Ndotës Industrial – 15 biznese;
- Ndotës Institucional – 5 Institucione;
- Ndotës pompa të benzinës dhe autolarjet – 20 ndotës.

Me qëllim që pastrimi i ujërave të ndotura të plotësojë kriteret e parapara me ligjet në fuqi, për këtë veprimtari, është përgatitur një pyetësorë që ka për qëllim vetëm marrjen e informacioneve që lidhen me shkarkimin e ujërave të ndotura nga aktivitetet ekonomike–biznesore në rrjetin e kanalizimit ose edhe shkarkimet direkte në lumenj apo rrjedha ujore.

- Mbikëqyrja e gjendjes së pajisjeve laboratorike dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Verifikimi i kushteve higjienike dhe masave të sigurisë në laborator.
- Bashkëpunimi me teknikët për përgatitjen e tretësirave kimike për analizat laboratorike.
- Përgatitja e raporteve ditore për aktivitetet e kryera.
- Diskutimi i rezultateve me Menaxheren e Cilësisë dhe propozimi i përmirësimeve të mundshme.

Gjatë kësaj periudhe janë informuar dhe anketuar 102 biznese në rajonin e Gjakovës. Është bërë

identifikimi i ndotësve varësisht nga natyra e biznesit të cilën këto biznese operojnë (industrial, institucionale, komerciale, pompa të benzinës, autolarje), ku deri me tani 94 biznese i kanë plotësuar pyetësorët, prej 102 bizneseve.

Identifikimi i ndotësve dhe materialet e mbledhura janë në kopje fizike dhe të gjitha janë të klasifikuara në tabela.

Pastaj ka vazhduar me zgjedhjen e ndotësve të cilët janë identifikuar (industrial, institucionale, komerciale, pompa të benzinës, autolarje,) me ç'rast me datën: 22.06.2025, ka filluar marrjen e mostrave dhe llogaritjen e shkallës së ndotjes dhe përbërësit kimik në ndotje.

Disa prej shkarkuesve të cilët janë përzgjedhur për këtë fazë janë: industrial, institucionale, komerciale, pompa të benzinës duke i konsideruar si veprimtari më të përshtatshme për fazën e parë si dhe për procesin e mostrimit .

Aktivitetet e realizuar gjatë muajit Janar - Dhjetor 2025 në ITUN

Operimi dhe mirëmbajtja ditore: Gjatë vitit, është siguruar funksionimi i pandërprerë i procesit përmes monitorimit, mirëmbajtjes dhe rregullimit ditor të pajisjeve mekanike, elektrike dhe sistemeve biologjike, në përputhje me manualët operacionale. Janë trajtuar dhe eliminuar defektet e hasura gjatë ditës, si në aspektin mekanik ashtu edhe në atë elektrik, duke garantuar stabilitet të procesit.

Mirëmbajtja e hapësirave dhe objekteve: Janë realizuar punët e rregullta të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe ambientit përreth ITUN-it, duke përfshirë mirëmbajtjen e njësive operuese dhe kanaleve, si dhe larjen e sipërfaqeve sipas nevojës. Është bërë pastrimi dhe kalibrimi i sensorëve të nivelit dhe oksigjenit, larja e sedimentuesve, si dhe pastrimi i pompave të influentit, rërës dhe llumit, grilave të trasha dhe të imëta dhe shiritave transportues.

Procesi i trajtimit ka shkuar mirë, nga mostrat reprezentative të marrura në mënyrë automatike 24/7 janë përbushur të gjithë parametrat e efluentit të përcaktuar në UA (MMPHI) Nr. 02/2022:

Tabela 11–Sasia totale e ujit të trajtuar 2025

Qtot. m ³ aver.	Qtot. m ³ tot.	Qaver. m ³	Qmin. m ³	Qmax. m ³
251,728	3,020,730	7,550	5,973	9,314

INFLUENT (uji i ndotur)	COD mes, mg/l	COD min, mg/l	COD max, mg/l
	330	266	436
	BOD mes, mg/l	BOD min, mg/l	BOD max, mg/l
	167	126	211
	TSS mes, mg/l	TSS min, mg/l	TSS max, mg/l
	105	74	156
EFLUENT (uji i trajtuar)	COD mes, mg/l	COD min, mg/l	COD max, mg/l
	15	15	21
	BOD mes, mg/l	BOD min, mg/l	BOD max, mg/l
	8	6	10
	TSS mes, mg/l	TSS min, mg/l	TSS max, mg/l
	4	3	7

	COD, mg/l	BOD, mg/l	TSS, mg/l
Reduktimi mes., %	95	94	95

SASIA E MBETJEVE NGA GRILAT E TRASHA		SASIA E MBEJTJEVE NGA GRILAT E IMËTA	
Sasia e prodhuar e mbetjeve të trasha, m ³	2	Sasia e prodhuar e mbetjeve të imëta, m ³	1

Sasia e prodhuar e mbetjeve të trasha, m ³ total	24	Sasia e prodhuar e mbetjeve të trasha, m ³ total	12
SASIA E RËRËS		SASIA E RËRËS	
Sasia e rërës së prodhuar, m ³ mes.	3	Sasia e yndyrës së prodhuar, m ³ mes.	1
Sasi e rërës së prodhuar, m ³ total	37	Sasia e yndyrës së prodhuar, m ³ total	12

Disa nga aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në ITUN

Me datë 24.01.2025, është bërë kërkesa për kryerjen e analizave të llumit, e paraparë sipas planit të prokurimit për vitin 2025. Me datë 31.01.2025, është bërë furnizim i pjesshëm me pajisje rezervë për SCADA.

Në kuadër të bashkëpunimit të KRU Gjakova me Ministrinë e Mbrojtjes, zv. Ministri Shemsi Syla, ndër vizitat e bëra në objektet e KRU Gjakova, vizitoi edhe ITUN-in.

Me datë 18.02.2025, është kryer mostrimi nga OE për analiza të llumit, sipas kontratës së tenderit “Kryerja e analizave të llumit të ITUN.

Me datë 06.03.2025, janë pranuar analizat e llumit nga OE, sipas kontratës së tenderit “Kryerja e analizave të llumit të ITUN. Analizat kanë rezultuar të jenë konform parametrave të përcaktuar tek Ligji për Mbeturina (Nr. 04/L-060) dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 29/2014 për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.

Me datë 10.04.2025 në kuadër të angazhimeve të Grupit Punues për Lobim dhe Avokim për iniciimin e Hartimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Llumit, u realizua një vizitë studimore në ITUN. Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte të shqyrtohet nga afër procesi aktual i menaxhimit të llumit nga ITUN-et ekzistuese në Kosovë. Në këtë vizitë morën pjesë anëtarë të grupit punues për lobim nga MMPHI, SHUKOS, IKSHPK, OJQ dhe konsulentët e angazhuar.

Me datë 29.04.2025 vizituan ITUN-in nxënësit e shkollës së mesme profesionale SH.M.P. “Fehmi Lladrovci” nga Drenasi, të cilët u njoftuan nga afër me proceset që zhvillohen në ITUN.

Mungesa e stafit në ITUN (inxhinier i elektrikes/mekanikës, mekanik) është duke paraqitur pengesë të vazhdueshme në punën e rregullt të punëtorëve dhe gjithashtu tejkalimin e normës së orëve të punës gjatë zëvendësimeve.

Gjatë muajit Maj, është kryer pastrimi dhe Servisimi i të gjithë kondicionerëve në ndërtesat e ITUN.

Më datë 20.05.2025 është bërë ndërrimi i vajit të dy ajruesve sipërfaqësorë në rezervuarin e llumit aktiv. Shtimi i stafit në ITUN: Angazhimi i një inxhinieri të elektrikes/mekanikës dhe i një mekaniku është i domosdoshëm për mbarëvajtjen e punës së rregullt, koordinimin e punëtorëve, si dhe për përballimin e tejkalimit të orarit të punës gjatë zëvendësimeve.

Me datë 03-04-05.06.2025, është bërë largimi i llumit për në deponi nga KRM “Çabrati” sipas marrëveshjes. Më datë 18.06.2025, është shfaqur një defekt në sistemin SCADA, ku paneli elektrik kryesor MCC2 ka humbur komunikimin me serverin, SCADA-n, kabllon optike dhe switch-in. Defekti është riparuar nga elektrikisti i ITUN.

Për shkak të temperaturave të larta gjatë muajit korrik, janë ndërmarrë masa shtesë në operim dhe mirëmbajtje, veçanërisht në pjesën biologjike të procesit. Këto masa kanë përfshirë aktivizimin e ajruesve për orë shtesë si dhe ri qarkullim më të shpeshtë të ujit teknik (uji i trajtuar).

Gjatë muajit korrik, në kuadër të përgatitjes së dokumentacionit tarifor për periudhën 2026–2028, janë

hartuar dhe dorëzuar planifikimet për investimet infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore për njësinë e ITUN.

Më datë 14.07.2025, është shfaqur një defekt në sensorin e oksigjenit në rezervuarin e ajrimit me llum aktiv. Zëvendësimi i sensorëve të detektimit për ITUN është i paraparë në planin e prokurimit për periudhën 2025/2026/2027.

Më datë 11.08.2025, motori i mikserit nr. 1 në rezervuarin e ajrimit me llum aktiv pësoi defekt dhe u dërgua për mbështjellje. Pas rikthimit, më 01.09.2025, ai u montua nga stafi i ITUN dhe aktualisht është në funksion, ndërsa puna e tij po monitorohet nëpërmjet sistemit SCADA.

Më datë 20.08.2025, është përgatitur dhe dërguar dosja e tenderit për "DDD (Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim) për të gjitha objektet e ITUN."

Më datë 25.08.2025, laboratorin e ITUN është furnizuar nga OE, sipas kërkesës për nevojat e ITUN-it.

Në mënyrë të vazhdueshme vërehen prurje të konsiderueshme të pecetave të lagura në rrjetin e kanalizimit, të cilat në sasi të mëdha ndalen në rrjetat ndarëse në ITUN. Problematika është se ato shkaktojnë bllokime dhe akumulim në pajisjet e ITUN, duke detyruar pastrim më të shpeshtë të pompave dhe pajisjeve të tjera dhe duke rritur rrezikun për defekte. Kjo dukuri është më e theksuar sidomos gjatë sezonit të verës.

Më datë 26.11.2025, në kuadër të SHUKOS me Programin për Zhvillim të Kapaciteteve "Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimin e Ujërave të Zeza për Menaxherë dhe Inxhinierë", është mbajtur dita e tretë e trajnimit në ambientet e ITUN-it. Në trajnim morën pjesë edhe përfaqësues nga ndërmarrjet e ujësjellësve në Kosovë, të cilët pritët të menaxhojnë impiante të ardhshme të trajtimit të ujërave të ndotura. Trajnimi u realizua me sukses, duke ofruar kushte adekuate për sesionet praktike dhe shkëmbimin e përvojave teknike.

Me datë 02.12.2025, ka pasur vizitë në ITUN nga zyrtarët e KfW, ku është bërë përmbyllja e fazës V dhe VI duke përfshirë këtu edhe murin mbrojtës të ITUN rreth lumit Erenik.

Me datë 03.12.2025, mikseri në rezervuarin e ajrimit ka pasur defekt. Me datë 04.12.2025 motori i mikserit është dërguar për servisim, ndërsa me datë 17.12.2025 është montuar dhe vënë në funksion normal.

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë vitit 2025, kanë hartuar dhe mbikeqyrë disa projekte:

Projektet që janë mbikëqyrur gjatë implementimit të vitit 2025

Nr.	Emri i projektit	Vlera financiare/€	Realizuar
1	Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit <u>faza 1</u> .	ME 500,000.00€, Komuna e Rahovecit 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 219,234.84€ Gjithsejtë: 919,234.84€	2024/2025
2	Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, Medvec dhe Komuna Mamushës <u>faza 1</u> .	ME 700,000.00€ Komuna e Prizrenit 300,000.00€ dhe KRU Gjakova 248,952.53€ Gjithsejtë: 1,248,952.53€	2024/2025
3	Gypi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, Medvec dhe Mamushë- FAZA II,	Projekt i financuar nga Ministria e Ekonomisë 449,964.26€ Gjithsejtë: 433,214.26€	2025
4	Ndërtimi i rrjetit dhe stacionit të pompave shtytëse për SPK në Qafë Morinë – Ritender-2	KRU Gjakova:34,538.60€ dhe Policia e Kosovës:33,184.15€ Gjithsejtë:67,722.75€	2024/2025

5	Rehabilitimi i ujësjellësit për fshatrat Ratkoc dhe Bratotin	KRU Gjakova: 30,584.088€ dhe Komuna e Rahovecit: 29,384.712€. Gjithsejtë: 59,968.80€	2025
6	Ndërrimi i gypit furnizues nga stacioni i pompave Pataqan i ulët deri te rezervuari Pataqan i Epërm	Vetëfinancim KRU Gjakova: 108,446.58€. Gjithsejtë:108,446.58€	2025
7	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rr. Ymer Pula dhe në 4 fshatrat të komunës së Gjakovës	Vetëfinancim KRU Gjakova: 113,535.64€. Gjithsejtë:113,535.64€	2025
8	Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP- Ritender	Vetëfinancim KRU Gjakova: 6,272.30€. Gjithsejtë: 6,272.30€.	2025
9	Renovimi i objekteve administrative	Vetëfinancim KRU Gjakova: 7,856.86€. Gjithsejtë: 7,856.86€.	2025
10	Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës	ME 200,000.00€ Komuna e Gjakovës 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 184,277.25€ Gjithsejtë: 584,277.25€	2025/2026
11	Sanimi i rrjetit të kanalizimit si rast emergjent në rrjetin e kanalizimit në rrugën Nëna Terezë	Vetëfinancim KRU -Pjesa e parë: 44,847.00€. - Pjesa e dytë: 52,548.41€ Gjithsejtë: 97,395.41€	2025
12	Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec,dhe Smaq 1-faza 2	Vetëfinancim KRU Gjakova: 44,616.58€. Gjithsejtë: 44,616.58€.	2025/2026
13	Instalimi i ujëmatësve jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashengjergj të Komunës së Prizrenit	Vetëfinancim KRU Gjakova: 32,821.00€. Gjithsejtë:32,821.00€	2025/2026
14	Sanimi i rrjetit të kanalizimit nëpër rrugë të ndryshme, në gypat e dëmtuar dhe ndërtimin e pusetave	Vetëfinancim KRU Gjakova: 56,485.00€. Gjithsejtë: 56,485.00€.	2025/2026
15	Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve në teren, në tërë Njësit e KRU Gjakova	Vetëfinancim KRU Gjakova: 26,600.00€, Gjithsejtë: 26,600.00€,	2025/2026
16	Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë Faza V-VI 3) Rehabilitimi i Rrjetit të Ujërave të Ndotura, 4) Furnizimi i Autocisternës për mirëmbajtje të Rrjetit të Ujërave të Ndotura, 3) Ndërtimi i Argjinatures për mbrojtjen e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) nga vërshimet e lumit Erenik	Banka Gjermane për Zhvillim KfW. Buxheti = 4.191.238,42€. Zbatimi = 3.629.982,26€. Progresi (%) = 86,61%	2024/2025

Punët e realizuara gjatë muajit Janar – Dhjetor 2025, nga Sektori për Planifikim dhe Zhvillim

- Janë bërë vendime dhe zgjidhje teknike për caktimin e vendit të kyçjeve, për konsumatorë të rinjë, të cilët kanë bërë kërkesë gjatë muajit Janar -Dhjetor 2025.
- Kemi bërë shqyrtimin e kërkesave për dislokim të ujëmatësve për muajit Janar -Dhjetor 2025.
- Kemi bërë shqyrtimin e kërkesave për dislokim të lidhjeve ekzistuese për muajt Janar-Dhjetor 2025, dhe legalizimin e lidhjeve ekzistuese për muajin Janar -Dhjetor 2025.

- Kemi bërë raportin e komisionit për pranim e shërbimeve për mbikëqyrje dhe monitorimi i stacionit të pompave për zonat rurale për nevojat e KRU Gjakova sh.a.
- Jemi angazhuar në zyrën e prokurimit si komision për tenderin e shitjes përmes ankandit të mjeteve jashtë përdorimit.
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushës së Madhe, Piranë, Zojcë dhe Medvec".
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: " Ndërtimi i rrjetit dhe stacionit të pompave shtytëse për SPK në Qafë Morinë.
- Kemi bërë raportin e komisionit për pranim e shërbimeve për mbikëqyrje dhe monitorimi i stacionit të pompave për zonat rurale për nevojat e KRU Gjakova sh.a.
- Jemi angazhuar në zyrën e burimeve njerëzore në komisionet e pranimit të punëtorëve konkretisht 2 monterave.
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: "Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Oterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit"
- Jemi angazhuar në zyrën e burimeve njerëzore në komisionet e pranimit të punëtorëve konkretisht 1 Inxhinier për zyrën e planifikim dhe zhvillim.
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: " Ndërtimi i rrjetit dhe stacionit të pompave shtytëse për SPK në Qafë Morinë .
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: " Rehabilitimi i Ujësjellësit për fshatrat Ratkoc dhe Bratotin".
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: " Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP-Ritender.
- Jemi angazhuar në zyrën e prokurimit në vlerësimin e tenderëve:
- Furnizimi me ujë të zonës së sipërme të fshatit Pjetershan dhe kampin YMCA " në Komunën e Gjakovës;
- Gyp i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojz, Medvec dhe Mamushë- FAZA II;
- Jemi pajisur me leje ndërtimore nga Komuna e Gjakovës për projektin "Rehabilitimi i ujësjellësit për fshatrat Dol, Lipovec dhe Gërquinë të Komunës së Gjakovës"
- Mbikëqyrjen e punimeve për tenderin: "Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Oterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit"

Hartimi i Projekteve Investive nga Zyra për Planifikim

Kemi vazhduar në plotësimin/revidimin e projekteve kryesore;

Në bazë të vendimit të Kyeshefit Ekzekutiv, kemi marrë detyrat për projektet që janë të parapara me planin e prokurimit dhe ato janë:

- Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP,
- Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec, dhe Smaq 1 - faza 2,
- Ndërtimi i stacionit të pompave të fshatit Brestovc dhe ndërprerja e furnizimit nga rrjeti i qytetit Rahovecit,
- Instalimi i ujëmatësve jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashengjergj.
- Kemi bërë projekt detal për Ministrin e Ekonomisë për tenderin Faza II – Medvec- Mamushë, për financimin e projektit
- Kemi aplikuar në KEK dhe PTK, për tenderin Faza II – Medvec- Mamushë, për pajisje për leje ndërtimore.
- Kemi aplikuar në Komunën e Mamushës, në Drejtorin e Urbanizimit për tenderin Faza II – Medvec- Mamushë, kërkesë për pajisje për leje ndërtimore
- Kemi bërë projekt detal për Ministrin e Ekonomisë, për "Rehabilitimin e ujësjellësit Dol Lipovec dhe Gërquinë, për financimin e projektit.
- Kemi bërë kërkesë për caktimin e lokacionit në Brestovc në komunën e Rahovecit për ndërtimin e rezervuarit të ri.

- Në bazë të vendimit të Kyeshefit Ekzekutiv, kemi marre detyrat për projektet që janë të parapara me planin e prokurimit e ato janë:
- Kemi aplikua për leje ndërtimore në drejtorin e urbanizimit në komunën e Gjakovës për tenderin “Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec, dhe Smaq 1 - faza 2”,
- Kemi aplikua për dhënie në shfrytëzim të një parcele 2-3 ari, për ndërtimin e rezervuarit dhe pajisje me leje ndërtimore në parcelë publike për ndërtimin e stacionit të pompave pranë drejtorisë së urbanizimit në komunën e Rahovecit,
- Instalimi i ujëmatësve jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashengjergj.
- Kemi përfunduar projektin dhe paramasën për tenderin “Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP”,
- Jemi pajisur me pëlqimet nga KEK dhe PTK, për tenderin Faza II – Medvec- Mamushë.
- Jemi pajisur me leje ndërtimore nga Komuna e Mamushës, në Drejtorin e Urbanizimit për tenderin Faza II – Medvec- Mamushë, kërkesë për pajisje për leje ndërtimore
- Kemi përfunduar projektin dhe paramasën për furnizim me ujë për zonën së sipërme të fshatit Petershan dhe kampit YMCA, Komuna e Gjakovës.
- Kemi përfunduar projektin dhe paramasën për projektin “Ndërrimi i gypit AC me gypin PE 100 RC type 2, dhe vendosja e ujëmatësve të mençur në rrugën Megzon Boshnjaku në komunën e Gjakovës.
- Kemi përfunduar projektin dhe paramasën për projektin “Ndërtimi i kanalit të ujit në fshatin Hoqe e Madhe në komunën e Rahovec me kërkesë të KFOR – it Italian.
- Jemi pajisur me leje ndërtimore nga drejtorin e urbanizimit në komunën e Gjakovës për tenderin “Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec, dhe Smaq 1 - faza 2”,
- Në bazë të vendimit të Kyeshefit Ekzekutiv, kemi marre detyrat për projektet që janë të parapara me planin e prokurimit e ato janë:
- Furnizim me kubëza, çimento, blloka çimento dhe armaturë për nevojat e mirëmbajtjes,
- Pajisje mbrojtëse për punëtorët gjatë punës në puseta , ndërtimi i stacionit të pompave të fshatit Brestovc dhe ndërprerja e furnizimit nga rrjeti i qytetit Rahovecit,
- Furnizimi i punëtorëve me mjete pune për të gjitha njësitë.
- Në bazë të vendimit të Drejtorit Teknik kemi punuar në projektet ” Instalimin e ujëmatësve jashtë pronave private në: Fshatin Cermjan, Novosellë e ulët , Skivjan, Vrajak dhe Novosellë e epërme si dhe fshatrat-Palabardh, Janosh dhe Sopot.

Shërbimi Gjeodezik Janar-Dhjetor 2025

Shërbimi gjeodezik , ka qenë i angazhuar në incizimin e avarive, lidhjeve të reja në tri njësitë punuese në Gjakovë – përfshirë edhe Reken e Keqe, Rahovec dhe Prizren. Veç kësaj ka kryer dhe punë të tjera sipas kërkesave nga udhëheqësit apo departamentet tjera, të cilat po i cekim me poshtë.

Tabela 12–Incizimi i havarive në teren dhe dislokimeve dhe instalimeve të reja në ujësjellës dhe kanalizim

LOKACIONI	PËRSHKRIMI I PUNËS				
	Incizim i gypave/defekteve Janar – Dhjetor 2025				
Zona e shërbimit Gjakovë, Rahovec, Prizren dhe Reka e Keqe	Tremujori parë	Tremujori dytë	Tremujori tretë	Tremujori katër	Totali :
A. Ujësjellësi					
a.1. Defektet	116	106	134	111	467
a.2. Lidhjet e reja	31	31	21	17	100
a.3. Incizimet për projekte	2	0	6	3	11

a.4. Piketimet	4	5	5	32	46
B. Kanalizimi	2	5	7	12	26

Detektimi Akustik i Rrjetit Janar-Dhjetor 2025

Njësia për detektim Akustik është duke u përdorur sipas nevojës në rastet e ndonjë dyshimi eventual për rrjedhje të ujit. Janë bërë detektime sipas kërkesave gjatë paraqitjes në zyrën e Departamentit Teknik, zyrën për marrëdhënie me konsumatorë, apo paraqitjes te zyrat e mirëmbajtjes së rrjetit, si në vijim:

Tabela 13—Incizimi i avarive në teren nga ekipi detektues në ujësjellës dhe kanalizim

Lokacioni	PËRSHKRIMI I PUNËS				
Zona e shërbimit në KRU Gjakova	Nr. i detektimeve të humbjeve dhe rrjedhave të ujit Janar – Dhjetor 2025				
Gjakovë, Rahovec, Prizren dhe Reka e Keqe	Tremujori parë	Tremujori dytë	Tremujori tretë	Tremujori katër	Totali :
	118	130	177	131	556

Spektori për Mirëmbajtje Mekanike dhe Elektrike, Janar -Dhjetor 2025

Spektori për mirëmbajtje mekanike dhe elektrike gjatë vitit 2025, ka realizuar këto aktivitete: Furnizimi me derivate të naftës për automjetet e KRU “Gjakova” Sh.A. në “Petrol Company”,

Përpilimi dhe dorëzimi i raporteve të menaxhimit dhe pranimi për:

- a) GPS-at e automjeteve të KRU Gjakova 2025.
- b) Furnizim me derivate të naftës 2025.
- c) Servisimi dhe rimbështjellja e motor pompave.
- d) Kontrollimi i faturave të energjisë elektrike të të gjitha objektet e KRU Gjakova 2025
- e) Mirëmbajtja dhe monitorimi i Stacioneve të pompave.
- f) Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve.
- g) Furnizim dhe Montim me Auto goma dhe Bateri.

Përpilimi dhe dorëzimi i raportit mbi matjen e shtypjes së ujit në sistemin e furnizimit të KRU GJAKOVA, Janar – Dhjetor 2025, duke llogaritur që matjet bëhen tri herë në muaj.

Kontrollimet dhe intervenimet e përditshme në stacionet e pompave dhe rezervarëve akumulues Janar – Dhjetor 2025.

Gjatë vitit janë realizuar-Kontrolle të vazhdueshme në stacionet e pompave dhe rezervuar: Hereq, Cermjan, Pyrgu i liqenit, Sopot, Fierzë, Pataqan 1, Pataqan 2, Berkoc, Damjan 1, Damjan 3, Novosellë, Rezina, Kushavec, Ujë, Muhadër, Karashengjergj, Rahoveci 1, Çabrat, Vrajak, Dedaj, Breg Drini, Reti e epërme-poshtme, Rahoveci 2, Drenoc, Senoc, Bratotin, Opterushë, Luginë e Hasit, Hoqe madhe, Palluzhë, Dushkaje, Doli, Lipovec, Kusarë, Batushë, Pastasel, Palabardh, dhe Randobravë.

Gjatë fillimit të muajit Janar kemi pasur problem shumë me energjinë elektrike në disa Stacione të pompave, ku tensioni ka qenë shumë i ulët, dhe si shkak pompat nuk aktivizoheshin ose siguresa mbrojtëse nuk aktivizohej.

Stacionet e pompave të cilat kishin problem me energjinë elektrike: Stacioni i Pompave Palluzhë, Pastasel, Opterushë, Gërquinë dhe Damjan, dhe Ujë. Kjo dukuri e rënies së tensionit është stabilizuar pas datë 10.01.2025, dhe menjëherë është stabilizuar furnizimi me ujë.

Më datë 07.10.2025, ekipi elektro mekanik ka realizuar mbylljen e dyerve të kullës në Digë për sistemin e ujitjes.

Energjia Elektrike – Nga data 01.06.2025, ne jemi të obliguar që të dalim në treg të hapur për furnizim me energji elektrike, pasi që e tejkalojmë njërin nga kushtet me staf mbi 50 punëtorë. Vlen të ceket se nga data 01.06.2025, do të rriten tarifat e energjisë elektrike çka do të ndikoj në rritjen edhe të vlerës totale të faturës.

Ekipi elektro-mekanik ka qenë vazhdimisht i angazhuar në monitorimin e stacioneve të pompave si pasojë e luhatjeve të tensionit.

Gjithashtu edhe punë tjera nga sektori i mekanikes dhe elektrikes si:

- Monitorimi dhe Servisimi i të gjitha automjeteve të KRU Gjakova,
- Shikimi teknik dhe Regjistrimi i automjeteve të kompanisë;
- Intervenime në stacionet e pompimit në të gjitha pikat dhe mbajtja nën kontrollë të pompave për furnizim 24/7;
- Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të derivateve nga punëtorët e kompanisë,
- Kërkesa – të ndryshme për prokurim;
- Kërkesa për Furnizim me auto-goma dhe bateri për nevojat e KRU Gjakova,
- Lëshuarja e autorizimeve të ndryshme për ngasjen e automjeteve të kompanisë
- Hartimi i raporteve mujore.

Çdo muaj ekipi elektro-mekanike bënë monitorimin e gjendjes së automjeteve për rregullsinë e tyre, si dhe bënë regjistrimin dhe kontrollimet teknike të automjeteve sipas nevojës.

Gjatë muajit Tetor-Nëntor, i kemi pranuar dy automjete nga Konsulenca, duke u bazuar në kontratën e tyre. Bartja e pronësisë së tyre është bërë menjëherë, dhe i janë vendosur tabelat e reja: Golf 4 – 07-204-FQ dhe Ford Fiesta – 07-203-FQ.

Shpenzimet e energjisë elektrike në kw në KRU "Gjakova" për vitin 2025

Të dhënat e performancës	Njësia	Vlera e raportuar
Energjia elektrike e konsumuar - furnizimi me ujë	kw/vit	4,757,196
Energjia elektrike e konsumuar - ujëra të ndotura	kw/vit	1,238,670
Energjia elektrike e konsumuar nga shërbimet tjera dhe administrative	kw/vit	230,302
Totali i shpenzimeve të energjisë elektrike	kw/vit	6,226,168

3.3 Ndryshimet që kanë ndodhur në performanc operative në krahasim me vitin e kaluar dhe me caqet e planit të biznesit. Pse këto ndryshime kanë ndodhur

Tabela 14. Pasqyra e performancës operative në krahasim me vitin paraprak dhe planin aktual

<i>Pasqyra e performancës operative në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual</i>							
		2024	2025	Ndryshimi %	BP 2025	2025	Ndryshimi %
1	Uji i prodhuar në m ³	16,202,875	16,211,843	0.06%	16,150,102	16,211,843	0.38%
2	Uji i faturuar në m ³	8,434,971	8,300,017	-1.63%	9,199,005	8,300,017	-10.83%
3	Humbja e ujit në %	48%	49%	0.90%	43%	49%	5.80%
4	Konsumatorë të regjistruar numër	49,216	51,702	4.81%	51,684	51,702	0.03%
5	Numri i konsumatorëve me ujëmatës	49,147	51,645	4.84%	51,684	51,645	-0.08%
6	Kualiteti i ujit %	99.35%	99.28%	-0.07	100%	99.28%	-0.72
7	Numri i punëtorëve	293	301	2.66%	305	301	-1.33%

Prodhimi i ujit në m³ -Prodhimi i ujit në vitin 2025, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2024 ka rritje prej 0.06%, ndërsa krahasuar me BP 2025 ka rritje prej 0.38%. Rritja e prodhimit të ujit ka ardhur si pasojë e rritjes së kërkesës për ujë nga rritja e konsumatorëve

Faturimi m³- Në vitin 2025 faturimi në m³ është për 1.63% më ulët se viti 2024 si dhe -10.83% më pas se BP 2025. Rënia e faturimit në m³ në këtë periudhë ka ndodhur për mos planifikim të sakt të Biznes Planit.

Humbjet e ujit – Në vitin 2025, humbjet e ujit janë përfunduar me 49%,për 0.90% më të larta se viti 2024 dhe për 5.8% më të larta se BP 2025.

Numri i konsumatorëve- Në vitin 2025 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitit 2024 ka rezultuar me rritje prej 4.81% ndërsa krahasuar me BP 2025 numri i konsumatorëve ka rritje prej 0.03%.

Numri i testeve të dështuara- Në vitin 2025 në total kanë dështuar 26 mostra fiziko-kimike në zonën e furnizimit për shkak të turbecitetit të ujit. Zakonisht ndodhin në fshatrat që i kanë burimet e veta të ujit dhe për shkak të reshjeve atmosferike dhe problemeve me energji elektrike.

Numri i punëtorëve - Kur krahasojmë vitin 2025 me vitin 2024 numri i punëtorëve ka rritje prej 2.66%, kurse kur krahasojmë BP 2025 ka zvogëlim për 1.33%.

3.4 PASQYRË E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

3.4.1 Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti i kaluar dhe ndryshimet me caqet e Planit të Biznesit

Tabela 15. Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti i kaluar dhe ndryshimet nga caqet e PB 2025

Pasqyra e performancës financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual							
		2024	2025	Ndryshimi në %	BP 2025	2025	Ndryshim i në %
1	Të hyrat nga shitja e ujit	5,002,476	5,084,575	1.61%	5,335,423	5,084,575	-4.93%
2	Të hyrat tjera	133,723	247,079	45.88%	144,000	247,079	41.72%
	TOTALI	5,136,199	5,331,654	3.67%	5,479,423	5,331,654	-2.77%
	Shpenzimet operative						
1	Shpenzimet e pagave	2,963,386	3,419,484	13.34%	3,072,831	3,419,484	10.14%
2	Shpenzimet e mirëmbajtjes	78,723	159,549	50.66%	95,149	159,549	40.36%
3	Shpenzimet rrymës elektrike	441,980	670,787	34.11%	454,323	670,787	32.27%
4	Shpenzimet e derivateve	109,080	102,554	-6.36%	113,458	102,554	-10.63%
5	Shpenzimet e kemikaleve	54,616	47,565	-14.82%	62,562	47,565	-31.53%
6	Shpenzimet tjera operative	333,024	437,584	23.89%	325,509	437,584	25.61%
	TOTALI	3,980,809	4,837,523	17.71%	4,123,832	4,837,523	14.75%

TË ARDHURAT TOTALE - Gjatë vitit 2025 me të ardhurat e realizuara KRU-ja ka mbuluar 100% të kostos së operimit të mirëmbajtjes. Krahasuar me të hyrat nga uji të vitit aktual me vitin paraprak të ardhurat janë për 3.67% më të larta se viti 2024, ndërsa me BP 2025 janë për 2.72% më të ulëta.

SHPENZIMET OPERATIVE- Gjatë vitit 2025 shpenzimet operative janë për 17.71% më të larta se me viti 2024 dhe për 14.75 më të larta se BP 2025. Këto shpenzime si të tilla gjatë vitit mundësuan përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë.

3.4.2. Ndryshimet në të ardhura dhe shpenzime –faktorët ndryshues në këto ndryshime

Faktorët ndikues në rritjen e të ardhurave

KRU "Gjakova" SH.A., gjatë vitit 2025 të ardhurat kanë rritje kur krahasojmë të njëjtën periudhë të vitit 2024 për 3.67%. Rritja e të ardhurave ka ndodhur pasi ka rritje të faturimit në m³ dhe rënia e humbjeve të ujit.

Faktorët ndikues në rritjen e shpenzimeve

Me mjetet financiare të saja, Kompania ka investuar në ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore, infrastrukturës rrugore, ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, sanimet e rrjetit të ujësjellësit, funksionimin e Stacionit të Filtrimit dhe kontrollin e cilësisë së ujit të pijes, kërkesat për realizimin e veprimtarisë administrative në kompani (shpenzimet e personelit për paga dhe mëditjet, shpenzimet e energjisë elektrikes shpenzimet e derivateve, shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klori i gaztë, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta), etj.

Shpenzimet e pagave

Në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 shpenzimet kanë pësuar rritje prej 13.34% , ndërsa me BP 2025 kanë rritje për 10.14%. Në këto shpenzime hyjnë: pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

Përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj. Ka rritje krahasuar me vitin 2024 për 50.66%. Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2024 krahasuar me vitin BP 2025 kanë rritje për 40.36%.

Shpenzimet e rrymës elektrike

Këto shpenzime krahasuar me vitin 2024 kanë ngritje për 34.11%, kurse kur krahasojmë me BP 2025 kemi ngritje për 32.77%. Rritja e shpenzimeve të rryme ka ardhura nga ngritja e çmimit të saj.

Shpenzimet e derivateve

Kur krahasojmë me vitin 2024 shpenzimet e derivateve janë më të ulëta për 6.36%, kurse kur krahasojmë me BP 2025 janë më të ulëta për 10.63%.

Shpenzimet e kemikaleve

Përfshijnë alumin sulfatin, klori i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv. Krahasuar me vitin 2024 shpenzimet e kemikaleve kanë pas zvogëlim për 14.82%, ndërsa krahasuar me BP 2025 shpenzimet e kemikaleve kanë pasë zvogëlim 31.53%.

Shpenzimet tjera operative

Përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU-së, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta, faturimet e ujit. Shpenzimet tjera Operative për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 kanë rritje për 23.89%, kurse kur krahasojmë me BP 2025 kanë pasur rritje 25.61%.

Përkundër shpenzimeve të cekura Kompania gjatë vitit 2025, ka operuar me fitim operativ ku nga total Arkëtimi 5,401,134 euro, zbriten Shpenzimet Operative në shumë prej 4,837,521 euro, Fitimi Operativ ka vlerën 563,613 Euro.

3.4.3. Komentet mbi ndryshimet në strukturën e kapitalit, duke përfshirë huat apo ndonjë formë tjetër të financimit

Kompania gjatë vitit 2025 ka pësuar ndryshime në strukturën e kapitalit pasi që Kompania operon me fitim financiare. Fitimi financiar për vitin 2025, pas tatimit në fitim është 91,645 euro.

3.5 PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

3.5.1. Pasqyrat e progresit në implementimin e Planit të Biznesit

Tabela 16. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me BP

Treguesit kryesor të performancës		Caqet e planifikuara BP 2025	Caqet e realizuara 2025	Ndryshimi në përqindje-%
1.	Uji i prodhuar në m ³	16,150,102	16,211,843	0.38%
2.	Uji i faturuar në m ³	9,199,005	8,300,017	-10.83%
3.	Konsumatorë të regjistruar në numër	51,684	51,702	0.03%
4.	Numri i faturave të lëshuara	51,684	51,702	0.03%
5.	Numri i kons. që faturohen sipas	51,684	51,645	-0.08%
6.	Uji faturuar për konsumatorët me ujmatësa m ³	8,755,003	8,286,048	-5.66%
7.	Faturimi nga uji në Euro	5,335,423	5,084,575	-4.93%
8.	Arketimi nga uji në Euro	5,335,423	5,234,542	-1.93%
9.	Të hyrat tjera operative Euro	144,000	157,985	8.85%
10.	Shpenzimet operative Euro	4,123,833	4,837,521	14.75%
11.	Shlyerja e borxheve ndaj konsumatorëve Euro	0	0	0
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët Euro	0	0	0
13.	Parat e gatshme në bank dhe në arkë Euro	1,288,284	470,665	-173.72%
14.	Stoqet Euro	846,423	740,957	-14.23%
15.	Llogarit e arketueshme nga uji Euro	9,469,702	9,062,175	-4.50%
16.	Llogarit e pagueshme Euro	22,668,340	28,213,636	19.65%
17.	Numri i punëtorëve	305	301	-1.33%
18.	Numri i ankesave	250	1,429	82.51%
19.	Numri total i testeve të realizuara	4,037	3,600	-12.14%
21.	Matja e treguesve në %			
22.	Uji i pa faturuar %	43%	49%	5.80%
23.	Përqindja e faturimit %	100%	100%	0%
24.	Përqindja e konsumit të matur%	95%	100%	5%
25.	Proporcioni i konsumatorëve me ujmatësa %	100%	100%	0%
26.	Efikasiteti i stafit numër	5.90	5.82	0
27.	Shkalla e arkëtimit në % total	100%	103%	2.95%
28.	Shkalla e arkëtimit në amvisëri %	96%	104%	8.00%
29.	Shkalla e arkëtimit në biznese %	97%	107%	10.00%
30.	Shkalla e arkëtimit në institucione%	92%	87%	-5.00%
31.	Norma e mbulesës së punës numër	1.33	1.08	-25%
32.	Norma e punës numër	1.33	1.08	-25%
33.	Shpenz. Operative për Konsumator numër	6.65	7.80	1%

Uji i prodhuar në m³- Prodhimi i ujit në vitin 2025 duke krahasuar me prodhimin e ujit BP 2025 ka rritje prej 0.38%. Rritja e prodhimit të ujit ka ndodhur si rezultat i rritjes së konsumatorëve dhe i rritjes së kërkesës për ujë.

Uji i faturuar në m³- Në vitin 2025 kur krahasojmë me BP 2025 ka zvogëlim për 10.80%.

Numri i ankesave- Kur krahasojmë vitin 2025 me BP 2025 kanë rritje për 82.51%, duket se me Biznes Plan nuk janë parashikuar siç duket.

Numrin e konsumatorëve – Kur krahasojmë vitin 2025 me BP 2025 numri i konsumatorëve ka rritje për 18 konsumator ose 0.03%.

Arkëtimi nga uji në Euro- Kur krahasojmë vitin 2025 me BP 2025 arkëtimi ka zvogëlim prej 1.93%. Në

përqindje vitin 2025 e kemi mbyllur me 107.10% .

Humbjet e ujit në % -Në vitin 2025 humbjet e ujit janë 49%, për 5.8% më shumë se BP 2025.

Shlyerja e obligimeve nga kreditorët Euro –Kompania në përgjithësi e ka arritur planin e shlyerjes së obligimeve ndaj furnitorëve si rezultat i rritjes së të hyrave të realizueshme gjatë vitit 2025. Kompania i ka paguar rregullisht furnitorët e sajë, punëtorët dhe obligimet tatimore.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë Euro - Kompania gjatë vitit 2025 e ka mbyllur me 470,656 euro. Këto janë mjete financiare me 31.12.2025 në arka dhe banka.

Shpenzimet operative Euro- Gjatë vitit 2025 shpenzimet operative kur krahasojmë me BP 2025 kemi ngritje për 14.75%.

Në avancimin kryerja e obligimeve me kohë ndaj konsumatorëve

Falë angazhimit profesional Kompania ka vazhduar të dëshmoi përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale në raport me konsumatorin. Ka vazhduar të modifikohet hapësira për ofrimin e shërbimeve për konsumator, me standarde të mjaftueshme që konsumatorëve të ju mundësohet qasje e lehtë në realizimin e kërkesave të tyre, dhe kryerjen e obligimeve ndaj Kompanisë. Këtë drejtim është realizuar projekti mbi Ndërrimin e ujëmatësve kryesor dhe individual, kontrollimit, identifikimit dhe evitimit/pengimit të parregullsisë/ keqpërdorimeve në shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Ndërtimi i rezervarëve dhe rrjetit të ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijes, hapja e numrit të madh të portoarkave ku me këtë planifikim po ju mundësohet konsumatorëve një shërbim me i afërt dhe cilësor i pagesave si dhe për kompaninë po arrihet heqja e keshit nga inkasantët. Në vitin 2025 Kompania ka ndërruar softverin e Kompanisë dhe në kuadër të saj ka fut në jetë projektin për leximin e ujëmatësve ma pasije elektronike, duke ofruar shërbime më të mira për konsumatorët e tij.

Përkujdesja për sigurimin e punëtorëve dhe objekteve

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë në aspektin social Kompania ka ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë për punëtorët e saj, duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë standardeve më të larta. Po përmendim këtu; Realizimi i Programit të sigurimit të veshmbathjeve të punëtorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Edhe për vitin 2025 është planifikuar që punëtorët të furnizohen me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë si dhe është realizuar në tërësi procedura e prokurimit për sigurimin me kohë të tyre .

Kompania ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve në realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshop dhe grupe punuese. Janë realizuar blerje të pajisje kompjuterike për zyrë dhe punë në teren .

3.5.2. Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjive

Objektivat kryesore dhe strategjike për vitin 2025 po i listojmë, si më poshtë:

- Humbjet e ujit kanë qenë të planifikuara 43%, kurse vitin e kemi mbyllur me 49%, shkak i diferencës në humbje shihet se është mos planifikimi i duhur në BP i faturimit m³.
- Përqindja e konsumimit të matur ka qenë i planifikuar 95%, kurse e kemi realizuar 100%
- Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës ka qenë e planifikuar 100%, kurse vitin e kemi mbyllur me 100%, njëjtë
- Shkalla totale e arkëtimit është planifikuar 100%, kurse vitin e kemi mbyllur me 103%
- Shkallet e arkëtimit si: amvisëri është planifikuar 96% kurse vitin e kemi mbyllur me 104%, biznese është planifikuar 97% kurse vitin e kemi mbyllur 107% dhe institucione i kemi planifikuar 92% kurse vitin e kemi mbyllur me 87%
- Norma e mbulesës së punës është planifikuar 1.33, kurse vitin e kemi mbyllur me 1.08
- Norma e punës është planifikuar 1.33, kurse vitin e kemi mbyllur me 1.08.

3.5.3. Çfarë ndryshime janë paraqitur gjatë aktiviteteve, operimeve dhe ambientit të cilën e rrethon ndërmarrjen që nga përgatitja e planit të biznesit. Si do të ndikojnë këto ndryshime (nëse ka) në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Gjatë aktiviteteve, operimeve menaxhmenti i Kompanisë synon të realizojë objektivat e Planit të Biznesit si dhe të përmirësoi edhe më tej performancën e Kompanisë në rritjen e të hyrave të Kompanisë si bazë themelore e krijimit të mundësive financiare të vetë ekzistimit dhe të investimeve kapitale përmes mjeteve vetanake. Në këtë rrugëtim gjatë aktiviteteve drejt realizimit të PB janë paraqitur disa ndryshime, si ;

- Funksionimin e detektorëve si dhe trajnimi i stafit në këtë drejtim për aftësimin e tyre në përdorimin e aparaturës (detektorëve) si dhe përdorimi i të njëjtave në teren;
- Matjet komerciale përmes leximit të dhënave komulative të ujëmatësve kryesor dhe shtëpiak në mënyrën elektronike përmes datalogerëve ;
- Me këto aktivitete është arritur që Kompania me mjete vetanake të siguroi që të ketë ndryshime në realizimin e Planit të Biznesit në ambientin që rrethon Kompaninë edhe në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët në kompani.

3.6. SHPENZIMET KAPITALE DHE TË PROJEKTEVE

Gjatë vitit 2025, në KRU "Gjakova" janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjakovë dhe dy njësit tjera në Rahovec dhe Prizren, si nga ana e Kompanisë ashtu edhe nga ana e Qeveris dhe Komunave. Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë, rritjes së konsumatorëve, zhvillimit të infrastrukturës ujore, kanalizimit, të infrastrukturës së objekteve, mirëqenies së punëtorëve etj. Kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presionit në rrjetin e ujësjellësit. Në vazhdim po paraqesim investimet e realizuara nga ana e Kompanisë që kanë të bëjnë me implementimin e projekteve.

Tabela 17. Lista e investimeve kapitale -2025

Lista e investimeve për vitin 2025	Euro
<i>Objektet Ndërtimore</i>	
Renovimi i objekteve administrative - Gjakovë dhe Rahovec	6,658
Ndërrimi i stacionit -SPK në Qafë Morin	26,803
Telekomanda e Rampës së parkingut për automjetet	84.00
Totali objektet ndërtimore	33,545
<i>Rrjeta e Ujësjellësit</i>	
Ndërrimi i rrjetit dhe stacionit -SPK në Qafë Morin	34,273
Furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Hoqë e Madhe	779,013
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krush	1,425,565
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rr.Ymer Pula	96,217
Ndërrimi i gypit nga stacioni i pompave Pataqan	91,904
Investimet tjera në rrjet	280,399
Totali i rrjetit të ujësjellësit	2,707,371
<i>Ujëmatësit</i>	
Instalimi i ujëmatësve të konsumatorëve të ndryshëm	47,348
Totali ujëmatësit	47,348
<i>Pajisjet Elektro-Mekanike</i>	
Pompë e ujit për SPK Qafë Morinë	3,051

Bombole 1,000 kg	5,682
Furnizim me material elektrik-Frekuentor	1,458
Servisimi i pompave dhe rimbështjellja e motorëve	975
Paisjet elektrike-mekanike / Pompat e Ujit	5,663
Investimet tjera nëm paisje elektro-mekanike	14,010
Totali paisjet elektro mekanike	30,839
<i>Automjetet</i>	
Automjetet-FW Xhip-Amaroko 07-504/SJ	34,703
Automjetet-FW Xhip-Amaroko 07-503/SJ	34,703
Automjetet-Minibus 07-973/FQ	58,703
Kapitalizimi i mirëmbajtjes të makinave të Kompanisë	21,325
Totali i automjeteve	149,434
<i>Paisjet Kompjuterike-TI</i>	
Furnizim me paisje, ekzekutimi dhe konfigurimi i rrjetës kompjuterike	14,966
Furnizim me telefona të mençur dhe printera për printimin e faturave të ujit	3,766
Furnizim me paisje mobile-Telefon i mençur UNIWA 6 GB	1,047
Furnizim me paisje mobile-Printerë	1,966
Paisje tjera për IT	1,705
Totali i paisjeve kompjuterike-TI	23,450
<i>Paisjet për mirëmbajtje</i>	
Furnizim të ndryshme për mirëmbajtje	2,705
Totali i paisjeve për mirëmbajtje	2,705
<i>Mobilje dhe paisje për zyre</i>	
Furnizim me klime 18BTU për dhomën e servereve	542
Material laboratorik - Resho magnetik	305
Mobilje dhe paisje tjera për zyre	5,105
Totali i mobiljeve dhe paisjeve për zyre	5,952
<i>Investimet në vijim</i>	
Investimet në vijim-Impianti i ujerave të zeza -Ndërtimi i digës mbrojtëse nga përmytjet	493,936
Investimet në vijim-Impianti i ujrave të zeza	89,813
Investimet në vijim-Sanimi i rrjetit të kanalizimit të dëmtuar dhe ndërtimi i pushtave	6,283
Investimet në vijim-për kategorin e Aseteve E,G,H.	1,891
Investimet në vijim-Ndërtimi i ujëmatësve dhe zgjerimi i rrjetit-për fsh. Lipovec dhe Smaq 1	24,732
Investimet në vijim-Softveri i ERP-së	70,552
Investimet në vijim- Gjakova III- për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan	172,144
Totali i investimeve në vijim	859,351
Totali i investimeve 2025	3,859,995

3.6.1 Komentet në progresin e projekteve kapitale të ndërmarrjes, duke përfshi; Komente dhe vonesa administrative, vonesa në prokurim, apo ndonjë ndryshim i kostove në implementimin e projekteve .

Në realizimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2025 Ndërmarrja ka treguar një progres të dukshëm. Projektet e planifikuara për vitin 2025 janë realizuar në numër të konsiderueshëm ku në këtë realizim ka ndikuar rritja e të hyrave si rezultat i rritjes së arkëtimit si dhe të hyrave tjera. Projektet kapitale janë implementuar një pjesë nga mjetet tona vetanake, Grandet e aksionarit –Qeverisë së Kosovës, CDI, si dhe komunat e Regjionit që furnizon Kompania. Sa i përket procedurës së implementimit, vonesa administrative, vonesa në prokurim apo ndonjë ndryshim tjetër i kostove gjatë vitit 2025 mund të themi se të gjitha projektet janë realizuar pa ndonjë ngecje të qenësishme që do të pengonte realizimin e këtyre projekteve kapitale .

Projektet e investuara nga mjetet donacionet e Qeverisë së Kosovës – mund të themi se procedurat administrative dhe të prokurimit si dhe kostove të shpenzimeve janë realizuar në tërësi. Falënderuar stafit të prokurimit KRU-ja ka arritur që për vitin 2025, ti realizoi 100% të mjeteve nga donacionet e ndara për Kompaninë .

3.7 PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

3.7.1 Të paraqitet një skicë gjithëpërfshirëse e planit të biznesit për vitin e ardhshëm dhe të identifikohen objektivat kryesore;

Plani i Biznesit 2026-2028 definojnë çart orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definojnë çartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake. Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adaptuar praktikën më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në regjionin tonë .

Plani i Biznesit 2026-2028, definojnë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojnë me një arritje të vet qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat operativ dhe financiar janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme duke lënë mundësinë e tejkalimit të tyre –uljen e tyre pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të jenë sa më lartë realitetit dhe parametrave të arritshëm.

Plani është i orientuar fuqishëm në drejtim të mundësive vetanake financiare dhe të donatorëve ku realizim i këtij plani e sidomos planit të investimeve është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga donatorët ,institucionet qendrore dhe lokale .

Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky plan, në mënyrë që Kompania të arrij një qëndrueshmëri financiare që të ofroj shërbime cilësore për konsumatorët.

Në vazhdim po i paraqesim në formë tabelare treguesit kryesor operativ dhe financiar të performancës .

Tabela 18. Treguesit kryesor të performancës, caqet e planifikuara PB 2026

Treguesit kryesor të performancës		Caqet e planifikuara BP 2026
	Uji i prodhuar në m ³	16,687,102
	Uji i faturuar në m ³	8,767,963
	Konsumatorë të regjistruar në numër	53,484
	Numri i faturave të lëshuara	53,484
	Numri i konsumatorëve që faturohen sipas leximit me ujëmatës	53,484
	Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës m ³	8,767,963
	Faturimi nga uji në Euro	6,137,574
	Arketimi nga uji në Euro	6,444,453
	Të hyrat tjera operative Euro	163,046
	Shpenzimet operative Euro	5,422,116
	Shlyerja e borxheve ndaj konsumatorëve Euro	0
	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët Euro	0
	Parat e gatshme në bank dhe në arkë Euro	431,418
	Stoqet Euro	705,185
	Llogarit e arketueshme nga uji Euro	9,162,823
	Llogarit e pagueshme Euro	24,310,736
	Numri i punëtorëve	320
	Numri i ankesave	260
	Numri total i testeve të realizuara laboratorike	4,795
	Matja e treguesve në %	
	Uji i pa faturuar %	47%
	Përqindja e faturimit %	100%
	Përqindja e konsumit të matur %	100%
	Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	100%
	Efikasiteti i stafit numër	5.98
	Shkalla e arkëtimit në % total	105%
	Shkalla e arkëtimit në amvisëri %	96%
	Shkalla e arkëtimit në biznese %	97%
	Shkalla e arkëtimit në institucione %	92%
	Norma e mbulesës së punës numër	1.22
	Norma e punës numër	1.16
	Shpenz. Operative për Konsumator numër	8.54

Objektivat kryesore

Plani i Biznesit përfshinë synimet afariste të Kompanisë gjatë periudhës 2026-2028, dhe përveç tjerash vlerësohet se do të përmirësoj kontrollin menaxherial mbi Kompaninë dhe shmangien ndaj gabimeve që mund të sjellin atë në dështim të përmbushjes së standardeve të shërbimeve.

Plani i Biznesit do ti nënshtrohet rishikimit dhe freskimit në baza vjetore.

KRU "Gjakova" SH.A ka furnizuar deri në fund të vitit 2025, me ujë të pijes 51,702 konsumatorë. Gjatë kësaj periudhe KRU "Gjakova" do vazhdoj të furnizoi konsumatorët e vet me ujë 24 orë.

Krahas përmirësimit të shërbimeve të ofruara Kompania synon që gjatë kësaj periudhe të përmirësoi afarizmin ekonomik dhe atë : Duke shtuar përpjekjet në ngritjen e shkallës së arkëtimit në 105% në vitin 2026. Të shtoi masat e kontrollit të ujit të prodhuar i cili iu shpërndahet konsumatorëve dhe me këtë të ndikoi në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit, gjegjësisht të ujit që nuk faturohet dhe Kompanisë nuk i sjellë të ardhura.

Realizimi i këtyre të synimeve do ti mundëson Kompanisë gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme për të qenë vetë financues i qëndrueshëm dhe do ti rrisë aftësitë financiare të Kompanisë për mbulimin e pjesërisht të investimeve të parapara në periudhën planifikuese.

Kontrolli dhe evitimi i humbjeve teknike dhe komerciale si dhe me mbikqyerjen e shpenzimeve të përgjithshme të Kompanisë, planifikohet një zvogëlim i shpenzimeve operative .

Krahas ngritjes së kapaciteteve teknike të Kompanisë, rëndësi e veçantë do ti kushtohet ngritjes së aftësive

profesionale të stafit, dhe për këtë menaxhmenti do identifikoi lëmit adekuate për trajnim të stafit . Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, deri në fund të vitin 2026, Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike si vijon:

1. **Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë** ; Këto aktivitete do të përfshijnë identifikimin e humbjeve teknike të sasisë së ujit të prodhuar, gjegjësisht të ujit i cili nuk faturohet dhe nuk i sjell Kompanisë të ardhura. Uji i pa faturuar planifikohet të ulet në 45% deri në fund të vitit 2028.
2. **Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime**; janë pjesë e planit të biznesit 2026-2028, të cilat planifikohen që të realizohen me mjete vetanake të Ndërmarrjes si dhe me mjete nga donacionet nga Qeveria e Kosovës dhe bashkëfinancim me Komuna në zonën e shërbimit / Komunën e Rahovecit, Prizrenit/. Nga fillimi i vitit 2026, pritët të bëhet furnizimi me ujë me shumicë i Komunës së Mamushës ku planifikohet që shitja sipas UTSH do të jetë 0.22 cent/ m³.
3. **Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit** –gypat të cilët kanë qenë të dimensioneve të vogla për nevojat e konsumatorëve, ku kemi shtim të vendbanimeve me shtëpi, të cilat janë punuar nga materiale jo adekuate ose në ato gypa janë defektet e përsëritshme (sidomos gypat AC);
4. **Përmirësimi i funksionimit të sistemit**; Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve të reja elektrike, teknologjike dhe mjetet e reja pune etj. Investime në SCADA dhe pjese tjera përcjellëse.
5. **Projektet e planifikuara për vendosjen e ujëmatësve jashtë pronës private** – ku planifikohet vendosja e ujëmatësve të mençur në disa fshatra ku humbjet i kemi me të mëdha, ku do arrihet të bëhet zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe energjisë elektrike në disa zona, ku vlera investive planifikohet të jetë mbi: 500,000.00€.
6. **Investime në panele solare** - planifikohet investim mbi 500,000.00€, në panele solare për furnizim me energji të ripërtitshme dhe zvogëlim të energjisë elektrike sidomos në ITUN dhe ITUP.

Investimet e planifikuara në sistemin e furnizimit me ujë janë ndarë në 4 nënkategori:

- (i) investimet në burimet e reja të ujit,
- (ii) investimet në zgjerimin e sistemit të ujësjellësit,
- (iii) investimet në rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit dhe
- (iv) investimet në matje dhe automatizim.

Investimet e planifikuara në sistemin e kanalizimit janë ndarë në 3 nënkategori:

- (i) mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit,
- (ii) investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit dhe
- (iii) investime në rrjet të kanalizimit në zonat rural.

Sigurisht që parametri kryesor që influencon planifikimin e investimeve është shtimi i kërkesës për ujë që vjen si rezultat i dy elementëve:

- (i) shtimit natyror të popullsisë dhe
- (ii) rritjes së shkallës së mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, me qëllim të shtrirjes së shërbimeve në tërë zonën e shërbimit.

Arritjet kryesore pas këtyre investimeve do të jenë:

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit në rrjetë ;
- Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;
- Ndërrimi i gypave profili i të cilëve ka qenë i pamjaftueshëm për nevoja të konsumatorëve, të cilat janë punuar nga materiale jo adekuate ose në ato gypa janë defekte të përsëritshme brenda muajit;

- Kushte me të mira për punëtorët e mirëmbajtës;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke avancuar në sisteme automatike (stacionet e pompave dhe rezervuarët);
- Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve telemetrike, mjete të reja pune etj;
- Identifikimi më i lehtë i lidhjeve ilegale;
- Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe të konsumatorët;
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative të mirëmbajtjes;
- Mbatja në kontroll të vazhdueshme e furnizimit dhe cilësisë së ujit.

3.7.2 Përmbledhje e arsytive për ndryshime të mundshme në planin e biznesit nga viti paraprak. Çka duhet të jetë më ndryshe se Plani i Biznesit 2026

Ndryshimet e parashikuara nga Plani i Biznesit nga viti paraprak, arsyet për këto ndryshime i prezantojmë për secilin tregues kryesor si më poshtë;

Faturimi në euro- BP 2026 planifikohet të jetë 6,137,574 €, për 799,151€ më i lart se shënimet BP 2025. Konsiderojmë se do arrihet rritja e këtij treguesi i cili është baza e zvogëlimit të humbjeve të ujit, eliminimin e lidhjeve ilegale, paushallit si dhe rritjes së numrit të konsumatorëve si dhe implementimi i projektit për faturimin mobil në teren. Këtë tregues Kompania do ta arrij ta realizoi sipas BP të planifikuar përmes stafit të organizuar të shitjes, grupeve të caktuara sipas 5 zonave, si dhe ndihmesës së institucioneve lokale të Komunave dhe autoriteteve Qendrore .

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës -planifikohet të jetë 100% e ujit total të faturuar. Kompania përmes angazhimit të stafit të operativës do të arrij që të bej vendosjen e ujëmatësve për konsumatorët e të gjithë kategorive. Këtë ndryshim të mundshëm nga BP i vitit paraprak kompania e mbështet në arsyetimin se është një ndër objektivat dhe synimet kryesore që të eliminohen faturimi i konsumatorëve përmes paushallit, sepse është e njohur se me këtë veprim zvogëlohen humbjet e ujit tek Kompania ndërsa te konsumatori bëhet një vlerësim real i shpenzimit të shërbimit të ujit.

Arkëtimi i tërë në Euro dhe % –Arkëtimi në vlerë totale do të jetë 6,444,453€, 105 % e vlerës së faturuar. Bazohet në arsyetimin se Kompania si Ndërmarrje vetë financuese ku të ardhurat i siguron vetëm nga arkëtimi do të gjej metodat, programet më të avancuara që maksimalisht të arrij shkallen më të lartë të mundshme të arkëtitimit përmes : Organizimit të Grupeve të Kontrollës dhe shkyçjes, përcaktimin e grupeve sipas 5 zonave, rritjen e numrit të pikave të shitjes në tërë regjionin që operon Kompania, zonave për arkëtim dhe humbje të ujit, eliminimit të keqpërdorimit të ujit, ri programimet e borxheve me të gjitha kategoritë e konsumatorëve, eliminimit të humbjeve teknike, bashkëpunimit me palët e treta, Policinë, Inspektorët Komunal si dhe autoritet gjyqësore.

Shpenzimet Operative – Shpenzimet operative sipas BP 2026 do të jenë 5,422,116 euro për 1,298,283€, më të larta se shënimet e BP 2025 shkaku i rritjes se shpenzimeve të rrymës, pagave, mirëmbajtjes dhe riparimeve, kemikaleve etj. Shkaku i këtij dallimi në planifikimin e BP është se Kompania po përballet me dukurit; bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë në realizimin e Projekteve të mëdha, ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore, infrastrukturës rrugore, ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, Rritjen e inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikaleve, karburanteve të naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet), shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj.), shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet

e derivateve (përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta).

Gjatë vitit 2026 Kompania parasheh ti paguajë të gjitha shpenzimet operative për zhvillimin normal të veprimtarisë së vet normale.

Numri i Konsumatorëve- për BP 2026, janë parashikuar të jenë 53,484 konsumatorë duke u bazuar nga rritjet e viteve të Kaluara, njëjtë me numrin e konsumatorëve që lexohen me ujëmatëse. Kompania do të bëjë evidentimin në sistem të konsumatorëve të cilët furnizohen në mënyrë të pa legalizuar, do ekzekutoj dënime administrative si dhe gjoha për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm që keqpërdorin ujin. Ndërtimi i Fabrikës së dytë të ujit të pijes do të mundësohet që të rritet numri i konsumatorëve në masë të madhe sepse Kompania do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e shërbimeve të veta. Kompania në fillim të vitit 2024 ka futur në punë faturimin mobil në teren.

Prodhimi i ujit të pijes - Prodhimi i ujit për BP 2026 është planifikuar të jetë 16,687,102 m³, për 537,000m³ më shumë se BP 2025, si nevojë dhe mundësi e rritjes së numrit të konsumatorëve për shkak të rritjeve të kapacitetit të ujit për shkak të ndërtimit të Fabrikës së dytë me kapacitet shtesë 500 l/seconda m³.

Ristrukturimi organizativ – Radhitja e personelit për mes departamenteve në favor të produktivitetit të përgjithshëm, duke ngritur ato në vazhdimësi për mes përgatitjes dhe të përshtatjes profesionale; Pozicionimin dhe vërtetimin e pozitave të pa sistematizuara deri më tani dhe, sipas nevojës për pozitë e punëve të domosdoshme; Të bëhet planifikimi i mundësisë së kualifikimit të vazhdueshëm të personelit përmes shkollimit.

Zbatimi i kompjuterizimit të gjerë të kompanisë; Blerja e kompjuterëve në mënyrë të njëtrajtshme, ku me këtë do të ruhej uniformiteti performancës së tërë sistemit dhe do të ulëshin shpenzimet e mirëmbajtjes, implementimi i Intranetit të kompanisë i cili do të rrit efikasitetin e administratës, do të zvogëlonte shpenzimet administrative si dhe do të mundtë kontrollohej performanca e shërbyesve administrativ të kompanisë duke përcjellë azhureteti në administratës. Kompania në vitin 2025 ka bërë furnizim me softeverin e ri-ERP.

Sistemet të reja të menaxhimit të informacionit dhe të raporteve-Monitorimi i dhënie-marrjes së informatave mbi performancën e sistemit dhe verifikimin e furnizimit të konsumatorëve me ujë cilësor. Këto përfshijnë testimin e monitorimit analitik dhe vëzhgimor sikurse që janë inspektimet si dhe testimin Mbi Kënaqësinë e konsumatorit .

Programe të zhvillimit të burimeve njerëzore-Trajnimi i Resurseve që aktiviteti i tyre në kompanitë bëhet komfor konkurrencës së tregut, e që do të shërbejë veprimtarisë kryesore të punëve tona shërbyese, për kualitetin dhe distribuimin e ujit të pijes dhe që me këtë të arrihet përmbushja e kërkesave dhe nevojave ndaj konsumatorëve tanë;

Marrëdhëniet ndërmjet konsumatorit dhe Kompanisë sonë –Obligimin dhe angazhimi në mirëmbajtjes sipas standardeve minimale të shërbimit; Nevoja për vlerësime dhe reagime të përgjegjshme ndaj nevojave të konsumatorëve Përgjegjësi dhe në përputhje me rregullat në fuqi; Përdorimet i ligjeve aktuale në fuqi dhe kompetencave në furnizim me shërbime; dhe obligimet në përkrahje të arritjeve tekniko-teknologji kenë aplikimi në praktika vetë kohës

Informimi i konsumatorëve-Planifikimi afatgjatë i programeve komunikuese sistematike. Kjo do të siguronte të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë qasje në informacione nga keqinterpretuesit e zëshëm.

3.8. RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATES

Rreziqet kryesore që ndërmarrja do të ballafaqohet gjatë dy viteve të ardhshme

Megjithatë ndikimet që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, janë implikimet e tij në veprimtarinë e Kompanisë, janë analizuar dhe identifikuar disa nga rreziqet e mundshme që janë dhënë në vazhdim;

- Rritja e çmimeve të të gjitha furnizimeve sikur rryma, klori, derivatet, materiali i rrjetit etj;
- Rritja e nivelit të furnizimit të rajoneve me pompa;
- Ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi ;
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes;
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësishë të lartë dhe dëmtimet mekanike, ndërprerjet e tej zgjatura të furnizimit me shërbime si pasojë e fuqisë mbi natyrore;
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet,tërmetet)
- Vandalizmat dhe sabotimet;
- Si dhe ndikimi i ndotjeve të papritura (hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptazh ose në resurset ujore, neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)
- Vjetërsia e rrjetit të ujësjellësit dhe humbjet në shpërndarje
- Vjetërsia e rrjetit të kanalizimit

Komentoni në secilin rrezik që mund të paraqitet gjatë operimit të ndërmarrjes

- Kërcënimet financiare, paraqesin rrezik të veçantë dhe reflektojnë në shkaktimin e vështirësive të hyrave të pamjaftueshme të cilat pamundësojnë investimet kapitale .
- Një rrezik që duhet pasur parasysh me të cilën po ballafaqohet një pjesë e madhe e botës është edhe kriza globale, që ndikojnë në kapacitetin financiar të partnerëve afarist si dhe përkeqësimin e gjendjes ekonomike të konsumatorëve që reflekton në zvogëlimin e mundësisë së tyre për pagesën e faturave të shërbimeve për shkaqe të gjendjes së tyre ekonomike .
- Moslejimi i ngritjes së tarifave në përputhje me shpenzimet dhe investimet për zhvillimin e veprimtarisë së Kompanisë është faktor ndikues gjegjësisht që paraqet rrezik potencial për të hyrat e kompanisë.
- Kërcënim të veçantë paraqesin edhe ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi .
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes si pasojë e mos funksionimit në masë të duhur të organeve të rendit dhe Gjykatave.
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësishë të lartë dhe dëmtimet mekanike, Ndërprerjet etj. zgjatur atë furnizimit me shërbime si pasojë e fuqisë mbinatyrore
- Ndikimi i ndotjeve të papritura(hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptash ose në resurset ujore, neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet, tërmetet,vandalizmat dhe sabotimet);
- Rritja e kostonë së jetesës së konsumatorëve, si shkak i rritjes së çmimeve –inflacionit, për këtë do të kemi vështirësi në arkëtimin e borxheve të konsumatorëve të cilëve do ju rriten shpenzimet jetësore, e që do të ndikoi në pa mundësinë e tyre në kryerjen e detyrimeve;
- Furnizimi me klor të langët dhe gazët, ku çmimet për momentin janë të pa përballueshme për kompaninë.

3.8.1. Çfarë duhet të bëhet për të ulur ndikimin e secilit rrezik.

Që të ulim ndikimin e secilit rrezik që na përcillet në veprimtarinë tonë, kërkohet që të ndërmerren veprimet;

Vazhdimi i aktivitetit rreth evitimit të pengesave gjatë zhvillimit të aktiviteteve në Kompani ;

- Ngritja e vetëdijes përbrenda kompanisë mbi procedurat e veprimeve operative;
- Ngritje në cilësi të shërbimeve tona, dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe standardin e punëtorëve tanë;
- Nevojën e implementimit të Programit për zvogëlimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve të ujit, si njëra nga projektet zhvillimore për ndonjë donacion i mundshëm;
- Nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legjislative;
- Vlerësimin e aktiviteteve afariste për KRU “Gjakova” ti planifikojmë në drejtim të lëvizjeve më pozitive;
- Të rishikohen rregullisht për arritjet e praktikave më të mira të përvetësuara; Mënyrat më të mundshme të marrëveshjeve për furnizimin;
- Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit;
- Pajtueshmërinë e plotë ndaj kërkesave legjislative dhe rregullatorit Intervenime në defektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve;

Marrja e masave operative dhe juridike për eliminimin e rreziqeve të arkëtimit të hyrave –

- Kosto ekonomike të furnizimit dhe shërbimeve;
- Caktimi i tarifave mbi shërbimet dhe mbi pagesat tjera;
- Faturimi i obligimeve të konsumatorit për pagesën e shërbimeve; Informimi i konsumatorëve; Shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve;
- Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve;
- Nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legjislative;
- Rritjen e të hyrave dhe zvogëlimin e shpenzimeve;
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjetë, investime të nevojshme e të ri kthyeshe;
- Zvogëlimin e prodhimit të ujit pa dëmtuar konsumatorin;
- Arritjen e objektivave operative me një çmim kushtues sa më të vogël;
- Furnizim për mirëmbajtje me një çmim sa më të arsyeshëm, me ujëmatës;
- Rritjen e sasisë së ujit të shitur, të faturuar;
- Mbështetja në funksion të sektorit të shërbimeve për intervenime në defekte si dhe të mjeteve të punës .

Avancimi i operimit të rrjetit të ujit dhe të kanalizimit-Realizimi i projekteve përmes thithjes së donacioneve apo me mjete të Kompanisë për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit si dhe rrjetat e reja të kycjes së Konsumatorëve të rij të një komuniteti, nevojën për prodhim të ujit sa më cilësorë sipas kapaciteteve të instaluar, pajtueshmëri të plotë të resurseve në proceset e prodhimit me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të ujit, ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza etj.

Implementimi eficient i investimeve kapitale të KRU-ve-Angazhimi maksimal i Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim në hartimin e projekteve të planifikuara si dhe implementimi eficient i investimeve kapitale me theks të veçantë nga mjetet donacionet e Qeverisë; Angazhimi maksimal i Zyrës së Prokurimit në realizimin me kohë të procedurave për realizimin e tenderëve që me kohën optimal të arrihen të realizohen mjetet nga ekzekutimi i kontratave me operatorët ekonomik që mjetet të dhuruara nga Qeveria e Kosovës të mos kthehen në Buxhetin e Kosovës

Seanca takimesh dhe mbledhjesh më të shpeshta të menaxhmentit në KRU "Gjakova", Raportimet e rregullta për realizimin e Planeve dhe Programeve për masat dhe veprimet që duhet të merren nga çdo Menaxher në veprimtarinë e Departamentit që i përket për uljen e rreziqeve të mundshme që paraqiten gjatë ushtrimit të veprimtarisë në sferën e; Përmirësimit dhe ngritjes së nivelit në përmbushjen e obligimeve ndaj konsumatorëve ;Informimi i konsumatorëve, shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve, prodhimit, arkëtimit, humbjeve të ujit; Mirëmbajtjes së objekteve, intervenimet emergjente në sanimin sa më të shpejt të avarive, të shqyrtohen planet e intervenimeve emergjente në rastet e mundshme të fatkeqësive natyrore, shkatërrimit të objekteve.

Përgjigje më kreative në rastet e reagimeve emergjente ; Të përpilohen Planet dhe programet në çdo fushë të veprimtarisë për intervenime emergjente komfor legjislationit në fuqi në Kosovë si dhe akteve të brendshme në Kompani ; Të bëhet informimi i saktë dhe i shpejt i popullatës për çdo reagim emergjent në të gjitha fushat e veprimtarisë, intervenime për shkyçje si rezultat i veprimeve të natyrave të ndryshme defekte, avari të mundshme, diversione, sabotime, kushte atmosferike, shkyçje kolektive etj.

Përmirësimet në menaxhimin e aseteve; Të vazhdohet me procedura e legalizimit të gjitha aseteve të Kompanisë në emër të kompanisë si dhe vlerësimi i tyre në kontinuitet me rregullat financiare nga zyrtari i vlerësimit të aseteve; Të bëhet inkorporimi në sistem i të gjitha aseteve si dhe arkivimi i dokumentacionit për asete .

4.RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Gjatë vitit raportues, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vepruar në përputhje me planin vjetor të miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit, i cili është hartuar mbi bazën e vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve strategjike të ndërmarrjes. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 janë planifikuar për t'u realizuar shtatë auditime në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2025 duke u fokusuar në vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme, menaxhimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me legjislationin në fuqi, prej tyre gjashtë janë finalizuar, ndërsa Hartimi i Raportit "Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore" është në proces për arsye të angazhimeve të shumta përveç atyre të parapara me Planin Vjetor për vitin 2025. Përveç auditimeve të planifikuara, janë realizuar edhe tri auditime shtesë me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv, si dhe janë hartuar trembëdhjetë raporte të auditimit mbi rregullsinë përgjatë implementimit të projekteve kapitale të bashkëfinancuara nga Ministria e Ekonomisë, Komuna e Rahovecit, Komunat e Prizrenit dhe Policia e Kosovës. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë ofruar gjithashtu edhe shërbime këshilluese, duke kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe forcimin e kontrolleve të brendshme Auditimet e realizuara kanë kontribuar në identifikimin e fushave për përmirësim dhe në dhënien e rekomandimeve për forcimin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin efektiv të resurseve dhe përmirësimin e proceseve të ndërmarrjes. Funksioni i Auditimit të Brendshëm mbetet i përkushtuar në mbështetjen e ndërmarrjes për arritjen e objektivave strategjike dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Raportet lidhur me auditimet e brendshme të kryera duke i'u përgjigjur Planit Vjetor 2025 janë:

1. Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Faturimit
2. Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit
3. Sistemi për Menaxhimin e Mjetet Themelore (nga mjetet vetanake dhe format tjera të financimit)
4. Sistemi për Menaxhimin e Depove
5. Sistemi për Menaxhimin e Mardhënieve me Konsumatorë
6. Sistemi për Menaxhimin e të Hyrave në Arkë dhe në Bankë
7. Raporti i gjashtëmujorit të -I- lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën Janar deri Qershor 2025

8. Raporti i gjashtëmujorit të -II- lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën Korrik deri Dhjetor 2025 (finalizuar në Janar 2026)
9. Raporti Vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën Janar deri Dhjetor 2025 (finalizuar në Janar 2026)
10. Plani Strategjik 2026 – 2028
11. Plani Vjetor 2026

Në kuadër të aktiviteteve tjera të kryera nga Njësia për Auditim të Brendshëm, përfshihen edhe këto aktivitete:

- Hartimi i Raportit Final mbi Auditimin Ad-hoc për tri raste të prokurimit me aktivitet të njëjtë dhe krahasimi i tyre (Mirëmbajtja dhe servisimi i të gjitha automjetve të K.R.U “Gjakova” SH.A.)
- Hartimi i dy raporteve nga NJAB për Policinë e Kosovës për mbështetjen financiare të projektit kapital “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe stacionit të pompave për SPK në Qafë Morinë”
- Hartimi i një raporti nga NJAB për Komunën e Prizrenit për mbështetjen financiare të projektit kapital “Ndërtimi i Rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushës së Madhe, Piranë dhe Medvec”
- Hartimi i tri raporteve nga NJAB për Kuvendin Komunal Rahovec për mbështetjen financiare të projektit kapital “Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zojishtë dhe Opterushë dhe zonën industriale të Komunës së Rahovecit”
- Hartimi i një raporti nga NJAB për Kuvendin Komunal Rahovec për mbështetjen financiare të projektit “Rehabilitimi i ujësjellësit në fshatrat Ratkoc dhe Bratotin”
- Raporti Final i Auditimit Ad-hoc i Procesit për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit për Tenderët "Furnizim me Barkë" dhe "Furnizim me dy Kamioneta"
- Hartimi i katër raporteve nga NJAB për Ministrinë e Ekonomisë për mbështetjen financiare të projektit “Gypi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojzë, Medvec dhe Mamushë” – Faza II (vazhdimi)
- Hartimi i dy raporteve nga NJAB për Ministrinë e Ekonomisë për mbështetjen financiare të projektit “Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hilë dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës”
- Hartimi i Raportit mbi Auditimin Ad-hoc të Procesit për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit për Tenderin “Furnizim me Plomba dhe Bllokues të Valvulave” – në proces për arsye të plotësimit – ndryshimeve të kërkuara nga Komiteti i Auditimit.
- Poashtu, përveç angazhimeve në kuadër të realizimit në tërësi të aktiviteteve të Njesisë për Auditim të Brendshëm janë kryer punë dhe angazhime tjera për monitorimin e aktiviteteve dhe proceseve në kuadër të ndërmarrjes dhe konsulencës të ndryshme sipas nevojave ditore për të cilat nuk kemi lëshuar raporte.

Përmes auditimeve të finalizuara në vitin 2025 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë dhënë 35 rekomandime, prej të cilave 8 rekomandime janë implementuar, 27 rekomandime janë në proces të implementimit. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit janë raportuar në mënyrë të pavarur te njësitë e audituara, menaxhmenti dhe Komiteti i Auditimit, me qëllim adresimin e mangësive të identifikuara dhe përmirësimin e proceseve operative dhe financiare.

Zbatimi i rekomandimeve të cilat ipen nga Njësia e Auditimit të Brendshëm përgjatë një cikli të auditimit, si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Menaxhmentit të lartë dhe punonjësve në varësi të tyre, do të mundësojë që kontrolli i brendshëm dhe menaxhimi financiar të jenë në nivelin i cili siguron zbatimin e procedurave në përputhje me ligjet në fuqi, do të ndikojë që niveli i performancës të ngritet në nivelin e kërkuar, paraja publike dhe pasuria publike të menaxhohet në mënyrë efikase dhe ekonomike, sigurimin e transparencës së plotë lidhur me të gjitha aktivitetet e kryera

nga ndërmarrja, si dhe të ketë regjistrim dhe raportim të drejtë për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në ndërmarrje.

5.RAPORTIMET SIPAS LIGJIT MBI NDËRMARRJET PUBLIKE

5.1.STRUKTUARA ORGANIZATIVE AKTUALE E KRU"GJAKOVA "Sh.A.-GJAKOVË, DUKE PËRFSHIR TË GJITHA NDRYSHIMET E KONSIDERUESHME QË JANË BËRË GJATË VITIT PËRKATËS

Makro struktura e aprovuar me këto ndryshime ka ardhur si rezultat i kërkesave ligjore nga ligji mbi Ndërmarrjet Publike, Ligji i Punës, Ligji i Prokurimit Publik si dhe ligjet tjera në fuqi në Kosovë. Duke u bazuar në këtë, ndryshimet do të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe performancës së kompanisë në përgjithësi por edhe në performancën e individëve të caktuar në arritjen e objektivave të përcaktuara. Struktura organizative K.R.U."Gjakova" Sh.A.-Gjakovë e përbërë nga;

Bordi i Drejtorëve

Organ më i lartë përbëhet prej 6 drejtorë jo ekzekutiv dhe një drejtori ekzekutiv, si dhe Sekretarin e Bordit të Drejtorëve i cili ka pozitën e vëzhguesit pa të drejtë vendimmarrje.

Struktura Menaxhuese brenda në kompani

Afarizmi i Kompanisë zhvillohet nga 4 Departamente. Në strukturën Organizative janë përfshirë edhe pozita e Kryeshefit Ekzekutiv, Sekretari i Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar si dhe zyrtarit për Auditim të Brendshëm. Organizimi K.R.U. "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë, është i bazuar në afarizmin tekniko –operativ ku mbulohet me Departamentin Teknik Operativ. Afarizmi tjetër ka karakter; Projektues, komercial, ligjor, Mardhënia me Konsumator, Personelit . Në përgjithësi veprimtaria e Kompanisë mbulohet nga 4 Departamente si më poshtë;

- Departamenti Financiar
- Departamenti i Shitjes
- Departamenti i Administratës së përgjithshme
- Departamenti i Operatives Teknike

5.2.SHQYRTIMI I PERFORMANCËS AFARISTE FINANCIARE GJATË MUAJVE

JANAR – DHJETORË 2025

Në vazhdim po paraqesim draft Pasqyrat Financiare për periudhën Janar-Dhjetor 2025 të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë. Këto pasqyra janë në fazën e auditimit të jashtëm.

Tabela 19. Pasqyrat financiare deri 31. Dhjetor 2025, krahasuar me vitin 2024.

K.R.U. GJAKOVA SH.A

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

		2025	2024
	<i>Shënime</i>		
PASURIA			
Pasuria Jo-qarkulluese			
Toka, Ndërtesa, Automjetet dhe Paisjet	1	55,496,880	54,383,929
Investimet në vijim	1	5,081,298	5,361,765
Total pasuria jo qarkulluse (I)		60,578,178	59,745,694
Pasuria qarkulluese			
Të arkëtushmet tregtare dhe tjera	2	5,066,906	5,220,221
Stoqet	3	740,957	794,960
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	470,654	1,351,819
Total pasuria qarkulluese (II)		6,278,518	7,367,001
Total Pasuria (I+II)		66,856,696	67,112,695
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali Aksionar	5	25,000	25,000
Fitimi (humbja) e mbajtur	6	100,745	(517,622)
Rezerva e Rivlerësimit dhe tjerat	7	40,423,164	40,803,023.00
Total kapitali (III)		40,548,909	40,310,400
Detyrimet afatgjata			
Kreditë afatgjata			
Total detyrimet afatgjata (IV)		0	0
Detyrimet afatshkurta			
Kreditë afatshkurta			
Llogaritë e Pagueshme tregtare dhe tjera	8	244,436	61,785
Detyrime ndaj punëtorëve dhe tatime	9	97,356	61,359
Të hyrat e shtyra	10	25,965,996	26,679,151
Total detyrimet afatshkurta (V)		26,307,787	26,802,294
Total Detyrimet dhe Kapitali (III+IV+V)		66,856,696	67,112,695

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

		2025	2024
	<i>Shënime</i>		
Të hyrat			
Të hyrat	11	6,910,610.03	6,422,059.64
Gjithsej të hyrat		6,910,610.03	6,422,059.00
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	12	-3,419,484.00	-2,963,958.57
Shpenzimet operative dhe administrative	13	-1,512,867.52	-1,117,785.67
Shpenzimet e Zhvlerësimit	14	-1,876,435.84	-2,086,806.86
Gjithsej shpenzimet		-6,808,787.36	-6,168,551.10
Fitimi (humbja) nga aktivitetet operative		101,822.67	253,507.90
Fitimi (humbja) financiare			
Shpenzimet Financiare			
Gjithsej fitimi (humbja) financiare			
Fitimi (humbja) para tatimit		101,822.67	253,507.90
Tatimi në fitim		-10,182.27	-25,350.79
Fitimi (humbja) neto e vitit		91,640.40	228,157.11

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

	Kapitali investus	Fitimi (humbja) e mbajtur	Rezerva të Rivleresimit	Gjithsej
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	25,000	(121,988)	31,573,655	31,476,667
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	140,493	-	140,493
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	25,000	18,505	31,573,655	31,617,159
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(163,531)	180	(163,351)
Fitimi (humbja) e vitit	-	112,602	-	112,602
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	25,000	(32,424)	31,573,835	31,566,411
Shtim	-	-	10,979,493	10,979,493
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(15,769)	-	(15,769)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(492,586)	-	(492,586)
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	25,000	(540,779)	42,553,327	42,037,548
Shtim	-	-	(2,871)	(2,871)
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	431,386	(946,375)	(514,989)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(58,397)	-	(58,397)
Gjendja me 31 Dhjetor 2021	25,000	(167,791)	41,604,082	41,461,291
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(23,388)	(560,484)	(583,872)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(288,536)	-	(288,536)
Gjendja me 31 Dhjetor 2022	25,000	(479,715)	41,043,598	40,588,883
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	-	(132,634)	(132,634)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(266,064)	-	(266,064)
Gjendja me 31 Dhjetor 2023	25,000	(745,779)	40,910,964	40,190,185
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	-	(107,942)	(107,942)
Fitimi (humbja) e vitit	-	228,158	-	228,158
Gjendja me 31 Dhjetor 2024	25,000	(517,621)	40,803,022	40,310,401
Shtim	-	582606.05	217,047.68	799,654
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(55,881)	(596,905.67)	652,787
Fitimi (humbja) e vitit	-	91,640	0	91,640
Gjendja me 31 Dhjetor 2025	25,000	100,745	40,423,164	40,548,909

K.R.U. GJAKOVA SH.A

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	2025	2024
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi (humbja) e vitit	91,640.40	253,507.90
<i>Të korigjuara për:</i>		
Zhmerësimi	1,876,435.84	2,086,806.86
Rregullimet në Zhmersimin e Akumuluar	-	-
Provizionet e borxheve të keqja		-
Rregullime në fitime të mbajtura	(652,786.89)	(107,942.00)
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	153,314.58	347,410.94
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	182,651.08	(142,537.26)
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet ndaj punëtorëve dhe tatimeve	35,996.80	(10,202.00)
Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	(713,154.92)	3,189,217.53
(Rritja)/zvogëlimi në parapagime		-
Tatimi në fitim i parapaguar		(25,614.00)
(Rritja)/zvogëlimi në stoke	54,003.54	(59,025.44)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	1,028,100.43	5,531,622.53
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)	1,028,100.43	5,531,622.53
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(1,909,264.75)	(5,357,133.66)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)	(1,909,264.75)	(5,357,133.66)
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Huamarrjet	-	-
Arkëtimet nga donacione		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)	-	-
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)	(881,164.32)	174,487.57
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës	1,351,818.65	1,177,331.08
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit/periudhës (IV + V)	470,654.33	1,351,818.65

6. Veprimatria e zhvilluar nga Departamenti Administrativ gjatë vitit 2025

6.1 Punët e kryera nga Sekretari për Bordin e Drejtorëve Janar - Dhjetor 2025

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 13 mbledhje Bordit të Drejtorëve, 13 Mbledhje Komisionit Auditimit 13 dhe 1 Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin dhe 3 Mbledhje Jashtëzakonshme. Është bërë caktimi mbledhjeve përpilimi agjendës së mbledhjeve dhe njoftim i aksionarit për datën dhe kohën e takimeve. Përgatitja e materialeve për mbledhjet e organizuara, kompletimi i të gjithë raporteve për Departamentin Financiar, Teknik dhe Administrativ, Burimeve Njerëzore, Departamentit IT, dhe Departamenti Prokurimit. Dorëzimi i raporteve përmes emailit dhe shtypja materialeve në kopje fizike për mbledhjet e Bordit dhe Komisionit Auditimit. Përpilimi i raportit të Komisionit të Auditimit për mbledhjen e Bordit të Drejtorëve. Bordi Drejtorëve është plotësuar me 3 anëtarë të rinj me datë 14.12.2023.

Materialet e mbledhjeve janë përcjellë në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike. Janë përpiluar vendimet dhe përcjellë tek zyrtarët e Ndërmarrjes për ekzekutim.

Tabela 20. Mbledhjet e Bordit Drejtorëve dhe Komisionit Auditimit

Janar –Dhjetor 2025	Bordi Drejtorëve	Komisioni Auditimit	Mbledhjet e aksionarit / Mbledhjet jashtëzakonshme
Mbledhjet	13	13	1 / 3
Agjendat	13	13	
Draft procesverbalet	13	13	
Procesverbalet finale	13	13	

Janë përpiluar Draft procesverbalet e mbledhjeve dhe janë përcjellë tek drejtorët bordit dhe aksionari në afatin ligjor prej 7 ditësh. Procesverbalet finale janë plotësuar me përmirësime teknike nga ana e Drejtorëve të Bordit të protokolluara dhe nënshkruara dhe skanuara përcillen tek aksionari, bashkangjitur dhe vendimet e Bordit Drejtorëve.

6.2 Seksioni i Burimeve Njerëzore

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025, për të punësuarit ka hartuar të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës/ përgatitjen e pagave/barazimet/Akontacionet etj.

Tabela 21.. Lista e aktiviteteve të burimeve njerëzore

NR.	LISTA E AKTIVITETEVE, VEPRIMEVE DHE VENDIMEVE TË CILAT JANË PËRPILUAR, PËRFUNDUAR/ EKZEKUTUAR GJATË MUAJVE JANAR- DHJETOR 2025	
1	Përpilimi i Vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës	6
2	Përpilimi i Vendimit për dalje në pension	6
3	Raporti mujor për aktivitet mujore Janar- Dhjetor 2025	12
4	Raport i përditësimit të punëtorëve Janar – Dhjetor 2025 në sistem dhe raportim	12
5	Vazhdime të kontratave të punës	63
6	Raport për ARRU- ndarja e punëtorëve ujësjellës/kanalizim dhe përcjellja e të dhënave sipas kërkesës dhe formulave për raportim	Çdo 3 muaj
7	Vendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme nga punëtorët	8
8	Përpilim të Vendimeve për Pushim Vjetor	294
9	Koordinimi i Vlerësimit të Performancës me Udhëheqësit kompetent	294

10	Skanimi i të gjitha vlerësimeve të performancës dhe çdo kontrate të punës dhe vendosja në dosjen personale të tyre.	294
11	Përpilimi i aneks kontratave me ngritje page	294
12	Përgatitja e listave dhe ndryshimet në sistem për rritje rrogës baze për të gjithë punëtorët	294
13	Menaxhimi i Procedurave të rekrutimit dhe përpilimi i kontratave të punës për 20 punëtor	20
14	Përpilimi i vendimeve për refuzim të aplikacioneve të kandidatëve	24
15	Njoftimet dhe publikimet për çdo faze të rekrutimit	20
16	Përpilim i Vendimit për Pushim Mjekësor me pagës 70%- (2 vendime)	2
17	Përgatitja në Excel për ato specifikave të tenderit të BNJ të cilat janë kryer dhe ato të cilat nuk janë kryer (1).	1
18	Përgatitja në Excel për të gjitha pozitat në rregullore të lira dhe të plotësuara	1
19	Raporti i Përditësimit të numrit të punëtorëve për Muajin Dhjetor 2025 përmes programit	1
20	Përpilim i Vendimeve për Ushtrues Detyre	9
21	Vendime për Hapje të konkurseve	10
22	Vendime për anulim të konkurseve	5
23	Përpilim të vendimeve për formim të Komisioneve disiplinore	2
24	Përpilim të inicimeve të procedurës disiplinore	11
25	Vërtetim për konfirmim të marrëdhënies së punës	15
26	Përgatitja e Pagave për çdo Muaj Janar- Dhjetor 2026	12
27	Përcjellja/printimi i pagesave të pagave tek financat /Kontributet/tatimet etj.	12
28	Përditësimi i tabelës me të dhënat e punëtorëve për llogaritjen e orëve në Excel.	12
29	Mbushje të formularëve për kredi/ndalesa administrative për punëtor	24
30	Përpunimi i të dhënave për ditët e shfrytëzuara të pushimit vjetor/mjekësor/	Çdo muaj
31	Analiza statistikore për numrin e femrave/meshkujve, grup - moshave, përkatësive etnike, departamenteve, shkollimit etj.	Çdo muaj
32	Përcjellja/printimi i pagesave të pagave për financa	Çdo muaj
33	Përditësim i data bazës për punëtor në mënyrë të vazhdueshme	Çdo muaj
34	Barazimet/ akontacionet.	Çdo muaj
35	Menaxhimi ditor i hyrje/daljeve të punëtorëve, pushimeve vjetore, mjekësorë etj.	Çdo ditë
36	Pagat gjithnjë të llogaritura në kohën e duhur.	Çdo muaj
37	Llogaritja e pagave për të gjithë punëtorët në baze të karnetit për çdo departament/Njësi në baze të vendimeve, dhe akontacioneve të nënshkruara nga departamenti financiar të llogaritura me kohe dhe saktësi, të dërguara për ekzekutim tek Financat sipas afatit.	Çdo muaj
38	Kontrollimi ditor i hyrje/daljeve të punëtorëve nga Zyrtari/ja i/e Burimeve Njerëzore dhe raportimi i rregullt për pushime dhe koordinimi i rregullt i pushimeve vjetore me udhëheqësit në baza ditore	Çdo ditë
39	Kontrollimi dhe barazimi i karnetave të orëve të punëtorëve me udhëheqësit kompetent.	Çdo muaj
40	Asistimi dhënë punëtorëve në mbushjen e formularëve për pushim vjetor dhe koordinimi i pushimeve vjetore të punëtorëve me udhëheqësit kompetent.	Çdo ditë

Në vazhdimësi janë realizuar të gjitha aktivitetet dhe kërkesat e nevojshme që dalin nga marrëdhënia

e punës në përputhje me kërkesat e stafit të kompanisë dhe dispozitave ligjore në fuqi. BNJ luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e suksesit të ardhshëm të KRU-Gjakova Sh.a, duke vepruar kështu, udhëhiqet nga vizioni i saj afatgjatë për të punuar dhe për të krijuar një mjedis ku punonjësit mund të zhvillohen, dhe për të ofruar performancë të qëndrueshme organizative. Veçanërisht, disa prioritete strategjike afatgjata janë identifikuar për BNJ:

Tabela 22.-Numri i punëtorëve dhe ndryshimet Janar-Dhjetor 2025 dhe krahasimi me BP.

Numri i Përgjithshëm i punëtorëve Janar 2025	297
Numri i Përgjithshëm i punëtorëve Dhjetor 2025	301
Numri i Punëtorëve sipas Planit të Biznesit të aprovuar 2025	320

Tabela 23 - Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve

Nr. i përgjithshëm i punëtorëve	Meshkuj	Femra	TOTALI
Doktor	2	0	2
Magjistër	10	13	23
Fakultet	50	21	71
Shkollë të Lartë	4	2	6
Shkollë të Mesme	155	11	166
Shkollë Filllore	29	4	33
Totali	250	51	301

Tabela 24. Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve (%)

Kualifikimi i Punëtorëve-Gjendja: Janar - Dhjetor 2025						
Doktor	Master	Fakultet	Shkollë e Lartë	Shkolle e Mesme	Shkolle Filllore	Gjithsejtë
2	23	71	6	166	33	301
0.66%	7.64%	23.59%	1.99%	55.15%	10.96%	100.00%

Tabela 25. Ndarja gjinore në Kompani, raporti 18 % deri 82% në favor të punëtorëve meshkuj.

Gjinia	Numri	Përqindja/%
Femra	51	16.95%
Meshkuj	250	83.05%
Total	301	100.00%

Tabela 26- Numri i minoriteteve të përfshira në numrin e Përgjithshme të punëtorëve ku afërsisht 4% e punëtorëve i përkasin pakicave kombëtare/minoritete.

Nacionaliteti Përkatësia etnike	Shqiptarë	Egjiptas	Rom	Boshnjake	Turk	Serb	Totali
Numri i Punëtorëve	290	7	1	1	1	1	301
Përqindja %	96.35%	2.33%	0.33%	0.33%	0.33%	0.33%	100.00%

Tabela 27 – Profili i moshës së stafit të KRU Gjakova Sh.A.

Mosha e punëtorëve	Numri i punëtorëve	Përqindja
19-29	19	6.31%
30-39	80	26.58%
40-49	57	18.94%
50-59	83	27.57%
60-65	62	20.60%
Totali	301	100.00%

Tabela 28 – Departamentet organizative në kuadër të Kompanisë

Nr.	Departamenti	Numri i punëtorëve
1	Departamenti i Administratës/Burimeve Njerëzore	48
2	Departamenti Komercial	88
3	Departamenti Financiar	12
4	Departamenti Teknik -GJK	94
4.1	Njësia Operative-Prizren	25
4.2	Njësia Operative-Rahovec	28
	Zyra e IT-së	3
	Zyra e Prokurimit	3
	Totali në të gjitha Departamentet	301

6.3 Seksioni ligjorë

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatat, Prokuroritë Themelore si dhe atyre të Apelit në Republikën e Kosovës, si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.

Tabela 29. Padi në procedure Civile K.R.U. “Gjakova” palë paditëse

Nr.	E paditura	Lloji dhe nr. i lendes	Kronologjia (Akti i fundit)
1	Administrata Tatimore Kosovës	KF.nr.704/22	AKTVENDIM – Caktohet eksperti financiar Ukshin Vllasa, për kontestin tregtar administrativ me bazë juridike anulim vendimi për vlerësimin tatimor.
2	AKP- NSH-Ereniku – Prodhimtaria Primare	C-IV-15-1900	Zyra ligjore përmes Parashtresës ka dorëzuar Fjalën Përfundimtare me dt. 08.12.2025.
3	Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL- NSH. “Ereniku-Tregtia”	C-IV-15-1912	Zyra ligjore ka pranuar AKTGJYKIM-in, AC-I-23-0760, nga Gjykata Supreme e Kosovës – Kolegji i Apelit i Dhomës Posaçme, Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar ndërsa VËRTETOHET Aktgjykimi i shkallës parë, C-IV-15-1912, Ndaj të paditurës Autoriteti i likuidimit: NSH. “Ereniku-Tregtia” -Vendimi PEJ135-005.
4	Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL- NSH. “Nëntori”	C-IV-23-0475	Zyra ligjore duke u bazuar në URDHËRIN e Gjykatës ka dorëzuar Parashtresën, C-IV-23-0475, në Gjykatën Supreme të Kosovës – Dhoma Posaçme, për çështjen Juridike të Autoritetit të likuidimit: AKP, NSH. “N.N.9 Nëntori” -Vendimi PEJ062-0012. Zyra ligjore ka pranuar AKTGJYKIM-in, nga Gjykata Supreme e Kosovës – shkalla e parë e Dhomës Posaçme, REFUZOHET Ankesa e K.R.U. “Gjakova” si e pabazuar ndërsa VËRTETOHET vendimi i Autoriteti i likuidimit: NSH. “Nëntori” -Vendimi PEJ062-0012.
5	Agjencia për Informim dhe Privatësi - Prishtinë	AA.nr.267/2025	Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë AKTVENDIM Refuzohet e pathemeltë ankesa e propozuesit(kompanisë), ndërsa është VËRTETUAR aktvendimi i Themelores A.nr.422/2025 – çështje Administrative.
6	Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL- NT- Agimi-	C-IV-15-1055	Zyra ligjore ka dorëzuar Parashtresën, C-IV-15-1055, në Gjykatën Supreme të Kosovës – Dhoma Posaçme, për çështjen Juridike të Autoritetit të likuidimit: AKP, NT AGIMI-Vendimi PEJ134-0018.
7	Komuna e Rahovecit - Zjarrëfiksat	KE.nr.2537/22	AKTVENDIM-in, KE.nr.2537/22, nga Gjykata Komercial në Prishtinë- Dhoma shkallës së Parë, për çështjen Juridike të kompensimit të borxhit ndaj të paditurit: Komuna e Rahovecit-Zjarrëfiksat, APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.R.U. “Gjakova” për shumën e borxhit prej 96.96 euro për periudhën 01.04.2007 deri 01.01.2010, REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër për shumën 550.10 euro. Zyra ligjore brenda afatit ka parashtruar Ankesë

			në Gjykatë të Shkallës së Dytë.
8	Agjencia për Informim dhe Privatësi - Prishtinë	A.nr.422/2025	•Zyra ligjore ka pranuar AKTVENDIM-in, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për çështjen juridike kundër të paditurës: Agjencia për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr. 1132/20, të dt. 29.01.2025, SHPALLET JOKOMPETENTE në pikëpamje lëndore, dhe lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale – Departamenti për çështje Administrative.
9	Komuna e Rahovecit - Rahovec	C.nr.252/2025	-Zyra ligjore ka dorëzuar PADI për Kompensimin e Paluajtshmerisë, në Gjykatën Themelore – Dega në Rahovec, në emër të K.R.U. “Gjakova” Sh. A, si pas-ardhës juridik i Bashkësisë së Ujërave Lumbardhi – Prizren, padi ndaj Komunës së Rahovecit. -Zyra ligjore ka pranuar Përgjigjen në Padi nga Komuna e Rahovecit, ku kompania ka dorëzuar PADI për Kompensimin e Paluajtshmerisë, në Gjykatën Themelore – Dega në Rahovec, në emër të K.R.U. “Gjakova” Sh. A, si pas-ardhës juridik i Bashkësisë së Ujërave Lumbardhi – Prizren.
10	Komuna e Rahovecit - Rahovec	C.nr.322/2021	Zyra ligjore ka pranuar AKTGJYKIM-in, C.nr.322/2021 nga Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, për çështjen juridike vërtetim pronësie kundër të paditurës: Komuna e Rahovecit, Rahovec, REFUZOHET në tërësi kërkesëpadija e paditëses K.R.U. “Gjakova”, me të cilën ka kërkuar që të VËRTETOHET se paditësja është pronare e ngatrrës kadastrale nr.1054-0 ZK Krushë e Madhe-Rahovec, me kulturë ndërtimore oborr në sipërfaqe prej 388m2, dhe shtëpi ndërtësë në sipërfaqe prej 260 m2. Zyra ligjore ka dorëzuar ANKESË ndaj Aktgjykimit C.nr.322/2021 të gjykatës themelore në Gjakovë dega në Rahovec.
11	Komuna e Rahovecit - Rahovec	Padi për anulim vendimi nr.03/2025, dt.11.07.2025, Drejtoria Inspektuese	Zyra ligjore ka dorëzuar Padi ndaj Komuna e Rahovecit – Rahovec, Komisioni për Shqyrtim të Ankesave, për anulimin e vendimit nr.3/2025 i dt. 11.07.2025, si dhe vendimi i shkallës parë Drejtoria për Punë Inspektuese nr. 2038, dt. 16.06.2025, për shqiptim gjobë prej 5000 euro.

Tabela 30. Padi në procedure Civile K.R.U. “Gjakova” palë e paditur

Nr.	Paditësi	Lloji dhe nr. i lendes	Kronologjia (Akti i fundit)
1	Nexhat Sefa - Gjakovë	C.nr.1236/23	Me PARASHTRESË Gjykatës i është dorëzuar fjala përfundimtare apo përmbledhja e aspekteve faktike dhe juridike të çështjes. Po ashtu autorizuari i paditësit ka dorëzuar fjalën përfundimtare. -Zyra ligjore ka dorëzuar ANKESË-n, C.nr.1236/23, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për çështjen Juridike të Paditësit: Nexhat Sefa nga Gjakova, ankesë e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.1236/23. Paditësi ka bërë përgjigje në ankesë.
2	Feta Hoti - Ratkoc	C.nr.1146/2024	Aktvendim i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, DETYROHET e paditura K.R.U “Gjakova” Sh. A, që brenda afatit ligjor të paraqes Përgjigje në Padi. Zyra ligjore ka dorëzuar Përgjigje në Padi.
3	Rinor Lama - Gjakovë	A.nr.1490/2023	AKTGJYKIM-in, A.nr.1490/2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për çështjen konfliktit administrativ të paditësit: Rinor Lama nga Gjakova, REFUZOHET në Tërësi i Pa Bazuar kërkesëpadija e paditësit Rinor Lama. Paditësi ka bërë Ankesë ndaj Aktgjykimit.
4	Shqipe Beqa - Gjakovë	A.nr.2897/22	Aktgjykimi A.nr.2897/22, me të cilin është Refuzuar si e bazuar Kërkesëpadija e paditëses Shqipe Beqa me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i paditurës MFPT, të trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës IP 780, të dt. 29.11.2022. -Ankesë e pranuar nga paditësja Shqipe Beqa kundër kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2897/22, të dt. 18.02.2025.
5	Beqir Zeqiroviq – Ljubinje e Epërme	AC.nr.8833/22	Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Rev.nr.27/2025, Refuzohet i pa bazuar revizioni i paditësit Beqir Zeqiroviq kundër aktgjykimit të Apelit.
6	Shaqir Vula, Florent Vula dhe Agron Vula – Gjakovë	A.nr.1735/2018	Gjykata Themelore Prishtinë AKTGJYKIM A.nr.1735/2018, Refuzohet i pa bazuar Kërkesëpadija e paditësit Shaqir Bula nga Gjakova me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i ARRU-së 169/18, dt. 19.07.2018, si i pa

			bazuar. -Zyra ligjore ka pranuar Ankesën nga Paditësit: Shaqir Vula dhe Florent Vula, ankesë kundër Aktgjykimit A.nr.1735/2018, Të Gjykatës themelore në Prishtinë.
7	Gazmend Mulaj – Llukë e Epërme	C.nr.76/25	Aktvendim i Gjykatës Themelore në Gjakovë, DETYROHET e paditura K.R.U “Gjakova” Sh. A, që brenda afatit ligjor të paraqes Përgjigje në Padi. Zyra ligjore ka dorëzuar Përgjigje në Padi.
8	Blerina Zhubi-Meka - Gjakovë	C.nr.733/24	Gjykata me dt. 25.03.2025, ka marrë këtë Aktvendim - KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses Blerina Meka pas parashtrësës së dorëzuar në gjykatë me dt.11.03.2024, nga paditësja.
9	Nikë Gjeloshi - Gjakovë	C.nr.1757/21	Gjykata me dt. 20.03.2025, ka marrë këtë Aktvendim - KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit Nikë Gjeloshi pas parashtrësës së dorëzuar në gjykatë me dt.10.03.2024.
10	Visar Hasi	C.nr.1635/23 – Kontest Punë - Anulim Vendimi	Aktvendim i Gjykatës Themelore në Gjakovë, DETYROHET e paditura K.R.U “Gjakova” Sh. A, që brenda afatit ligjor të paraqes Përgjigje në Padi. Zyra ligjore ka dorëzuar Përgjigje në Padi.
11	Adnan Nurkasa - Rahovec	Ac.nr.3838/2024	Gjykata Apelit në Prishtinë, AKTVENDIM, Aprovohet ankesa e paditurës K.R.U. “Gjakova” Sh. A, Prishet Aktgjykimi i Gjykatës Themelores Gjakovë-Dega Rahovec C.nr.224/2023, çështja kthehet në rivendosje të njëjtës gjykatë.
Gjakovë, Rahovec dhe Prizren	Pajisjet Mbrojtëse për Punëtorët Gjatë asistimeve në njësi dhe vendpunishte është vërejtur se: - Punëtorët në disa raste nuk kanë pasur pajisjet mbrojtëse personale të plota (helmeta, doreza, çizme, jelekë reflektues). - Janë identifikuar pajisje të dëmtuara ose të konsumuar, të cilat nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme. Në zonat e gërmimeve me ekskavator mungojnë pajisjet specifike të mbrojtjes dhe mbikëqyrja operative është e ulët. - Në vendpunishte mungon sinjalistika paralajmëruese e dukshme gjatë intervenimeve në terren. 2. Njësitë e Kanalizimit (Gjakovë dhe Rahovec) Gjendja e konstatuar tregon se: - Punëtorët në kanalizim nuk posedojnë pajisje të plota për ekspozim me ujë të ndotur (maskë, doreza të forta, çizme të larta). - Mungojnë pajisjet bazike higjieno-sanitare në terren (dezinfektues personal, materiale pastruese). - Nuk ekziston pajisje ndihmëse për punë në hapësira të mbyllura si pusët. - U vërejt mungesa e vazhdueshme e furnizimit me qumësht për punëtorët e	1. Pajisjet mbrojtëse për punëtorët Masat e ndërmarra - Është nisur procedura e tenderit për furnizim me pajisje personale mbrojtëse. - Është përgatitur lista paraprake e pajisjeve sipas pozitave të punës. - Punëtorët janë njoftuar për detyrimin për mbajtjen e pajisjeve mbrojtëse. Masat që duhet të ndërmerren - Të finalizohet porosia dhe shpërndarja e pajisjeve për të gjithë punëtorët. - Të sigurohet pajisja speciale për punimet me azbest (maskë, syze, doreza). - Udhëheqësit e njësive të monitorojnë detyrimisht mbajtjen e pajisjeve. - Punëtorët të nënshkruajnë marrjen e pajisjeve, të ruhet evidenca individuale. 2. Punimet në gërmime dhe sinjalistika Masat e ndërmarra - Janë evidentuar vendet ku mungojnë pajisje të mbrojtjes dhe shenja paralajmëruese. - Janë komunikuar kërkesat për shënjim të zonave të punimeve. Masat që duhet të ndërmerren - Të porositen mbrojtje përcjellëse për ndarjen e zonës së punimeve në gërmime (metal/druri). - Të vendoset sinjalistikë paralajmëruese gjatë çdo defekti në rrugë. - Të sigurohet mbikëqyrje e vazhdueshme nga udhëheqësit e njësive. 3. Siguria në njësitë e kanalizimit (Gjakovë & Rahovec) Masat e ndërmarra - Janë identifikuar nevojat për pajisje specifike për kanalizim. - Janë raportuar mungesat e PPE dhe higjienës në terren. Masat që duhet të ndërmerren - Furnizimi me maska, doreza, çizme të forta dhe uniforma adekuate.

kanalizimit – praktikë e pranishme në shumicën e ndërmarrjeve të ujësjellës-it për arsye higjienike dhe mbrojtëse. 3. Kontakt me materiale të rrezikshme - Në punimet me gypa të azbestit mungojnë maskat adekuate për filtrimin e grimcave. - Nuk konstatohet mbrojtje specifike për punime me rrezik respirator. 4. Pajisjet Kundër Zjarrit - Aparatet kundër zjarrit ekzistojnë në të gjitha njësitë. - Në asistimet është konstatuar se një pjesë e aparateve është e skaduar dhe kërkon rimbushje. - Evidenca e gjendjes së tyre është e rregullt në të gjitha lokacionet. 5. Evidenca dhe Mbikëqyrja Operative - Nuk ekziston evidencë e përditësuar për shpërndarjen dhe disponueshmërinë e pajisjeve mbrojtëse. - Njësitë ndryshojnë në nivelin e disiplinës dhe zbatimit të përdorimit të PPE nga punëtorët. - Vërehet varësi e lartë nga përgjegjësit lokalë të njësive për zbatimin e rregullave të sigurisë. Përmbledhje e përgjithshme Gjendja aktuale e sigurisë në punë tregon se: - Pajisja personale mbrojtëse është e paplotë ose jo e përdorur rregullisht. - Njësitë e kanalizimit janë zona me ekspozimin më të lartë ndaj rrezikut dhe mungesave të evidentuara. - Pajisjet kundër zjarrit janë në vend, por dhe në gjendje optimale në të gjitha lokacionet. - Mungesa e shenjave dhe sinjalistikës në terren paraqet rrezik të shtuar për punëtorët dhe publikun. - Ekziston nevojë për sistematizim dhe kontroll më të rregullt të pajisjeve, si dhe dokumentim të saktë të tyre.	- Pajisje të posaçme për punë në pusët dhe hapësira të mbyllura. - Organizim i sigurt i hyrjeve në pusët e kanalizimit (dezinfektim pas punës). - Të shqyrtohet rikthimi i furnizimit me qumësht për punëtorët e kanalizimit. 4. Pajisjet kundër zjarrit Masat e ndërmarra - Aparatet kundër zjarrit janë kontrolluar gjatë vitit. - Është nisur procesi i rimbushjes dhe servisimit gjashtëmujor. - Pajisjet janë vendosur në pikat e duhura. Masat që duhet të ndërmerren - Të vazhdohet me kontrollin periodik sipas afatit 6-mujor. - Të mbahet evidencë e pauzave të skadimit dhe përdorimit. - Të sigurohet që çdo njësi ka pajisje të lehtësisht të qasshme. 5. Trajnimet dhe vlerësimi i riskut Masat e ndërmarra - Janë nisur procedurat e tenderit për vlerësimin e riskut për ndërmarrjen. - Është planifikuar përfshirja e trajnimit në proces sipas pozitave të punës. Masat që duhet të ndërmerren - Trajnime të sigurisë për: për të gjithë punëtorët dhe të gjitha pozitat e punës. - Edukim praktik për përdorimin e PPE dhe ndërhyrje emergjente. 6. Evidenca dhe kontrolli operacional Masat e ndërmarra - Janë mbledhur të dhënat për pajisjet e shpërndara dhe nevojat shtesë. - Është paraparë regjistri i pajisjeve sipas njësive dhe punëtorëve. Masat që duhet të ndërmerren - Krijimi i regjistrit elektronik me afatet e përdorimit dhe skadimit. - Kontroll periodik në terren për respektim PPE dhe sinjalistikë. - Njoftim zyrtar i punëtorëve për përgjegjësitë dhe pasojat disiplinore
--	--

Tabela 39. Aparatet e zjarrfikës (Modelet që kemi në posedim)

Aparatet e zjarrfikës (Modelet që kemi në posedim)	Numri i aparateve të zjarrfikës	Afati i rimbushjes së aparatëve
Aparat zjarrfikës P – 6	34	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës P – 9	46	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës P – 50	3	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës CO2- 5	12	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës CO2- 30	2	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës AU-10	6	Nëntor 2025 – Maj 2026

Aparat zjarrfikës me pluhur 1 kg	32	Nëntor 2025 – Maj 2026
Aparat zjarrfikës me pluhur 2 kg	20	Nëntor 2025 – Maj 2026
Shqyrtim hidrostatik i rrjetit të Hidrantëve	19	Nëntor 2025 – Maj 2026
Kutia e ndihmës së parë	7	Nëntor 2025 – Maj 2026
Total	181	

Njësia mbrojtja në punë dhe Siguria e Punëtorëve. Gjatë vitit 2025, Njësia e Mbrojtjes në Punë dhe Sigurisë së Punëtorëve ka vazhduar realizimin e aktiviteteve funksionale me qëllim sigurimin e një mjedisi pune të sigurt, mirëmbajtjen e infrastrukturës së objekteve, monitorimin e hapësirave kritike dhe trajtimin e çështjeve të sigurisë së personelit.

Puna është karakterizuar nga ndërhyrje të rregullta në terren, asistencë operacionale për njësitë teknike dhe koordinim të vazhduar me strukturat e kompanisë, duke ruajtur funksionalitetin e sistemeve të sigurisë dhe standardet e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHP).

1. Aktivitetet e Zbatuara gjatë Vitit

a) Mirëmbajtja e Infrastrukturës

- Pastrim dhe sistemim periodik i hapësirave përreth stacioneve të pompave dhe rezervarëve
- Përmirësim i qasjes në objekte teknike, veçanërisht në periudhat me reshje, erëra dhe barishte të rritura
- Rregullimi dhe riparimi i dymëve, rrethojave dhe elementeve mbrojtëse
- Pastrimi i rrugëve dhe hapësirave qarkulluese në zonën e Liqenit të Radoniqit dhe stacioneve të filtrimit
- Propozime për lidhje kontraktuale me kompani të specializuara për mirëmbajtje periodike të hapësirave të jashtme

b) Sistemet e Sigurisë Fizike

- Kontroll, servis dhe pastrim i kamerave të sigurisë dhe ndriçimit në të gjitha objektet kyçe
- Mbajtja funksionale e pajisjeve paralajmëruese dhe mbrojtëse
- Heqje, mirëmbajtje dhe konservim i instalimeve sezonale dhe dekorimeve të festave

c) Mbrojtja e Digës dhe Liqenit të Radoniqit

- Mbështetje e vazhdueshme për ekipet e kanalit derivues dhe monitorimit
- Parandalim i peshkimit ilegal dhe menaxhimi i mbeturinave
- Sistemim i rrethojave të dëmtuara dhe mbikëqyrje e zonës sanitare
- Pastërti dhe ndërhyrje të vazhdueshme në rezervuarë e rrugë qasjeje drejt stacioneve të filtrimit

d) Hapësirat gjelbëruese dhe ambientet e jashtme

- Mirëmbajtje e vazhdueshme e gjelbërimit nga rojet dhe personeli
- Pastrim i oborreve, rrugëve të brendshme dhe ambienteve përreth objekteve
- Menaxhim i shkurreve dhe barit në bashkëpunim me resurset e brendshme të kompanisë

2. Masat e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHP)

- Rikujtimet e vazhdueshme për përdorim të pajisjeve mbrojtëse personale (PPE)
- Asistencë dhe koordinim me Inspektoratin e Punës në rastet e incidenteve
- Përgatitje dhe planifikim për vlerësimin e ri të riskut dhe trajnime të personelit
- Ndjekja e situatave të lëndimeve, dokumentim dhe rekomandime parandaluese

3. Incidentet, Lëndimet dhe Menaxhimi i Rrezikut

- Regjistruar disa raste lëndimesh me pasoja të lehta gjatë vitit (në terren dhe gjatë punimeve teknike)
- Për dy tremujorë nuk është regjistruar asnjë incident
- Procedura standarde të zbatuara për trajtim, raportim dhe analizë të shkaktarëve
- Rikujtime dhe ndërgjegjësim të shtuar pas çdo rasti

4. Sfidat e Identifikuara

- **Mungesa e automjetit të dedikuar për Njësine,** duke kufizuar efikasitetin dhe reagimin në kohë
- Resurse të kufizuara teknike për mirëmbajtjet masive dhe emergjente
- Nevoja për buxhet specifik për riparime, pajisje mbrojtëse dhe ndërhyrje preventive

5. Rekomandime Strategjike për Vitin 2026

- Sigurimi i një automjeti zyrtar për Njësine e Mbrojtjes në Punë dhe Sigurisë së Punëtorëve

- Planifikim dhe financim i rregullt për mirëmbajtjet operative dhe pajisjet e sigurisë
- Bashkëpunim i zgjeruar ndërmjet njësive teknike, operacionale dhe menaxheriale
- Formalizim i kontratave për mirëmbajtje të hapësirave të jashtme (shërbime të kontraktuara dy herë në vit)
- Vazhdimi i trajnimeve të SHP, përfshirë vlerësimin sistematik të riskut dhe përditësimin e dokumentacionit ligjor

Përfundim

Viti 2025 ka qenë një periudhë dinamike dhe e suksesshme për Njësinë e Mbrojtjes në Punë dhe Sigurisë së Punëtorëve, pavarësisht sfidave të hasura.

Puna e vazhdueshme në terren, kontrolli teknik i objekteve dhe përqendrimi ndaj standardeve të SHP-së kanë kontribuar drejtpërdrejt në:

- ✓ Rritjen e sigurisë së personelit
- ✓ Funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e aseteve teknike
- ✓ Mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe zonës së Liqenit të Radoniqit
- ✓ Përmirësimin e kushteve të punës në të gjitha lokacionet

Përkushtimi dhe profesionalizmi i stafit të njësive përbëjnë një bazë të fortë për vazhdimin e punës në vitin 2026 dhe për ngritjen e standardeve të sigurisë dhe të operimit brenda kompanisë

6.5 Seksioni i Arkivit

Njësia ka vijuar pandërprerë punën me proceset që kanë të bëjnë me administrimin, përpunimin përdorimin dhe informimin në lidhje me dokumentet e Ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025 janë rregulluar dhe përpunuar lëndët arkivore dhe janë ndarë si në vijim: Departamenti i Administratës së përgjithshme janë rregulluar dhe përpunuar gjithsejtë 113 dosje-folderë, Departamenti Financiar 24 dosje-folder Departamenti Komercial 526 dosje-folderë, konsulenca 57 dosje. Sa i përket shërbimit me dokumente arkivore gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 2 kërkesa për qasje në dokumentacion.

Tabela 40. Raporti i dokumenteve, lëndëve, dosjeve të regjistruara dhe dokumentet e dorëzuara me kërkesë gjatë vitit 2025

Janar – Dhjetor 2025	Dosje- folderë	Të dorëzuara me kërkesë
Departamenti Administrativ	113	2
Departamenti Financiar	24	
Departamenti Komercial	526	
Konsulenca	57	
Totali	720	2

Sa i përket protokollit, ju njoftoj se gjatë vitit 2025 janë protokolluar gjithsejt 3,470 shkresa ku 416 nga to janë nga përbrenda kompanisë dhe 293 shkresa janë të pranura nga palët e jashtme. Sa i përket dërgesave postare, gjatë kësaj periudhe janë kryer 61 dërgesa të destinuara për institucione apo persona fizik.

Tabela 41. Raporti i shkresave të protokolluara dhe të dorëzuara me postë gjatë vitit 2025

Nr. i dokumenteve të protokolluara dhe të dorëzuara me postë gjatë vitit 2025			
Janar – Dhjetor 2025	Të brendshme	Të jashtme	Totali
Protokolli	2,338	1,132	3,470
Dërgesat me postë	61		61

6.6 Veprimtaria e zhvilluar nga sektori i Teknologjisë Informatike gjatë vitit 2025

Departamenti i Teknologjisë Informatike

Zyra e Teknologjisë Informatike (ZTI) është sektor i cili është në shërbim të gjitha departamenteve dhe njësive tjera të kompanisë dhe i cili ua lehtëson atyre punët në fusha të ndryshme të veprimtarisë. Teknologjia Informatike është sektori i vetëm në të cilin nuk mund të vendosësh një cak. Vendosija e një caku do të thotë përfundimi i garës në cak, por ndërkohë caku është larguar për shkak të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë. Ne jemi duke bërë përpjekje maksimale që ky cak të mos na largohet por të jemi sa më afër tij.

Vitin 2025 zyra e Teknologjisë Informatike ka pas një aktivitet të ngjeshur në përmirësimin e saj në të gjitha fushat që i mbulon stafi i saj. Pas shumë vitesh kemi ndërtuar një sistem krejt të ri të rrjetëzimit të kompanisë duke shfrytëzuar teknologjitë më moderne dhe pajisjet më të sofistikuar për një sistem të sigurtë, gjithmonë duke pasur parasysh kostot. Kjo infrastrukturë e re na ka mundësuar që edhe konfigurimi i sistemit të ndryshoj në formë drastike duke përdorë platformat më të reja.

Siguria kibernetike vazhdon të jetë brenga, shqetësimi dhe kërcënimi kryesorë për të gjithë profesionistët e teknologjisë informatike sidomos me avancimin e Inteligjencës Artificiale. Kërcënimet e sigurisë kibernetike kanë vazhduar të evoluojnë, duke bërë të nevojshme monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kompanisë. Investimet vitet në vazhdim duhet të fokusohen në dy drejtime kryesore: parandalimin dhe aftësinë e rekuperimit të të dhënave në rast të penetrimit. Edhe pse ne i kemi rritur masat e sigurisë, sot është bërë kërkesë imediate siguri i redundancës në rast të ngjarjeve katastrofike. Kërkesa për mbështetje si në aspektin e know-how ashtu edhe në aspektin teknologjik, është rritur dhe kjo mund të vendos një tendosje në burimet e departamentit si në aspektin buxhetor ashtu edhe në atë të burimeve njerëzore.

Arritjet:

Viti 2025 ka shënuar arritjet më të larta që nga fillimi i aplikimit të teknologjisë informatike në kompani, si në aspektin e harduerik ashtu edhe në aspektin softuerik. Më poshtë janë listuar këto arritje duke përdorë një gjuhë të thjeshtë për të mos e komplikuar shpjegimin e punës së komponentëve të implementuara.

1. Infrastruktura dhe Rrjeti

Arritja kryesore e këtij viti është ekzekutimi i rrjetës së re kompjuterike në Drejtori të KRU Gjakova dhe konfigurimi i rrjetës së re. Me këtë rast janë ndërruar të gjitha pajisjet të cilat më parë kanë mundësuar komunikimin si brenda kompanisë, ashtu edhe jashtë saj. Gjithsejtë janë ndërruar 16 pajisje të reja. Siç e kemi cekur edhe në raportin e vitit të kaluar aspekti kryesor i rrjetëzimit është mbikëqyrja e rreptë e mënyrës së ekzekutimit të rrjetës. Stafi i TI së kompanisë ka qenë i pa kompromis në këtë aspekt dhe nuk ka lejuar asnjë lëshim si në aspektin e ekzekutimit fizik ashtu edhe në konfigurimin e saj softuerik. Ekzekutimi është bërë sipas standardit ndërkombëtar ANSI/TIA-568-C.2. Ne e kemi monitoruar me përpikëri ekzekutimin e punimeve si dhe i kemi asistuar sipas njohurive tona sepse ekzekutimin e ka vështirësuar shume mungesa e planeve të instalimeve të murit.

Kemi krijuar VPN site-to-site përmes protokollit WireGuard për njësitë operative në distancë, duke siguruar komunikim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Po ashtu kemi bërë edhe implementimi i lidhjes përmes Cloudflare Tunneling për mundësimin e komunikimit të sigurt nga jashtë me API-të e kompanisë.

2. Virtualizimi dhe Platforma Moderne

Virtualizimi i sistemeve operative duke përdorur Docker Containers, duke rritur fleksibilitetin dhe aftësinë e sistemit për zgjerimin e shërbimeve.

Krijimi i platformës për menaxhimin e Docker containers, duke standardizuar dhe thjeshtuar instalimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve.

Implementimi i NGINX si zgjidhje open-source për web serving, reverse proxy, caching dhe load balancing.

3. Monitorimi dhe Siguria

Krijimi dhe implementimi i platformës SIEM bazuar në Wazuh për monitorim të avancuar të sigurisë dhe analizë të incidenteve.

Implementimi i platformës Zabbix për monitorimin e parametrave të rrjetit, shëndetit dhe integritetit të serverëve.

Krijimi i sistemit të file auditing në shared folders në Domain Controller për rritjen e kontrollit dhe gjurmueshmërisë së aktiviteteve.

4. Modernizimi i Infrastrukturës IT

Përmirësimi i infrastrukturës me harduerë përmes furnizimit me laptopë dhe kompjuterë AIO, duke rritur produktivitetin e stafit.

Migrimi i sistemeve operative në client-side nga Windows 10 në Windows 11, duke përmirësuar sigurinë dhe performancën.

Migrimi i serverit ArcGIS nga Windows Server 2012 në Windows Server 2022, duke siguruar kompatibilitet dhe mbështetje afatgjatë.

5. Automatizimi dhe Operacionet

Automatizimi i sistemit të hyrje-daljeve në ITUN, duke reduktuar ndërhyrjet manuale dhe duke rritur saktësinë.

Organizimi dhe mobilizimi i procesit të printimit për të gjithë kompaninë, si zgjidhje alternative pas dështimit të hapjes së tenderit për printerë, duke siguruar vazhdimësi të papenguar të punës në kompani.

6. Prokurim:

Zyra e Teknologjisë informatike gjatë vitit 2025 ka hapur 6 tenderë për furnizim me mallra, shërbime dhe punë.

Arritjet e realizuara nga Zyra e Teknologjisë Informatike kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe modernizimit të infrastrukturës teknologjike të kompanisë. Këto iniciativa krijojnë një bazë të fortë për zhvillime të mëtejshme dhe adoptimin e teknologjive të avancuara në të ardhmen.

Sfidat:

Pavarësisht sukseseve të Departamentit të IT-së, mbeten disa sfida, duke përfshirë:

Kërcënimet e sigurisë kibernetike: Departamenti i IT-së vazhdon të përballët me kërcënime të vazhdueshme nga piratë kibernetikë që kërkojnë të shfrytëzojnë dobësitë në infrastrukturën teknologjike të kompanive dhe të gjejnë rrugë për penetrim në sistemet e TI të kompanisë.

Harduerë: për shkak të luhatjes së madhe të çmimeve në treg të pajisjeve dhe komponentëve të pajisjeve të teknologjisë informatike, me buxhetin që ne e kishim në dispozicion për vitin 2025, ka qenë e pamundur të blihet edhe një server që të sigurohet redundanca e shumë kërkuar e harduerin. Ne jemi duke monitoruar me kujdes lëvizjet në treg për të kapur momentin më të volitshëm për blerë edhe një server dhe të sigurohemi se do të kemi redundancë të mjaftueshme.

Aktualisht kjo është shumë e vështirë për shkak të kërkesës së madhe (nga Inteligjenca Artificiale) dhe oferta shumë e limituar (sipas disa revistave të njohura botërore të Teknologjisë informatike prodhimet vjetore të memorieve të vitit 2026 tashmë janë të gjitha të shitura). Ka vazhduar sfida me harduerë veçanërisht komunikimi përmes TRB (modemi për furnizim me internet për pajisjet mobile) për shkak të mbulueshmërisë së operatorit mobil me valë në zona të caktuara.

Burimet njerëzore: stafi i TI është i mirë kualifikuar dhe i aftë për ushtrimin e detyrave dhe funksioneve për të cilat janë angazhuar por mungon motivimi sepse edhe pse janë staf me kualifikime superiore dhe me certifikime të specializuara, ata paguhen si punonjësit me kualifikim të mesëm. Stimulimi me paga të cilat janë në pajtueshmëri me kualifikimet do të përmirësonte dukshëm performancën e stafit të TI.

Prokurimi: Sfidë e veçantë për sektorin e TI është prokurimi i pajisjeve dhe shërbimeve. Pajisjet dhe shërbimet e TI janë shumë specifike dhe ligji i prokurimit vështirëson prokurimin e pajisjeve dhe shërbimeve adekuate. Pamundësia e prokurimit të disa pajisjeve dhe shërbimeve specifike direkt nga prodhuesi ose furnizuesi (si shërbimet e hostimit ose domenit, apo blerja e disa pajisjeve specifike direkt nga prodhuesi), e bëjnë shume të komplikuar këtë proces sepse duhet të bëhet përmes palëve të treta.

Planet e ardhshme:

Për të adresuar sfidat me të cilat përballet Departamenti i IT-së, është menduar zbatimi i këtyre çështjeve:

Përmirësimi i siguri së kibernetike: Departamenti i IT-së do të vazhdojë t'i japë përparësi masave të siguri së kibernetike duke miratuar teknologji të reja dhe të avancuara, duke zbatuar politika dhe procedura dhe duke ofruar trajnime të vazhdueshme për të gjithë punonjësit.

Aktivitetet që janë të nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit tonë janë:

- 7 Furnizimi i dhomës së serverëve me fikje automatike të thatë të zjarrit
- 8 Ndërtimi i rrjetës së re kompjuterike në zyrat e Njësisë Operative Rahovec.
- 9 Redundanca duhet të arrihet me blerjen e serverëve me performancë të njëjtë për të parandaluar ngjarjet katastrofike
- 10 Blerja e një NAS serveri për ruajtjen automatike të kopjeve të data bazave jashtë serverëve punues.

7. Veprimtaria e zhvilluar nga Departamenti Komercial

Në vijim do të paraqesim punët për Departamentin Komercial gjatë 12 muajve të vitit 2025.

Tabela 42. Konsumatorët gjatë vitit, transaksionet, lidhjet e reja, bllobime

1. Numri total i konsumatorëve të rinj për 12 muaj e vitit 2025 janë të listuara si më poshtë që në total ka arrit **2,202** konsumatorë të rinjë si dhe numri total i konsumatorëve ka arritë **51,702**.

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
196	79	145	121	174	168	255	151	192	197	161	363	2,202

2. Ngarkesa për vitin 2025, ka arrit në m³ është 8,299,845.
3. Ngarkesa e shprehur në vlerë monetare (në euro) për vitin 2025, është 5,670,033 euro
4. Arkëtimi nga uji për vitin 2025, ka arritur 5,676,292 euro, vetëm të hyra nga faturat e ujit dhe kanalizimit, apo në përqindje 100.02 %
5. Diferenca e arkëtimit nga Biznes Planit me Arkëtimin është 134,192 euro mbi BP.

Tabela 43. Prodhimi dhe faturimi për vitin 2025 i ndarë në njësi krahasuar me vitin 2024.

Njësia	2024				2025				DIFERENCA PËR DY PERIUDHAT
	PRODHIMI	FATURIMI	UPF	%	PRODHIMI	FATURIMI	UPF	%	
GJAKOVA	8,195,756	5,331,445	2,864,311	34.95	8,472,725.00	5,375,169.23	3,097,555.8	36.56	(233,244.96)
RAHOVECI	3,798,040	1,435,651	2,362,389	62.20	3,718,041.	1,325,760	2,392,281.0	64.34	(29,891.70)
LUMBARDHI	3,317,353	1,183,944	2,133,409	64.31	3,208,230	1,099,289	2,108,941.0	65.74	24,467.59
REKA E KEQE	891,726	483,805	407,921	45.75	813,047	499,626.50	313,420.5	38.55	94,500.50
TOTAL	16,202,875	8,434,845.30	7,768,029.70	47.94	16,212,043	8,299,845	7,912,198.3	48.80	(144,168.57)

Nga tabela e mësipërme vërejmë disa ndryshime të ndara në njësi nga vitit 2024 deri në vitin 2025.

- Gjakova ka rritur UPF për 1.61% krahasuar me vitin 2024.
- Rahoveci ka rritur UPF për 2.14% krahasuar me vitin 2024.
- Prizreni ka rritur UPF për 1.42% krahasuar me vitin 2024.
- Reka e Keqe ka zvogëluar UPF për 7.20% krahasuar me vitin 2024.

Tabela 44. Krahasimi i vitit 2025 me Biznes Planin e vitit 2025.

Viti 2025/ Biznes plani 2025	Viti 2025	BP 2025	NDRYSHIMI NGA BIZNES PLANI	B.P. %
PRODHIMI M3	16,202,875.00	16,150,102.00	52,773.00	0.33
FATURIMI M3	8,434,845.30	8,971,005.00	(536,159.70)	(5.98)
PA FATURUAR M3	7,768,029.70	7,179,097.00	588,932.70	(8.20)
% HUMBJES	47.94%	44.45%	3.49%	7.85
ARKETIMI	€ 5,676,291.56	€ 5,542,099.38	134,192.18	2.42

Nga këto tabela vërejmë që:

- Prodhimi ka ngritje për 0.33% nga Biznes Planit i vitit 2025.
- Faturimi ka pësuar rënie për 5.98% nga planifikimi.

- Përqindja e UPF ka rritje për 7.85% nga planifimi.
- Arkëtimi ka tejkaluar Biznes Planin për 2.42%.

6. Numri i transaksioneve të realizuara për 12 muaj e kemi paraqitur si më poshtë:

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
16,013	16,840	19,133	19,032	18,285	18,170	19,904	21,835	19,978	19,249	19,805	20,751	228,995

7. Numri i konsumatorëve pasiv për këtë vit ka pas ndryshime nga muaji në muaj ku edhe do t'i listojmë si më poshtë:

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
K.Pasiv	16,961	17,509	18,304	17,478	17,450	17,441	15,913	13,796	15,908	17,958	18,375	19,064

8. Gjatë vitit 2025 kemi identifikuar lidhje para orës, kyqje të paautorizuara, manipulime në ujëmatës si më poshtë: ku në total janë 570 .

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
49	40	28	21	25	39	83	57	105	58	43	22	570

9. Gjatë vitit 2025 janë bërë gjithsej **322** blompime të ujëmatësve, si dhe raportime të vazhdueshme për ujëmatëse jofunksional e të cilët i kemi ndërruar me procesverbale.

10. Në vitin 2025 janë shtuar dukshëm kërkesat për pëlqime parimore, të cilat para aprovimit kontrollën nga Njësia e Kontrollës, për obligime ose faturim. Numri total ka arrit 128.

11. Gjatë vitit 2025 grupe të kontrollës gjatë inspektimit në teren kanë identifikuar defekte që llogariten humbje teknike, të cilat janë të listuara si më poshtë, në total janë 151

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
1	5	7	8	17	23	23	26	13	13	10	6	151

12. Për të gjitha kyqjet e paautorizuara dhe lidhjet para ujëmatësit që kanë qenë për këta muaj është aplikuar rregullorja e ARRU-së Rregullore Nr.14/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.06/2016, për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë, për rikthimin e humbjeve. Për ata konsumtorë që nuk kemi arrit marrëveshje mbi rikthimin e humbjeve ka vazhduar procedura.

7.1.Shërbimi për konsumatorë

Shërbimi me Konsumatorë me qëllim të harmonizimit (bashkërenditjes) sa më të mirë të punëve dhe detyrave të punës në mes të shërbimeve për konsumator në Kompani, në funksion të realizimit të objektivave kryesore të Kompanisë dhe arritjes së standardeve shërbyese për të gjithë konsumatorët e vet brenda zonës së definuar të furnizimit pa dallim, në nivelin e ndërmarrjeve të vendeve në rajon, ka vepruar në drejtim dhe ofrim të të gjitha shërbimeve për konsumatorë.

Shërbimi me Konsumatorë ka bërë pranimin dhe procedimin e aplikacioneve për kyqje të reja në shërbimet përkatëse, më pas lidhjen e kontratave të shërbimeve me konsumatorët e kyçur, në të gjitha rastet e kyçjeve të rregullta dhe legalizimeve kur konsumatori ka ardhë në kompani si dhe regjistrimin e tyre si konsumatorë. Konsumatorët i ka pajisur me Kontratë të Shërbimeve edhe në rastet kur ata kanë kërkuar ndonjë shërbim.

Tabela 45. Raporti mbi numrin e Ankesave/Kërkesave dhe Kontratave të Shërbimeve

Nr.	Përshkrimi	2025	2024	Ndryshimi % krahasuar me 2024
1	Ankesat Komerciale/ Teknike të pranuar	1,185	2,024	Ka pasur një rritje prej 70.8 %
2	Kërkesa Komerciale/Teknike të pranuar	3,962	3,903	Ka pasur një rënie prej 1.49%
3	Ankesat/Kërkesat-Komerciale dhe Teknike, të shqyrtuara dhe zgjidhura me kohë	5,086	1,776	Ka pasur një rritje prej 65.1%
4	Kontata të Shërbimeve, të realizuara	5,140	7,740	Ka pasur një rritje prej 50.6 %

Vlen të ceket që në vitin 2025 ka pasur rritje të numrit të ankesave komerciale (për heqjen e shërbimeve të kanalizimit) pasi në muajin Shkurt të vitit 2024 bazuar në vendimin nga Komuna e Gjakovës, KRU Gjakova Sh.A. ka bërë faturimin kolektiv për të gjithë konsumatorët e njësisë punuese Gjakovë, ku më pas konsumatorët që nuk janë të lidhur në rrjet të kanalizimit, janë paraqitur dhe identifikuar për heqjen e shërbimeve të kanalizimit. Përqindja e rritjes së ankesave ka arritur 70.8%. Një rritje e konsiderueshme vërehet te kontrata e shërbimeve, ku përqindja e rritjes krahasuar me vitin 2024 ka arritur 50.6%.

Kurse rënie të konsiderueshme shohim që kemi te ankesat/kërkesat-komerciale dhe teknike, të shqyrtuara dhe zgjidhura me kohë me një përqindje të lartë prej 65.10%.

Deri me 31.12.2025 në total janë të lidhura 39,844 kontrata me konsumatorët.

Tabela 46. Raporti i Marrëveshjeve për Riprogramimin e Pagesës së Borxhit me Këste

Nr.	Përshkrimi	2024	2025	Ndryshimi % krahasuar me 2024
1	Marrëveshjet për riprogramim të pagesës të borxhit	127	243	Ka pasur një rritje prej 62.31%

Përmes Shërbimit me Konsumatorë janë arritur marrëveshje për ri programime të pagesës së borxheve më këste me ata konsumatorë të cilët në pamundësi të pagesës së menjëhershme të borxhit kanë kërkuar të i'u mundësohet pagesa me këste. Te ri programimet e borxheve është vërejtur një rritje e madhe e shprehur në përqindje 91.3%.

Menaxhimi i Debitorve dhe Qendra e Thirrjeve

Gjatë vitit 2025, në vazhdimësi janë filtruar lista me konsumatorë të cilët kanë borxhe të akumuluar ndaj K.R.U. "Gjakova" Sh.A ku të njejtëve u janë dërguar vërejtje për mospagesë dhe akumulim të borxhit.

Gjithësejt në zonën e mbulueshmërisë me shërbim të K.R.U "Gjakova" Sh.A janë dërguar **41,999** Vërejtje ku në fillim të çdo muaji janë dorëzuar tek Lexuesit e terreneve përkatëse në mënyrë që të shpërndahen së bashku me faturën mujore. Nga vërejtjet e shpërndara gjatë vitit janë propozuar

gjithësej **375** konsumatorë për Inicim të Procedurës së më tutjeme tek Përmbartuesi Privat, janë pranuar vetëm **217** prej tyre për vazhdim të Procedurave për arsye të mungesës së të dhënave ose të gabuara të cilat figurojnë në dosje të Konsumatorëve përkatës.

Në total vërejtjet e dërguara kanë sjellë edhe në reagim nga ana e konsumatorëve për kryerje të pagesave, arritje të marrëveshjeve për pagesë të borxhit me këste mujore si dhe përditësim të të dhënave të konsumatorëve.

Po ashtu gjatë vitit 2025, nga vendimet për ndërprerjen e shërbimeve të ujit janë ekzekutuar 94 çkyqje fizike në teren. Përveq vërejtjeve gjatë kësaj periudhe zyrtarja ka realizuar edhe thirrje përmes telefonit për konsumatorë industrial dhe Fizik të cilët janë njoftuar për borxhin e akumuluar ku të njejtit edhe janë përgjigjur me pagesa.

Gjatë gjithë kësaj periudhe në bashkëpunim me Zyren Ligjore dhe Përmbartuesin privat zyrtarja ka qenë e angazhuar në asistencë për çdo informacion më të detajuar të kërkuar nga ana e tyre në mënyrë që lëndët të jenë sa më të kompletuara për ekzekutim.

Gjatë Vitit 2025, janë thirrë gjithësejt 710 konsumatorë për pagesë të borxhit, me riprogramim dhe pa riprogramim si dhe thirrje për defekte, pëlqim parimor etj.

Prej 710 thirrje me konsumatorë, 271 i janë përgjigjur pagesës, 429 konsumatorë nuk janë përgjigjje pozitivisht për pagesë, ndërsa janë bërë edhe 6 thirrje për sqarim rreth pagesave të faturave përmes bankave apo dhe sqarim për menyrën e faturimit. Vlera totale e pagesave të konsumatorëve nga thirrjet për vitin 2025 është 16,593.60 €

Gjatë vitit 2025, janë regjistruar në excel 985 raste për ndërrimin e ujëmatësve, avullim, krije të xhamit, raste këto të paraqitura nga lexuesit në teren apo edhe nga vet konsumatorët. Defektet e paraqitura në Shërbimin për Konsumator janë dërguar në Shërbimin Teknik me e-mail dhe regjistruar në CRM.

Hulumtimi i Opinioneve të Konsumatorëve

K.R.U "Gjakova" SH.A. për të njohur më mirë opinionet dhe perceptimet e konsumatorëve, për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit që ka ofruar gjatë vitit 2025, është duke zhvilluar një hulumtim të opinionit të konsumatorëve.

Qëllimi i hulumtimit është që K.R.U "Gjakova" SH.A. dhe palët tjera të interesuara të njoftohen me qëndrimet e konsumatorëve për shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit gjatë vitit 2025, në tërë zonën shërbyese të K.R.U "Gjakova" SH.A. për të krijuar një pasqyrë të këtyre shërbimeve në aspektin e kënaqësisë së konsumatorëve. Gjetjet nga ky hulumtim do të përdoren si udhërrëfyes për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të përmirësuar nivelin e shërbimeve në të cilat adresohen shqetësimet e konsumatorëve, dhe avancimin imazhin e kompanisë.

8. TRANSAKSIONET E KONSIDERUESHME QË PËRFSHIJNË K.R.U. "GJAKOVA" Sh.A. GJATË VITIT 2025, NGA AKTIVITETI I PROKURIMIT

Tabela 47. Transaksionet -Aktivitetet e Prokurimit

Titulli i Aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e Kontratës së nënshkruar në euro	Operatori Ekonomik Fitues i Tenderit
Furnizim me automjete për nevojat e terenit të Kompanisë K.R.U. Gjakova- (SUV – Pick Up –Lot 1) Ritender	20.01.2025	81,900.00	PORSCHE KOSOVA SH.P.K, P N, LLAPNASELLË,
Furnizimi me rërë kuarci për stacionin e filtrave	22.01.2025	24,820.00	Grami SH.P.K., XHORXH BUSH NR.19, PRISHTINË
Furnizim me material hixhenik	08.01.2025	3,244.85	PM GROUP SH.P.K., Anton Çetta, PRISHTINË
Furnizim me pjesë rezervë për SCADA të Stacionit Filtrave	13.01.2025	9,968.50	"ENELDAT" SH.P.K., F.AGANI,21/8, PRISHTINË
Furnizim me orë të dorës'	08.01.2025	588.00	Ermal Neziri B.I., Rruga Nënë Terezë, nr.477, 50000, Gjakovë
Hulumtimi i Kënaqshmerisë së Konsumatorve për shërbimet e ofruara nga K.R.U " Gjakova" Sh.A për vitin 2024.	07.02.2025	1,440.00	D&D Business Support Center L.L.C., Str. "Xheladin Hana", Iliria Building, Prishtina
Kryerja e analizave të llumit të ITUN-Ritender	05.02.2025	980.00	Horn and Co. Analytics SH.P.K., Petra Bojovica pn Lapllaselle, 10500, Gracanice, Kosovë
Furnizim me zarfa për shpërndarjen e faturave	12.02.2025	960.00	NDËRMARRJA SHËRBYESE TREGTARE „ERPO-PRINT" SH.P.K., TIRANA P.N., 50000, GJAKOVË
Hulumtimi i Kënaqshmerisë së Konsumatorve për shërbimet e ofruara nga K.R.U " Gjakova" Sh.A për vitin 2024.	07.02.2025	1,440.00	D&D Business Support Center L.L.C., Str. "Xheladin Hana", Iliria Building, Prishtina
Furnizim me rërë	19.03.2025	48,150.00	Valdrini-A ShPK, Kramovik-Rahovec
Furnizim me makineri për kositjen e barit	20.03.2025	3,099.00	Jon Group L.L.C. Prishtinë
Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP-Ritender	29.04.2025	6,272.30	4ING SH.P.K., p.n., Podujevë-Pakashticë e Poshteme
Furnizimi me pajisje, ekzekutimi dhe konfigurimi i rrjetës kompjuterike në Drejtori të KRU Gjakova	05.05.2025	23,857.00	Ati - Kos SH.P.K., rr. "Tirana", Gjakovë
Furnizim me material elektrik	16.05.2025	24,630.30	ROA Consulting SH.P.K., Sallabajë-Lluzhan, p.n, Podujevë
Furnizimi me pajisje për dezinfektimin e rrjetit të klorit të gazët dhe pjesë rezervë	21.05.2025	24,853.49	" Profitech " SH.P.K., Rr. Ilaz Kodra Nr. 5, Prishtinë
Furnizim me mbyllës mekanik për pompën thithëse të K.R.U. Gjakova - Ritender	29.05.2025	850.00	N.P.SH."Hiterm EL", Driton Islami, Ferizaj, Kosovë

" Sanimi i rrjetit të kanalizimit si rast emergjent për shkak të depërtimit të betonit në rrjetin e kanalizimit në rrugën Nëna Tereze".	11.06.2025	44,847.00	KOSOVA WATER AND ENERGY SH.P.K., Rr. Tirana pn. (Ndërtesa e Arting), Kati V, Post Fah No.50, Prishtinë
Furnizim me Printera (arkat lëvizëse)	17.06.2025	988.00	KIBERNETIKA SH.P.K., A.Terbeshi, 50000, GJAKOVË, Kosovë
Furnizim me materiale të ndryshme për nevoja ITUP	23.06.2025	994.00	INFINIT SH.P.K.,Deshmoret e Kombit 10000 Prishtinë
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Ymer Pula dhe në katër fshatrat të Komunës së Gjakovës.	04.07.2025	113,535.64	Grup i Operatorëve Ekonomik FIDANI L SH.P.K.; FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr.180, Deçan.
Shërbime të përkthimeve - Ritender	08.08.2025	5,700.00	N.SH.PRESTIGE, Garibaldi,Hyr. 5/5, PRISHTINË.
Furnizim me material zyrtar	14.08.2025	6,577.32	EUROPRINT GROUP SH.P.K. Kompleksi Banesor A1, Lagja Emshir Prishtinë.
Gyp i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojz, Medvec dhe Mamushe- FAZA II (vazhdimi)	01.08.2025	449,964.26	Grup i Operatorëve Ekonomik GJIKURIA; Hidro Mentori SH.P.K., Rruga Faik Konica, Residencia Lion Park ,Tiran, Tirana- Gjiguria SHPK Dega në Kosovë
Furnizim me pajisje mobile (-Telefon Smart Printerë Termik)	29.08.2025	7,999.92	515 CONCEPT SH.P.K., Gasper Karaci, Gjakovë
Auditimi i Kompanisë	09.09.2025	4,764.99	" ProAudit " SH.P.K., Rr. Behar Begolli, Linda Premium, Obj. C2, Prishtinë
Shërbimet e Internetit	04.09.2025	21,942.00	ELEKTRA L.L.C., rr.Adem Jashari, Hani i Elezit
Pastrimi i Xhamave në Objektin e Drejtoris Gjakovë - Ritender	26.09.2025	978.12	Samir F. Kastrati B.I., Fehmi Agani, 165, 50000, Gjakovë
Shërbim i rikthimit të të dhënave kritike nga SSD	02.09.2025	885.00	STORM ICT L.L.C., RR. Tahir Zajmi p/n, 10000, PRISHTINË
Furnizim me Klimë 18 BTU për dhomën e serverëve-ritender	18.09.2025	640.00	Bujar Dakaj B.I., Dëshmoret e Kombit, 32000, Klinë
Furnizim me logo për nevoja të ITUP-Ritender	08.09.2025	945.00	Drini Shala B.I., Gjakovë /Orize, 5000, Gjakovë
Deratizimi, Dezinfektimi dhe Dezinsektimi (DDD) për njësinë e ITUN - KRU "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë	24.09.2025	846.00	Truly Nolen SH.P.K., Dardania5-L.-2, 10000, PRISHTINË
Furnizim me Klor i gaztë, klor të lëngët dhe me bombola të klorit të gaztë.	02.10.2025	44,795.00	Seykos SH.P.K., RR. Ali Vitia ob-office 6.1, PRISHTINË
Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësese shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec dhe Smaq 1-faza 2.	20.10.2025	44,616.58	VALA SH.P.K., Rr. Selami Pulaha, A6-2/5, PRISHTINË
Instalimi i ujëmatësave jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashëngjergj" të Komunës së Prizrenit.	20.10.2025	32,821.00	VALA SH.P.K., Rr. Selami Pulaha, A6-2/5, PRISHTINË

Furnizim me Kompjuter dhe Laptop.	31.10.2025	24,874.00	ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA
Aparatet kundër zjarrit.	22.10.2025	2,494.20	ALBKOS SAFETY SH.P.K., Rr. e Pejës 26, Fushë Kosovë
Furnizim me material reprezentativ -Ri tender.	13.10.2025	948.10	LANDI STAR SH.P.K. Nënë Tereza Gjakovë
Riparimi i rimorkios së kamionit MAN për bartjen e Eskavatorit.	24.10.2025	790.00	Gjelbrim Fetija B.I.UÇK, Gjakovë, 50000, Gjakovë
Renovimi i objekteve administrative.	07.11.2025	7,856.86	Grup i Operatorëve Ekonomik Albkos Bau SH.P.K.; AGE Group SH.P.K., Mulla Cufa Nr. 37, Rahovec.
Blerja e Minibusit për nevojat e ITUP.	04.11.2025	69,270.00	KOSOVA MOTORS J.S.C. SH.A., Graçanicë, Preoc.
Sigurimi dhe kontrollimi Teknik i automjeteve të KRU Gjakova-Ritender.	19.11.2025	16,827.20	K.S.Dukagjini SH.A., Rr. XHEVDET DODA, OBJ.DUKAGJINI RESIDENCE HY.A1 K.1, PRISHTINË.
Furnizim me pelet.	18.11.2025	1,245.00	Bek Fluids L.L.C., Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë.
Transportimi i stafit të K.R.U. Gjakova.	12.11.2025	785.00	BLEDI Bus SH.P.K.,Ruga Dedë Gjon Luli, 50000, Gjakovë.
Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve në tërë Njësit e KRU Gjakova – Ritender	11.12.2025	26,600.00	Grup i Operatorëve Ekonomik GEB SH.P.K.; Burimi - E Sh.p.k., Brigada 123, pn Suharekë
Sanimi i rrjetit të kanalizimit nëpër rrugë të ndryshme në gypat e dëmtuar dhe ndërtimin e pusetave	02.12.2025	56,485.00	EUROFAMIS SH.A., Shirokë- Suhareke, SHIROKË
Pastrimi i automjeteve të KRU Gjakova - Ritender	31.12.2025	7,368.00	Leicon SH.P.K., Kushtetuta Kaqanikut, Peje
Furnizim me material propagandistik	01.12.2025	985.00	AGIMI DE SH.P.K., Sheshi Mentor Tolaj, 51000, DEÇAN
Totali:		1,257,421.63	

9. SYGJERIME DHE PROPOZIME PËR NDRYSHIME TË CILAT ME ARSYE PRITET QË TË RRISIN PERFORMANCËN E KOMPANISË

- Të ofrojmë shërbime të pandërprera për të gjithë konsumatorët;
- Të mbulojmë shpenzimet me të ardhurat e Kompanisë;
- Të përmbushim apo të tejkalojmë të gjitha nivelet e aktiviteteve të planifikuara në mirëmbajtje;
- Të furnizojmë ujë cilësor dhe me efektshmëri më të mundshme mjedisore, duke i përmbushur pothuaj të gjitha në afat;
- Të përmbushim apo edhe tejkalojmë monitorimin e të gjitha detyrave;
- Të zvogëlojmë humbjet e ujit;
- Të mirëmbajmë funksionalitetin e mbarë infrastrukturës;
- Të bëjmë investime të planifikuara dhe aty ku mundë të shfaqen e ku do të vlerësohet se mundë të vihet në rrezik biznesi jonë;
- Të planifikojmë zvogëlimin e shpenzimeve për energji dhe karburante;
- Të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake;
- Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve;
- Të furnizojmë shërbime cilësore dhe në kufijtë e parametrave të lejuara, sipas standardeve;
- Të reduktojmë në masë të madhe rrezikun nga përmytjet nga kanalizimi fekale dhe atmosferik, gjatë periudhave me të reshura me intezitet dhe kohë të tej zgjatur;
- Të angazhohemi në mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve tanë, dhe kjo të jetë aktivitet qenësor në vazhdimësi;
- Të shtojmë kontrollin e shpenzimeve dhe të këmbëngulim për rritjen e të hyrave nga arkëtimi.



K.R.U."GJAKOVA "SH.A
Rr."U.Ç.K" nr.7–Gjakovë, Kosovë
www.kru-gjakova.com